



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 4 DHJETOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
4. DECEMBAR 2008. GODINE

DHJETOR – DECEMBAR
2008

R e n d i i d i t ë s

1. Koha për pyetje parlamentare,
2. Interpelanca e ministrit Alush Gashi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së,
3. Rishqyrtimi i Ligjit për tubimet publike,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimi e Ligjit për Administratën tatimore dhe procedurat, dhe
5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mandate dhe Imunitete për heqjen e statusit të deputetit z. Sabit Rrahmani.

D n e v n i r e d

1. Vreme za poslanička pitanja,
2. Interpelacija ministra Alush Gashi, na zahtev Parlamentarne grupe LDD,
3. Ponovno razmatranje Zakona o javnim skupovima,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o Poreskoj upravi i procedurama i
5. Razmatranje Preporuke Komisije za mandatna i imunitetna pitanja da se g. Sabit Rrahmani, oduzme mandat poslanika.

A g e n d a

1. Time for Parliamentary questions,
2. Interpellation of Minister Alush Gashi, upon request of the Parliamentary Group of DLD,
3. Review of the Law on Public Gatherings,
4. Second reading of the Draft Law on Amendment and Supplementation of the Law on Tax Administration and Procedures, and
5. Review of recommendation made by the Committee for Mandates and Immunities for removal of the status of a deputy for Mr. Sabit Rrahmani.

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
I nderuari Kryeministër,
Zëvendëskryeministër, ministra,

I hapim punimet e seancës së sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 79 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Rendi i ditës dhe materialet iu janë shpërndarë të gjithë deputetëve.

Ndërkohë, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, propozon Kuvendit që për seancën e sotme plenare të radhitet edhe -Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Edhe njëherë po ju lexoj çka, dhe ndijoni!

Ndërkohë, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen..., kjo ka ndodhur të martën, i propozon Kuvendit që për seancën e sotme plenare të radhitet edhe një pikë e re e rendit të ditës - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa në lidhje me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës

Kush është “për”? Shërbimi, i numëroni votat! Kush është “kundër”? Faleminderit! Kush abstenon, Faleminderit!

Konstatoj se pika ka hyrë në rend të ditës, për te kanë votuar 42 “për”, 17 “kundër” dhe 3 “abstenime. Pra, kemi pikën e fundit e rendit të ditës - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës.

Ju faleminderit!

Pika e parë e rendit të ditës, është:

- Pyetjet parlamentare

Para se të fillojmë me procedim të kësaj pike, ju njoftoj se për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara, me qëllim të ruajtjes së aktualitetit të tyre, në pajtim me ndihmën e seancës për shmangien e Rregullës 26.1, koha për pyetjet parlamentare zgjatet nga 50 në 60 minuta dhe procedohet nga një pyetje e deputetëve që kanë shtruar më shumë pyetje. Fillojmë, deputeti Arsim Rexhepi...

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohet për transkriptim)

...Asnjë kërkesë me shkrim nuk e kam, merreni shikojeni Rregulloren. Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin e Tregtisë, Industrisë, Lutfi Zharkun...

(Ndërhyrje e Gani Gecit , nuk dëgjohet për transkriptim)

...e di, po me shkrim duhet pasur. Nuk kam asnjë shkresë me shkrim, thashë. Merreni Rregulloren, shikojeni rregulloren. Arsim Rexhepi, e bëni pyetjen! Nuk është ministri. Kalojmë.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajazitin.

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohe për transkriptim)

Me shkrim, me shkrim, Rregullorja shkruan. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin. Rregulla me shkrim, bëni kërkesat me shkrim, unë ju japë fjalën,

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohe për transkriptim)

Është hartuar rendi i ditës para një jave.

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohe për transkriptim)

Unë kam thënë që ju nuk keni bërë kërkesë me shkrim, kur ta bëni kërkesën me shkrim, unë e shtroj.

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohe për transkriptim)

Rregulla 30, mocionet procedurale. Ju lutem!

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohe për transkriptim)

23.2 Në fillim të seancës plenare ky propozim i rendit të ditës do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 anëtarë të Kuvendit i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament në rend të ditës, i cili hidhet në votim. Unë nuk kam asnjë kërkesë me shkrim.

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohe për transkriptim)

Unë po e lexoj rregullën 30.8 Mocionin për të konstatuar zbatimin e Rregullores së Punës dhe mocionin për shkeljen e të drejtat e deputetit mund ta bëj madje vetëm një deputet. Ky mocion i parashtrohet Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese. Nëse konsideron se t'u ka shkelur e drejta, bë ankesë me shkrim!

Deputeti Riza Smaka, a do të bësh pyetje për Kryeministrin? Bëje pyetjen!

Lexojeni Rregulloren mirë, pastaj unë kam të drejtë të vendos.

(Ndërhyrje e Lulzim Zenelit, nuk dëgjohe për transkriptim)

Unë e përcaktoj a është urgjente a nuk është, jo ti! Ulu aty!

(Ndërpërje incizimi)

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohe për transkriptim)

Ne e kemi shkruar edhe unë e interpretoj Rregulloren e Punës së Kuvendit.

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohe për transkriptim)

Mbaj konferencë me gazetarë edhe lexoje! Jo, unë kam thënë atë që e di i gjithë Kuvendi.

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohe për transkriptim)

Rregulla 29, po ta lexoj edhe një herë. Çështje urgjente. “Në çdo seancë plenare, deputeti në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi të shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente. Nëse kryetari i Kuvendit konsideron se çështja menjëherë meriton t’i kushtohet vëmendja e Kuvendit, deputetit në fjalë i mundëson të japë propozime në Kuvend, që pastaj do ta vë në votim. Nëse Kuvendi vendos ta marrë çështjen para sysh, atëherë duhet ta bëjë në atë takim, sepse orari dhe radhitja e kësaj pike rregullohen”. T’i nuk e ke bërë kërkesën paraprake te unë, do të thotë as nuk e ke bërë me shkrim, as nuk e ke bërë paraprakisht te unë, kështu që nuk ke të drejtën ta marrësh fjalën. Prandaj, Riza Smaka, urdhëro, e ke fjalën dhe vazhdojmë seancën.

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohet për transkriptim)

Shefi se ka ngritur, qe ku e ke aty!

(Ndërprerje incizimi)

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohet për transkriptim)

RIZA SMAKA: I nderuari zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër, ministra,

Dhe deputetë të respektuar,

(Ndërhyrje e Gani Gecit, nuk dëgjohet për transkriptim)

(Ndërprerje incizimi)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Shefat e Grupeve parlamentare kanë rënë dakord që ta thyejmë Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe t’ia japim fjalën deputetit Gani Geci. I ka 2 minuta për rend dite.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Unë desha, para se të fillojmë me rendin e ditës, t’i them, t’i ngreh 2 çështje shumë me urgjencë. Një çështje është që Komisioni ynë funksional ka paraqitur një raport me rekomandime dhe Kryesia nuk e ka marrë parasysh. Unë do t’i përmend vetëm datat: më 21.4 e kemi bërë një, më 16.9. dhe më 6.10, dhe se është proceduar më 9.10, me numër të protokollit 031138DO614, andej ne nuk kemi pasur si Grup Parlamentar nevojë të ngrehim çështje për siguri, sepse këtë e ka bërë Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri.

Ndërsa, çështja tjetër për t’u ngritur me urgjencë nga Grupi ynë Parlamentar është arrestimi i 3 shtetasve gjermanë, arrestim ky spektakular me media, që nuk i takon shtetit më të vogël në Evropë dhe më të dobët ndaj një shteti më të fuqishëm ekonomikisht në Evropë, ndoshta edhe në botë. E dimë shumë mirë se shteti i Gjermanisë e ka njohur pavarësinë e Kosovës ndër shtetet e para, shteti i Gjermanisë ka mbi 2500 ushtarë këtu, shteti i Gjermanisë e ka një ambasadë, ka vënë marrëdhënie diplomatike me shtetin e Kosovës. Ne nuk kemi pasur nevojë të xhirojmë filma, por kemi pasur nevojë të bisedojmë me ambasadën e Gjermanisë dhe të falënderojmë Gjermaninë për kontributin

që e ka dhënë për shqiptarët gjatë viteve 1990 - 99, sepse ju e dini që shteti i Gjermanisë ka pritur mbi 250.000 shqiptarë, i ka punësuar, i ka mbajtur dhe ata i kanë mbajtur familjet e tyre, ndërsa ne jemi sjellë papërgjegjshëm me shtetasit gjermanë, sepse ata kanë shkuar, sipas informatave dhe gazetave gjermane, për të inspektuar vendin e ngjarjes, ndërsa janë arrestuar, prandaj dikush duhet të shkojë për këtë arsye o nga Ministria e Punëve të Brendshme, o nga Ministria e Drejtësisë. Janë arsyet pse? Sepse Ministria e Punëve të...

KRYETARI: Driton, merre fjalën edhe ti, 2 minuta!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Unë do të doja që për rend të ditës, sot apo në seancën e radhës, të kemi formimin e një grupi mbipartiak, do të thotë nga anëtarët e partive politike parlamentare, duke mos i anashkaluar edhe anëtarët e partive politike të mbetura jashtë parlamentit, grup të cilin do ta quajmë si të duam, grup strategjik apo këshill nacional, i cili konform situatës së krijuar, si rezultat i ofensivës agresive politike të Serbisë, e cila për synim ka mundësisht ripushtimin e Kosovës, të paktën ndarjen etnike të Kosovës. Ky grup të merret me analizimin e opsioneve alternative të realizueshme të interesave tona, duke pasur parasysh edhe interesat e qytetarëve shqiptarë, me të cilët jetuam në ish Jugosllavi, si bie fjala, interesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjes, e të tjerë.

Mendoj se është plotësisht legjitime që edhe ne shqiptarët, ashtu sikurse edhe fqinjët tanë verilindorë, të kemi projekte alternative të elaboruara mirë, të cilat do t'i përdorim sipas imponimeve të kohës. Unë në realitet mendoj se ky është edhe obligim i këtij Parlamenti, si institucion më i lartë përfaqësues, që të jetë i përgatitur e mos të na ndodhë edhe njëherë euforia e vitit 2005, mendoj euforia për negociata me Serbinë, ku nuk pati shqiptarë që nuk mendonte se nuk e kishte vendin në Grupin Negociator, pa marrë parasysh përgatitjen e tyre. Të gjithë pretendonin të bëheshin Ismajl Qemajala. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Vazhdojmë me pyetjet parlamentare.

Riza Smaka e kishte fjalën, po, po me duket tash na mungon. A po e bën pyetjen. Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

Regjia, fjalën deputetit Riza Smaka. Dil në foltore, deputet, bëje pyetjen!

RIZA SMAKA: Në gjysmën e dytë të muajit tetor 2008, autoritetet e rendit të Republikës bënë arrestimin e 3 qytetarëve gjermanë me dyshimin se kanë bërë vepër penale të eksplozimit në lokalet zyrtare ndërkombëtare. Arrestimit të tyre mediat elektronike dhe printe kosovare, sipas vlerësimit tim, në mënyrë diletante, amatore, pa sens elementar të përgjegjësisë politike, i dhanë publicitet krejtësisht të karakterit pompoz e spektakular. Arrestimi në raste të tilla në përgjithësi kurdoherë bëhet duke u bazuar në presubsione, pafajshmëri.

Pyetja është: Si u lejua të bëhet ky pompozitet spektakular krejtësisht në dëm të çështjes së Kosovës? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I nderuari ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra
Të nderuar deputetë,
I nderuari zoti Smaka,

Më lejoni shumë shkurt t'ju bëj disa njoftime për sa i përket rastit. E para, për t'ju kërkuar falje që sot nuk mund të jap detaje të rastit të hetimit për shkak se, siç e dini, ky rast ende trajtohet nga ana e hetimeve dhe e drejtësisë sonë dhe për shkak se, siç e dini, ende jemi në proces të ekzaminimit të disa prej provave. Ajo që dëshiroj t'ju them është që përkundër faktit një gjendjeje të mirë të sigurisë në Kosovë këtë vit, s'do mend se kemi pasur disa raste të cilat e kanë sfiduar efikasitetin e institucioneve tona, edhe vendore, edhe ndërkombëtare. Dëshiroj t'ju them, po ashtu, rasti i hudhjes së eksplozimit në ndërtesën e ICO, po ashtu ka qenë një sfidë për ne, për policinë, për orgenet e drejtësisë.

Më lejoni t'ju them që policia jonë ka intervenuar me shpejtësi dhe mjaft profesionalisht me rastin e këtij eksplozimi. Ky është një vlerësim madje jo vetëm i yni, por i gjitha institucioneve monitoruese e të tjera ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Po ashtu, vetëm pak minuta pas kësaj ngjarjeje, unë personalisht kam kontaktuar zotin Peter Feith për t'i treguar interesimin e veçantë të Qeverisë, të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Policisë për ta hetuar dhe për ta zbuluar rastin.

Ajo që ka ndodhur më pastaj me hetimet, kanë qar me gjetjen e provave, e kanë qar policinë deri te arrestimi i personave, të cilët më pastaj u janë dërguar organeve të tjera për proces mëtejme.

Më lejoni, po ashtu, t'ju them që kapacitetet tona, ekspertiza jonë ende nuk është e mjaftueshme për t'i ekzaminuar disa lloje të provave, siç janë këto me rastin e eksplozivëve e tjerë, prandaj edhe ka zgjatur procesi i ekzaminimit të këtyre provave dhe besoj që shumë shpejtë, me qenë se disa prej provave ekzaminohen jashtë vendit, do të kryhet procesi nga ana e hetimeve dhe, po ashtu, shpresoj që e njëjta gjë të bëhet nga ana e drejtësisë.

Ju e dini që, jo vetëm ky rast, por edhe raste të tjera që kanë ndodhur në Kosovë kohëve të fundit, tregojnë që ne kemi bërë një përkushtim të madh, kemi lënë dhe kemi kërkuar nga organet e policisë, të drejtësisë, që të jenë të pavarura dhe kemi thënë që jemi të sigurt, të vendosur që të orientojmë, t'i zbatojmë politikat që askush të mos jetë mbi ligjin. Me këtë rast nuk dëshiroj të prejjudikoj asgjë

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Keni pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Mirënjohje për punën e Ministrisë, aktivitetin e organeve të rendit. Aludimi im është përgjegjësia e medieve, të cilat pa kurrfarë nevojë e kanë skandalizuar këtë çështje në mënyrën më brutale e banale dhe amatore. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, merre fjalën!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Më lejoni të shfrytëzoj kohën time. Mediat nuk mund t'i orientojmë se çfarë, si mund të plasojnë rastin, ka qenë vetë interesim i mediave. Më

lejoni t'ju them, po ashtu, që nuk ka fare interes që të citohen edhe gazetatat e tjera të ndryshme të huaja. Ne nuk kemi asnjë interes që ta politizojmë rastin. Me Gjermaninë kemi një partner shumë të rëndësishëm me të cilën edhe si Ministri e Punëve të Brendshme, edhe si Qeveri kemi bashkëpunim të përbashkët edhe, po ashtu, ju e dini se është ndër partnerët, donatorët kryesor nga shtetet evropiane dhe kemi një bashkëpunim shumë të mirë edhe vazhdojmë të kemi në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet Riza Smaka, ju e dini rendin e pyetjeve qysh i keni bërë. Nuk është mirë ta kapërcesh rendin, se kur po e kapërcejmë ne, nuk po ju vjen mirë. Prandaj, kujdes! Ne i kemi pyetjet qysh i keni bërë dhe ju nuk e keni respektuar rendin e pyetjeve që i keni bërë. Ju e dini shumë mirë, atëherë t'i regjistroni kur i keni bërë pyetjet. Deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Urdhëro, e ke fjalën deputet!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kjo pyetje është bërë më 26 shtator, rreth dy muaj e gjysmë, më saktësisht dy muaj e tetë ditë, por edhe më tutje mban aktualitetin dhe ka të bëjë me qëndrimin e Qeverisë ndaj planit 6 - pikësh në raport me rinegociatat me Qeverinë serbe për çështjet teknike në këto fusha.

A na shpjegoni, zoti Kryeministër, se çka janë ato gjëra teknike apo cilat janë ato, për të cilat niveli më i lartë shtetëror i Kosovës dhe i Serbisë do të negociojnë apo të bisedojnë, siç parapëlqeni ju të thoni, në fushën e policisë apo në fushën e gjyqësisë. Faleminderit!

KRYETARI: E keni fjalën, Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari Kryetar,
Të nderuar deputetë,

Sa i përket pyetjes suaj, i nderuari zoti Tali, qëndrimi i institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës ka qenë gjithmonë i qartë. Kosova shtet i pavarur, sovran dhe demokratik, ka kushtetutën e vet, ka përgjegjësi për implementimin e dokumentit të presidentit të Ahtisari, ka vizionin e qartë për të ndërtuar raporte bashkëpunimi të shkëlqyeshëm me të gjitha vendet e rajonit. Me Serbinë gjithçka duhet të jetë në raporte ndërshtetërore. Është me rëndësi jetike të thuhet se veç ka filluar mbyllja e kapitullit të UNMIK-ut në Kosovë dhe hapja e kapitullit të ri të EULEX-it, prandaj ne të gjithë, si Kuvend, si institucione, si politikë kosovare, duhet t'i japim mbështetje këtij misioni të ri që nuk është vetëm i Bashkimit Evropian, por që është edhe prezenca amerikane. Prandaj, do të ketë respektim të plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës edhe në sistemin e drejtësisë, edhe të policisë, edhe të doganave dhe në të gjitha segmentet e tjera. Pra, ne do të funksionojmë si shtet.

Dëshiroj t'ju ftoj të gjithëve që, sinqerisht, të mos ndikoheni prej deklaratave të Jeremiqit dhe të askujt tjetër. Kosova është shtet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!
Pyetje shtesë?

DRITON TALI: Zoti Kryeministër, mendoj se isha shumë i qartë, cilat janë gjërat teknike që do t'i bisedoni. Keni pranuar se do të bisedoni për gjërat teknike. Niveli më i lartë, nuk e kam të qartë, çka bisedon për gjërat teknike, por sidoqoftë, konform asaj dhe

Kushtetutës së Kosovës, po ta bëj një pyetje shumë teknike. Më 3 tetor, para dy muaji e një dite, është hapur Gjykata në Mitrovicën e veriut. A është kthyer stafi kosovar, sipas premtimit të PSSP-së, se po e citoj atë: “brenda 60 ditëve, stafi, nëpunësit kosovarë do të fillojnë punën, do të kthehen në vendet e tyre të punës” Nëse nuk janë kthyer, atëherë kush nuk po e tregon të vërtetën këtu, për mos thënë tash atë fjalën, që zotit kryeparlamentar nuk po i pëlqen ta them në Kuvend, do me thënë, kush po rren? Faleminderit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë thashë, të mos ndikoheni nga shtypi i Beogradit, të mos ndikoheni nga deklaratimet e Beogradit, të mos frustroheni prej kërcënimeve dhe mesazhe frikësuese të Jeremiqit. Kosova ka zot, ka institucione shtetërore, ka vullnetin e 2 milionë qytetarëve, e ka përkrahjen e SHBA-ve, të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s, prandaj ne do të punojmë vetëm me agjendën tonë shtetërore. Beogradi gënjen, gënjen dhe gënjen gjithmonë për Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, e humb të drejtën të bësh pyetje, a!

(Ndërhyrje, deputeti Tali, nuk dëgjohet për transkriptim)

Deputet Tali, mos e merr fjalën pa ta dhënë. Jo, se vërtet duhet ta bëjmë një kulturë të sjelljes dhe të mirësjelljes. Janë do norma, a.

(Ndërhyrje, deputeti Tali, nuk dëgjohet për transkriptim)

Nejse, çështja e edukatës është çështje e hershme. Deputeti Zafir Berisha, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Meqë pyetja është bërë para 2 muajsh, unë tërhiqem nga pyetja, sepse e ka humbur kuptimin, kështu që të bëj pyetje sa për të bërë, mendoj se nuk ia vlen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Nait Hasani, pyetje për Kryeministrin zoti Hashim Thaçi. Deputet Hasani, e ke fjalën!

NAIT HASANI: Faleminderit, Kryetar!
Përshëndetje Qeverisë,

Unë e kam një pyetje që ndoshta aktualiteti nuk i ka humbur dhe nuk i humb asnjëherë. Për mua është një çështje që në Kuvend të Kosovës kemi pasur një raportim financiar për vitin 2007, që e ka mbajtur Hasan Preteni. Ka deklaruar se keqpërdorimet e keqmenaxhimet dhe korrupsioni i marrë është mbi 40 milionë euro për këtë vit. Pyetja është për Kryeministrin. Më intereson të di nga ju se deri ku ka mbërri çështja e zgjidhjes të këtij keqpërdorimi nga fjala e Hasan Pretenit dhe kush është marrë në përgjegjësi dhe a ka dhënë llogari kush për të vlerë të keqpërdorur. A është marrë kush në pyetje nga Prokuroria për këtë çështje, a duhet të japë llogari dhe të mbajë përgjegjësi Hasani Preteni për fjalën e deklaruar në Kuvend të Kosovës, që janë keqpërdorur mbi 40 milionë euro?!

KRYETARI: Zoti Kryeministër, a e do fjalën?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti deputet Hasani,

Me respekt, unë nuk e kam pyetjen përpara, por sido që të jetë, do të ishte me interes për mua ta përsërisni edhe njëherë pyetjen prej fillimit, nëse ka mundësi.

KRYETARI: Deputet Hasani, veç një moment. Pyetja juaj nuk është për ekzekutivin, më tepër është çështje e Gjyqësorit. Megjithatë, Kryeministri po tregon gatishmërinë për t'u përgjigjur. Po, ju lutem, dalloni pushtetet, sepse në Kosovë janë tri nivele pushtetesh. Vazhdoje fjalën!

NAIT HASANI: Në Kuvendin e Kosovës, në raportin financiar për vitin 2007, që e ka mbajtur Hasan Preteni, ka deklaruar se keqpërdorimet e keqmenaxhimit dhe korrupsioni i marrë është mbi 40 milionë euro.

Pyetja: Më intereson të di nga ju, deri ku ka mbërri çështja e zgjidhjes së këtij keqpërdorimi, sipas fjalës së Hasan Pretenit, dhe kush është marrë në përgjegjësi, a ka dhënë llogari kush për këtë vlerë të keqpërdorur? A është marrë kush në pyetje nga Prokuroria për këtë çështje, a duhet të japë llogari dhe të mbajë përgjegjësi zoti Hasani Preteni për fjalën e deklaruar publike se në Kosovë janë keqpërdorur mbi 40 milionë euro?

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë mendoj se duke respektuar pyetjen e deputetit Hasani, duhet të bëj një dallim fillimisht. Mos i parashtroni pyetjet ekzekutivit, që nuk janë për ekzekutivin, por janë për organet e drejtësisë. Qeveria nuk përzihet në investigime, nuk përzihet në organet e drejtësisë, i respekton dhe i mbështet. Kjo ndërlidhet edhe me dy pyetjet paraprake që u parashtruan edhe më herët për rastin e njohur që ka qenë më herët.

Ndërsa, në pyetjen tuaj direkte, zoti Hasani, është shqetësuese keqpërdorimi i 40 milionë eurove për vitin 2007. Duhet t'u japim mbështetje të fortë organeve të drejtësisë për ta kryer punën e vet dhe për të konstatuar të vërtetën, duke respektuar ligjin. Ndërsa, për deklaratën e tij, zotit Preteni, nëse është bazuar në fakte, duhet t'i japim mbështetje të plotë. Nëse nuk është bazuar në fakte, duhet gjithashtu të kemi qëndrim të cilin duhet ta respektojmë që është në përputhshmëri me interesat e vendit dhe të respektimit të ligjit. Por, ne i kemi dhënë përkrahje të plotë Agjencisë Antikorrupsion dhe do të vazhdojmë si Qeveri e re e Republikës së Kosovës.

Për këtë arsye, e kisha të paqartë, se ju folët për këtë vit, pra ju keni folur për vitin 2007. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Pyetje, jo koment.

NAIT HASANI: Jo, nuk po jap koment, po nëse vërtet janë 40 milionë, dikush duhet të japë llogari, dikush duhet të shkojë në burg të Dubravës, ta vizitojë Burgun.

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Edhe mund të jenë 40 milionë të keqpërdorura për vitin 2007. Organet e drejtësisë duhet ta thonë fjalën e vet dhe ne do t'i mbështesim si

Qeveri, do t'i mbështesim organet e drejtësisë, ndërsa ne as nuk dërgojmë njerëz në burg, por as nuk lëshojmë nga Dubrava. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin e Bujqësisë, zotin Idriz Vehapi. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen. Ministri nuk është këtu.

MYRVETE PANTINA: Ministri nuk është këtu, prandaj nuk po e parashtroj pyetjen.

KRYETARI: Mirë, vazhdojmë. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministren e Energjetikës, e cila nuk është këtu. Doni ta lexoni pyetjen, deputete? Urdhëro, fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla!

GJYLNAZE SYLA: Zoti Kryetar, nuk do ta lexoj pyetjen, por e kam një çështje. Dua personalisht Ty ta kujtoj mandatin e kaluar, kur Ju keni qenë shef, dhe i propozoj Kuvendit që në të ardhmen Ju të lejoni, se nuk është kompetencë e juaja mos t'i lejoni deputetët të flasin. Prandaj, propozoj që në fillim të seancës, herën e ardhshme secili deputetë të paraqesë qëndrimin e vetë 2 minuta, ata që duan të flasin. Duhet zhvilluar kësi lloj praktike dhe jo praktikë të kontrollit, çfarë Ju jeni duke zhvilluar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Po unë punoj mbi bazën e një Rregulloreje. Unë, përsëri po ju them, ndryshone Rregulloren. Projektregullorja është e përgatitur dhe si të ndryshohet rregullorja, unë kam për të punuar mbi bazën e rregullores.

Deputetja Shpresa Murati, pyetje për Kryeministrin zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen. Nuk është këtu.

Deputetja Njomza Emini, nuk është këtu.

Deputeti Enis Kervan, pyetje për ministrin e Arsimit, nuk është këtu.

Deputeti Emrush Xhemajli, pyetje për ministren e Drejtësisë, nuk është këtu.

Deputetja Rita Hajzeraj, pyetje për Kryeministrin, nuk është këtu.

Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zotin Valton Beqiri.

ARSIM REXHEPI: Zoti Kryetar,

Ky sistem i të paraqiturit të pyetjeve parlamentare, si duket, po tregohet shumë i pasuksesshëm. Unë pyetjen e kam bërë që një tre muaj ditë dhe asaj pyetje i ka dalë boja krejt. Po e kursej Parlamentin edhe nuk po e bëj fare.

KRYETARI: Do të thotë, e ke bërë këtë pyetje. Deputeti Nait Hasani, pyetje për ministrin e Punëve të Jashtme, zotin Skender Hyseni. Ministri nuk është këtu.

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Fjalën e ke, deputete!

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Padyshim, janë shumë arsye që flasin për nevojën e privatizimit të PTK-së. Edhe pse PTK-ja është e njohur si ndërmarrje më fitimprurëse në Kosovë, po ashtu është e njohur edhe për numrin e madh të skandaleve dhe të keqpërdorimeve. Një problem për PTK-në paraqet mungesa e kodit shtetëror telefonik, mungesë që shkakton shpenzime me dhjetëra milionë brenda vitit për shfrytëzimin e kodit të huaj, kosto të cilën e bartin konsumatorët e Kosovës.

Zoti Kryeministër, a është tani momenti i përshtatshëm për privatizimin e PTK-së, derisa PTK-ja ende nuk posedon kodin nacional për telefoni fikse dhe mobile?

KRYETARI: Faleminderit!
Zoti Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Procesi i privatizimit nga Qeveria e Kosovës është një proces më i gjerë dhe më gjithëpërfshirës dhe më kompleks sesa që mund të precizohet vetëm në PTK. Ne kemi vazhduar me procesin e zhvillimit të termocentralit “Kosova e Re”, që do të fillojë në vitin 2009. Gjithashtu, kemi vazhduar me procesin tjetër të zhvillimit të projektit të hidrocentralit në Zhur, mbi 300 megavatë, që gjithashtu do të përfundojë në vitin 2009. Gjithashtu, kemi filluar me procesin e koncesionit të Aeroportit, që do të përfundojë në vitin 2009, por kemi filluar edhe me procesin e privatizimit të distribuimit të KEK-ut, që gjithashtu do të përfundojë në vitin 2009, e në të njëjtën kohë, në kuadër të këtyre përgjegjësive të reja shtetërore dhe të respektimit të ekonomisë së lirë të tregut, të konkurrencës, kemi marrë vendim edhe për privatizimin e Valës 900. Pra, është çështje thjeshtë e përgjegjësive dhe e filozofie politike të qeverisjes për vendimmarrje dhe proces të privatizimit, ndërsa mund të ketë mendime të tjera, por ekonomia e planifikuar ka përfunduar njëherë e përgjithmonë në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

MYRVETE PANTINA: Kryeministër, nuk jemi kundër privatizimit, por me siguri për procesin e privatizimit duhet të zgjidhet edhe momenti i përshtatshëm, në mënyrë që përfitimet të jenë më të mëdha dhe të mos bëhet privatizimi me çdo kusht.

KRYETARI: Zoti Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Është një proces në të cilin janë të përfshirë ekspertët më të mëdhenj e më të fuqishëm vendorë dhe ndërkombëtarë. Është një vlerësim real i situatës dhe ne kemi vlerësuar, si Qeveri, në konsultim të ngushtë dhe mbështetje të të gjithë faktorit relevantë ndërkombëtarë, se është momenti i duhur.

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin e Bujqësisë, nuk është këtu.
Deputeti Driton Tali, e ka bërë këtë pyetje.
Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e MTI-së, Lutfi Zharkun, nuk është këtu.
Deputeti Nait Hasani, pyetje për ministrin e MASHT-it, Enver Hoxhaj.

(Ndërhyrje, nuk dëgjohet për transkriptim)

Çka, lexoni me rend pyetjet!

NAIT HASANI: Me rend, i ke kaluar rendet, Kryetar. Nuk kam pyetje për...

KRYETARI: Jo, këtu e kam emrin tënd, deputeti Nait Hasani, pyetje për ministrin e MASHT-it, zotin Enver Hoxhaj. Po, keni harruar deputet. Nëse do, hajde lexoje pyetjen!

(Ndërhyrje, nuk dëgjohet për transkriptim)

Këtë pyetjen që e lexova unë, ti e ke lexuar më herët. Prandaj, ju lutem, kur të kthehemi!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçin. Edhe ti më duket se e ke lexuar, deputet. Jo! Urdhëro! Deputeti Riza Smaka e ka fjalën!

RIZA SMAKA: Unë jam i bindur se zoti Kryeministër është i interesuar aq sa edhe të tjerët që pyetjet kuvendore të marrin përgjigje serioze në procedurë, me kuptimin e plotë, e jo të anashkalohen, të neglizhohen edhe shumë përgjigje jepen ad-hoc, aty për aty, në mënyrë të improvizuar. Unë angazhohem nëpërmjet kësaj pyetje që ky institucion të ketë një karakter serioz sepse është tepër i rëndësishëm sa për deputetin, sa për Kryesinë e Kryetarin, për Kryeministrin, aq edhe për opinion publik. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, unë kam respekt për deputetët, por vërtet duhet të jemi të kujdesshëm. Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin e MASHT-it, zotin Enver Hoxhaj. Nuk është.

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e MASHT-it, zotin Enver Hoxhaj. E keni fjalën deputet!

DRITON TALI: Një pyetje e kam për Kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin, që ka të bëjë po ashtu me arsimin. Kjo është më pastaj për ministrin e Arsimit, kështu që do ta bëj pyetjen, por tash më shkoj minutazhi. Do ta bëj pyetjen që e kam adresuar më 26 shtator të vitit 2008, zoti Kryetar, nëse më lejohet. Po, shkruan aty, Kryeministrit apo zëvendëskryeministrit.

KRYETARI: Po, ti e ke ndërruar vetë. Urdhëro, bëje pyetjen!

DRITON TALI: Po, s'po di tash cilën e keni qitur edhe me numër aty. Unë i kam dy pyetje më 26 shtator.

KRYETARI: Jo, ti i ke bërë me datë, e di qysh i ke bërë, mos i harro!

DRITON TALI: Të dyja kanë qenë të adresuara më 26 shtator, sidoqoftë.

KRYETARI: Urdhëro, urdhëro!

DRITON TALI: Faleminderit, megjithatë!

Zoti Kryeministër,

Kohë më parë, këtë pyetje ia kam bërë edhe në seancën e parë të shtatorit ministrit të Arsimit, por nuk ka ditur të më japë përgjigjen, andaj po ju pyes Juve. Kohë më parë, Qeveria e Serbisë deklaroi se nuk i njeh diplomat e Universitetit të Prishtinës, të vulosura nga UNMIK-u. Siç e dini, më 2001 ka qenë njëfarë marrëveshjeje në mes të UNMIK-ut dhe Serbisë që të njihen këto certifikatat akademike. A keni reaguar deri më tani, dhe si do të reagojë Qeveria ndaj këtij provokimi të radhës, nëse nuk ka reaguar deri më tash? Çfarë do të ndërmerrni konkretisht, ngase ky vendim tendencioz qëllim kryesor ka diskriminimin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjës në punësimin e tyre në aparatin shtetëror?

KRYETARI: Pyetja e bërë më 26.9.2008 ka të bëjë me atë se cili është qëndrimi i Qeverisë ndaj Planit të Ban Ki Munit lidhur me fillimin e ri të negociatave në mes të palës kosovare dhe asaj serbe.

(Ndërhyrje, nuk dëgjohej për transkriptim)

Mirë, t'i e lexove. Zoti Kryeministër, ju e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti deputet, nuk kam gjë as çka t'i shtoj, as çka t'i heqë përgjigjes që e ke marrë nga ministri Hoxhaj.

KRYETARI: Ju lutem, shko atje në vend. Deputet Driton Tali, e ke marrë përgjigjen për këtë pyetje. Jo, nuk të jepet fjala tash, se fjalën e ka Kryeministri. Urdhëro, Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Kuvendi nuk është vetëm i juaj, nuk është këtu odë e burrave, është Kuvend i Republikës së Kosovës, ka rend e rregull, nuk mundesh edhe Kryetarit të Parlamentit t'i drejtohesh në mënyrën si i drejtohesh, nuk mund ta uzurposh binën, siç pretendon ta uzurposh, nuk mund ta uzurposh periudhën kohore të deputetëve tjerë, siç pretendon. E ke marrë përgjigjen para 3 muajsh, e more edhe sot dhe, nëse nuk të ka bindur Enver Hoxhaj, nuk e di se kush mund të të bind ty në këtë vend.

KRYETARI: Faleminderit, faleminderit!

(Ndërhyrje, nuk dëgjohej për transkriptim)

Driton Tali, po ta them, edhe një herë bën zhurmë, ke për të dalë jashtë!
Deputeti Nait Hasani, pyetje për ministrin e Kulturës, të Rinisë dhe të Sporteve, Valton Beqiri.

(Ndërhyrje, nuk dëgjohej për transkriptim)

Ju lutem, Gani, ju lutem, a!

Naiti nuk e do fjalën. Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për... Justina Pula nuk është këtu. Doni ta lexoni pyetjen? Nuk doni.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Pyetjen e ke bërë më 2.12.2008. Nuk do, heq dorë. Mirë!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Idriz Vehapi. Pyetjen e ke bërë më 2.12.2008. Ministri nuk është këtu. A do ta lexosh pyetjen? Jo!

Shkojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

- Interpelanca e ministrit Alush Gashit, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së

Në pajtim me Rregullën 25.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar i LDD-së i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për të ftuar në interpelancë ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 25.2 të Rregullores së Punës, interpelanca mund të zgjasë 2 orë, kohë kjo që u ndahet grupeve parlamentare dhe deputetëve në proporcion me numrin e tyre.

Në pajtim me Rregullën 25.7 të Rregullores së Punës, përfaqësuesi i interpelancës mbanë të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta, dhe në përmbyllje të

debatit deri në 5 minuta. Ftoj përfaqësuesin e parashtruesit të interpelancës të Grupit Parlamentar të LDD-së që të marrë fjalën. Fjalën e ka deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,
Deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë, e brengosur për gjendjen alarmante në shëndetësi, i bashkohet vlerësimit të përgjithshëm të personelit mjekësor, të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të pacientëve tanë dhe, së fundit, të institucioneve ndërkombëtare relevante, si të Organizatës Botërore Shëndetësore, se shëndetësia kosovare është në krizë të thellë dhe faktor shqetësues për situatën maksimalisht të përkeqësuar në Kosovë.

Lidhja Demokratike e Dardanisë ka kërkuar këtë interpelancë me ju pasi ne ju drejtuam juve edhe opinionit publik në konferencë për shtyp, ku patëm kërkuar nga ju që të ndërmerreni hapa në përmirësimin e gjendjes në këtë sektor dhe jo të merreni me çështje që u takon organeve dhe sektorëve të tjerë.

Deputetë të nderuar,

Besoj se interpelanca e sotme nuk do të konsiderohet si triumf mbi kundërshtarin pozitë-opozitë nga se sëmundja nuk njeh pozitë apo opozitë. Qëllimi i LDD-së është shumë i qartë sot, duam të nxisim ndryshimin e diskursit të indiferencës dhe të papërgjegjësisë institucionale karshi thellimit të krizës në shëndetësi, si dhe rrënimit të gjendjes së shëndetit në nivel kombëtar.

Përfundimi i grevës së fundit të punonjësve shëndetësorë, sado të ketë rezultuar me një marrëveshje, kurrësi nuk paraqet dhe nuk reflekton sukses për punonjësit shëndetësorë. Fatkeqësisht, Ministria nuk ka arritur të krijojë status dinjitoz një punëtorët shëndetësorë, duke iu ndarë paga nënçmuese, duke i demotivuar dhe degraduar profesionalisht.

Ministria e Shëndetësisë po ballafaqohet me mungesë të vizionit dhe të konceptit të zhvillimit të shëndetësisë kosovare. Ajo dështoi të evidentonte saktë prioritetet e veprimit dhe, si pasojë, shëndetësia kosovare ka hyrë në një qark të mbyllur të së keqes.

Vonesat e Qeverisë në themelimin e skemave të sigurimeve shëndetësore dhe të legjislacionit përkatës, duke u arsyetuar me të dhëna të dyshimta për implikime shumë të larta buxhetore janë, të paqëndrueshme.

Zoti ministër,

Në fillim të mandatit tuaj keni deklaruar që në bashkëpunim me Bankën Botërore po analizohet fizibiliteti dhe ndikimi ekonomik i këtij ligji dhe së shpejti do të dilni me rezultate. Kanë kaluar 8 muaj dhe ajo që na është ofruar për koston e këtij ligji, ka qenë vlera 154.000.000 euro. Studimet që janë bërë nga ekonomistët e vendit, me përvojë ndërkombëtare, për analizën e implikimit ekonomik nga implementimi i mundshëm i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, ka rezultuar me vlerë shumë më të ulët, 1/3 e vlerës së proklamuar nga ju. Pyetja ime është, zoti ministër, cili agjencion është ngarkuar me përpilimin e këtij studimi dhe në bazë të të cilave kritere është bërë përzgjedhja e tij, sa ka kushtuar ky studim, cilat janë përfundimet konkrete të këtij studimi dhe sa kohë dhe sa mjete duhet të shfrytëzohen strukturat joeficiente për të thënë se nuk mund t'ju sjellin një dokument të tillë, çka do të bëni lidhur me këtë, zoti ministër?

Sistemi farmaceutik, sigurimi i barërave dhe të materialit shpenzues është një nga dështimet më të mëdha të Ministrisë dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ministria e Shëndetësisë, jo vetëm që ka dështuar në formulimin dhe implementimin e politikave të qarta të decentralizimit, porveç në enklavat serbe, që nuk ju pyesin fare, ajo përmes centralizimit të skajshëm të zinxhirit të furnizimit ka mundur keqpërdorimet më të mëdha në këtë sektor. Zoti ministër, buxheti për listën esenciale të barërave në këtë vit është më i larti, 16 milionë euro, kurse QKUK kurrë më pak e furnizuar me barëra dhe material shpenzues nuk ka qenë.

Përse mungojnë barërat, ato më prioritetet nga lista esenciale. Çdo mëngjes zoti ministër, në mbledhjet e kolegjiemeve profesionale shtrohet lista e gjatë e ankesave të profesionistëve për mungesën e barërave dhe të materialit gjatë punës së tyre ditore. Për shkak të këtyre mungesave shpeshherë janë të rrezikuar pacientët tanë dhe profesionistët. Kush duhet të japë përgjegjësi për këtë situatë të rëndë, bile katastrofale, ku as pacientët, as mjekët nuk janë të mbrojtur.

A mund të flitet fare për sistem shëndetësor kur aktorët kryesorë të këtij sistemi, pacienti dhe mjeku, fare janë të pambrojtur, zoti ministër? Jo! Jo, zoti ministër, ju nuk kemi sistem shëndetësor, ju duhet ta shtypni pullën e ristartimit dhe ta krijoni një sistem të ri shëndetësor të mirëfilltë!

Investimet kapitale, unë dua t'i përmend vetëm tri investime kapitale, që janë përgjegjësi e juaja, se si do t'i finalizoni: Onkologjia, Mjekimi Intensiv, Kardiokirurgjia. Tri projekte me rëndësi shtetërore karakterizohen me abuzime në realizmin e tyre dhe akoma nuk janë gjetur kryerësit e këtyre abuzimeve.

Përse, zoti ministër, nuk kemi llogaridhënie për këto abuzime? Për Onkologji janë shpenzuar 2.055.000 euro vetëm për objekt dhe është vendosur aparati më modern i CT-së funksionale, por nuk përdoret. Si rezultat, populli i Republikës së Kosovës çdo ditë po vuan dhe po maltretohet me aparate më të dobëta në sektorin privat dhe askush nuk brengoset për këtë.

A nuk ndieni përgjegjësi, zoti ministër, për çdo ditë vonese të punës së këtij instituti, kur dihet se në çfarë halli të madh janë pacientët tanë, duke bredhur në regjion për këto shërbime dhe duke u ekspozuar riskut për shpenzime katastrofale.

Projekti i dytë, Mjekimi Intensiv Qendror, edhe përkundër pyetjeve parlamentare në Kuvend, drejtuar juve për këtë projekt, letrës së hapur Presidencës dhe Kryeministrit nga anesteziologët e Republikës së Kosovës, me të vetmin qëllim që ta ngrisim cilësinë në trajtimin e pacientëve që luftojnë për jetë në mjekimin intensiv, nuk arritëm t'ju bindim. Tani mjekimi intensiv vazhdon të renovohet në formë kundërligjore.

Përse, zoti ministër, e vazhduat projektin ashtu si e kishin paramenduar abuzuesit, çka ju bën të dalloheni prej tyre? Projekti i Kardiokirurgjisë, me qindra mijëra euro janë dhënë deri tani për këtë projekt. Vetëm nga buxheti i paraparë për këtë vit janë ndarë 256.000 euro, kurse për Projektbuxhetin e vitit 2009 janë paraparë afër 1 milion euro.

Zoti ministër, a e dini ku e keni Kardiokirurgjinë dhe në çfarë faze e keni? Në rrënoja e keni, zoti ministër.

Menaxhimi i dobët i buxhetit është dukuri që e përcjell këtë ministri që nga përpilimi gjer te zbatimi i tij dhe çdo herë ka pasur për pasojë derdhjen e mjeteve të dedikuara në suficitin buxhetor, për të cilin buxhet Ministria gjithmonë ankohe.

Në raportin e gjashtëmujorit të vitit 2008, vetëm 17% të buxhetit kanë qenë të shfrytëzuara për investime kapitale. Në kërkesë dhe në konfirmimin e kërkesës sime të drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë për qasje në dokumente zyrtare, nuk më është lejuar dhe është bërë në tetor të këtij viti.

Zoti ministër, kur unë si deputete e Kuvendit të Kosovës nuk kam të drejtë në qasje në dokumente zyrtare, atëherë çka mund të pret qytetari i rëndomtë. Andaj, ju pyes, zoti ministër, sa është shfrytëzuar buxheti i paraparë për investime kapitale për këtë vit, edhe pse një dozë e madhe e dyshimit do të mbetet pas raportit tuaj. Zoti ministër, transparenca në sistemin shëndetësor duhet të jetë e domosdoshme.

Duhet të pranoj, as Projektbuxheti për vitin 2009 nuk sjell asgjë të mirë. Nuk ka planifikim, nuk ka projekte të përgatitura me arsyeshmëri, me planet e zbatueshmërisë dhe ajo më sinjifikantja, nuk ka racionalitet gjatë planifikimit. Do ta përmend vetëm një prej projekteve, për shkak të kohës. Keni paraparë blerjen e Akceleratorit linear afro 1 milion euro. Zoti ministër, ne e kemi një akcelerator të ri të deponuar në Mazgit. Ndoshta është bërë amortizimi moral, por ai mund të përdoret dhe, më thuani, cili shtet, edhe prej atyre më të pasurve, do të mund të përballonte këtë investim?

Qendra Klinike Universitare e Kosovës, institucioni më i madh, më përgjegjës, me stafin më të kualifikuar, me numër më të madh të punëtorëve...

KRYETARI: Ju faleminderit! Regjia, sa minuta po i do deputete? Atëherë edhe një minutë kohë për deputeten Morina.

... është e qartë se një riorganizim i tërësishëm i kësaj qendre është i domosdoshëm. Zoti ministër, sa po arrini të koordinoni bashkëpunimin me menaxhmentin e QKUK-së.

Veprimtaria private është dështim i plotë i Ministrisë së Shëndetësisë në implementimin e legjislacionit, monitorimin jo të mjaftueshëm, si dhe ngritjen e kapaciteteve për licencim. Këto e kanë bërë që praktika private të mbetet jashtë kontrollit dhe të kalojë në ilegalitet.

Lidhur me ngjarjet e fundit në këtë sektor, jemi kundër arrestimeve spektakulare mediatike, që po e rrënojnë dinjitetin e mjekut dhe rëndë po e godasin shëndetësinë kosovare. Sot Lidhja Demokratike e Dardanisë qëndron përkrah rreth 15.000 punëtorëve shëndetësorë, të cilët u dëshmuar dhe vazhdojnë me vite të përkujdesen për shëndetin e qytetarëve në Kosovë.

Deputetë të nderuar,
A është...

KRYETARI: Unë nuk e mas kohën, e matë elektronika. Deputete, unë nuk e mas kohën, të jeni e bindur.

Një njoftim. Bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rregulla 25.1, Grupi Parlamentar i LDD-së thërret në interpelancë ministrin e Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, zotin Alush Gashi për ta

informuar Kuvendin e Kosovës për gjendjen e rëndë në sistemin shëndetësor në Republikën e Kosovës. Për të informuar, asnjë kërkesë tjetër nuk ka.

Ju njoftoj se radha është e ministrit. Ministri i ka 10 minuta, nëse do më shumë, duhet t'i marrësh nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Grupet parlamentare e kanë këtë kohë:

- Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike37 minuta.
- Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike.....25 minuta
- Grupi Parlamentar i AKR-së.....11 minuta
- Grupi Parlamentar i AAK-së.....11 minuta
- Grupi parlamentar i LDD-së..... 11 minuta,
- 10 minuta nuk ia kemi numëruar, do të thotë i ka për parashtrësë,
- Grupi Parlamentar “ 7+” 7 minuta
- Grupi Parlamentar SLS-së, 8 minuta , dhe
- Deputetët e pavarur të gjithë së bashku i kanë.....10 minuta.

Vazhdojmë me ministrin Alush Gashi. Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit, I nderuari zëvendëskryeministër, ministra dhe ju shumë të respektuar deputetë. Zotëri Kryetar, me mirëkuptim të shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, më lejoni që t'i shfrytëzoj 3 deri në 4 minuta të Grupit Parlamentar si shtesë të prezantimit.

I nderuari kryetar i Grupit Parlamentar të LDD-së, ju faleminderit për ftesë, për të ofruar informatë për gjendjen në shëndetësi të Republikës së Kosovës!

Nga ftesa e juaj bëhet me dije se jeni të interesuar për informatë për gjendjen në shëndetësi, duke pretenduar edhe të bëni kualifikime. Me kujdes të posaçëm e dëgjova paraqitjen tuaj, e në veçanti për zgjedhjen e fjalëve që keni bërë me rastin e formulimit të interesimit tuaj për t'u informuar për vështirësitë e sistemit shëndetësor në tranzicion, i cili, duke hyrë në reforma, ndeshet me specifikat dhe pasojat e viteve të '90-ta të eskaluar në luftë me elemente të gjenocidit dhe shumë vite të paqartësisë administrative.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë dhe ju ministra, Për kthim të besimit dhe të dinjitetit në profesion dhe vazhdim të reformave në shëndetësi, është thelbësore që shëndetësia të bëhet prioritet nacional. Keni kërkuar të informoheni, por duket se keni hasur në vështirësi t'i arsyetoni kualifikimet, natyrisht, të paqëndrueshme.

Pyetja e parë, të cilën e kam marrë përmes paraqitjes suaj, ka të bëjë me gjendjen e përgjithshme në shëndetësi. Gjendjen në shëndetësi e kam gjetur shumë të rëndë. E kam thënë këtu në Kuvend, në Qeveri dhe në medime, këtë po e them edhe sot.

Gjendjen jemi duke e ndryshuar, duke respektuar ligjin dhe institucionalizuar transparencën. Për këtë kohë të shkurtër, zonja dhe zotërinj të LDD-së, kemi arritur rezultate të pakontestueshme. Me rritje të buxhetit zonjë, për barëra për 100%, shtim të furnizimit me barëra, zonja dhe zotërinj të LDD-së, zvogëlim të shpenzimeve të kabinetëve në çdo pozicion, realizim të projekteve dhe të shërbimeve në pritje për shumë vite, lehtësim të procedurave, monitorim dhe inspektime të vazhdueshme dhe angazhim

për reformë rrënjësore në shëndetësi dhe fillimisht kemi filluar me farmaci dhe kemi rezultate të jashtëzakonshme.

Ju duket se keni nevojë të mësoni lidhur me planet dhe vizionin i Ministrisë së Shëndetësisë. Solemnisht ju informoj se mund të keni në dispozicion të tërë dokumentacionin dhe Master Planin e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës për 10 vitet e ardhshme. Me këtë rast, juve ju përkujtoj se objektivat strategjike të Ministrisë së Shëndetësisë janë këto, të cilat ju kemi thënë në ditën e parë të kësaj qeverisjeje, të cilat i kemi të publikuara dhe të cilat ua kemi dërguar edhe me postë zyrtare:

1. Krijimi i sistemit të qëndrueshëm financiar për sektorin shëndetësor.
2. Përmirësimi i vazhdueshëm i menaxhimit të resurseve ekzistuese dhe të cilësisë së shërbimeve.
3. Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së popullatës.
4. Funksionalizimi i zhvillimit të sistemit të informimit shëndetësor,
5. Funksionalizimi, riorganizimi dhe plotësimi i infrastrukturës ekzistueses të sistemit shëndetësor dhe sigurimi i pajisjeve në përputhje me standardet evropiane, zhvillimi i shëndetësisë publike dhe private sipas kornizës ligjore.

Pyetja e dytë, ka të bëjë, siç thoni ju, me konfliktet brenda Ministrisë së Shëndetësisë. Ju ashtu e keni formuluar. Sa i përket formulimit tuaj jo specifik për konflikte, nëse aludoni në pezullim të sekretarit permanent, mund t'ju përkujtoj se kjo nuk është e veçanta e Ministrisë së Shëndetësisë, shumë ministri kanë një përvojë të tillë.

Është interesante se stimulimi, promovimi dhe kujdestaria mediale për këtë çështje është bërë vetëm për Ministrinë e Shëndetësisë. Ne e respektojmë pavarësinë e profesionit. Presim që kërkesa për respektim të hierarkisë institucionale mos të kualifikohet si konflikt apo ndërhyrje në punë.

Me këtë rast ju informoj, se keni kërkuar informatë, se në fillim të vitit Policia e Kosovës ka njoftuar se është duke u zhvilluar hetimi ndaj disa zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë, në mesin e të cilëve edhe drejtorë të departamentesh. Ne nuk jemi në dijeni për emrat. Sipas medimeve, numri mund të jetë edhe dyshifror dhe medimet thonë se ndaj tyre ka edhe kallëzime penale. Natyrisht, keqbërësit i kanë organizimet e veta dhe vazhdojnë me fushatë. Fushatës iu kemi përgjigjur me punë. Mënjanimin e blerjeve njëburimore, të ashtuquajtura blerje emergjente, me përmirësim të furnizimit me barëra dhe material shpenzues, me liberalizim të importit të barërave, me listë esenciale të përgatitur nga ekspertë e lëmive të ndryshme, me një proces plotësisht transparent, me pajisje diagnostike bashkëkohore, me mbikëqyrje të brendshme dhe të jashtme të përditshme dhe me mbikëqyrje ditore të realizimit të projekteve që kanë filluar që nga viti 2004.

Pyetja e tretë ka të bëjë me sigurime shëndetësore. Aktualisht, të gjithë qytetarët e Kosovës kanë sigurim shëndetësor themelor. Pra, të gjithë, pa dallim, jemi të angazhuar në përgatitjen e kartelës elektronike për këtë sigurim. Mund të jeni në dijeni se Ligji për sigurime shëndetësore është votuar në Kuvendin e Kosovës, i cili, për shkak të kostonë së lartë buxhetore nuk është nënshkruar nga PSSP-ja.

Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, është kthyer në ripunim, gjë që jemi duke e bërë me ekspertë vendorë dhe të jashtëm. Të ndërgjegjshëm për rëndësinë e sigurimeve shëndetësore, gjatë këtij viti kemi organizuar disa konferenca ndërkombëtare me Bankën Botërore, me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me ekspertë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, me të cilët jemi në dialog të vazhdueshëm për t'i shikuar mundësitë që sa më parë ta kemi një ligj për sigurime shëndetësore.

Ju përkujtoj se në vendin tonë është numër i vogël i taksapaguesve, ndërsa është i fortë përkushtimi i respektimit të specifikave të vendit, të programeve sociale dhe shëndetësore të partive parlamentare, emërues i përbashkët i të cilëve është gjenoriziteti për lirim nga pagesa për shërbime shëndetësore. Kuvendit do t'i ofrojmë Ligjin për sigurime shëndetësore dhe koston financiare. Me këtë ju përkujtoj përkushtimin e institucionit të vendit për disiplinë fiskale dhe respektim të rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Pyetja e katërt ka të bëjë me Qendrën Klinike Universitare.

Kryeqyteti ynë, Prishtina, është i vetmi kryeqytet që e njoh, i cili nuk ka spital qyteti. Qendra Klinike Universitare është i vetmi institucion shëndetësor publik terciar si një...

KRYESUESI: XHEZAIR MURATI, I lutem regjisë, edhe 5 minuta i ka ministri prej Grupit të LDK-së

... Qendra klinike është i vetmi institucion shëndetësor publik, i cili praktikisht është qendër emergjente, spital i qytetit për gjysmën e popullatës së vendit, aq sa ka qarku i Prishtinës, si dhe institucion shëndetësor terciar. Kjo gjendje është e papranueshme dhe vendimi im është i paluhatshëm. Duhet reformë rrënjësore në Qendrën Klinike Universitare. Këtë e mbështet Organizata Botërore e Shëndetësisë, Banka Botërore dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

Me kryetarin e Prishtinës kemi vendosur të themelojmë Spitalin e Prishtinës, ndërsa pas miratimit të Ligjit për partneritet publiko-privat, hapen shtigje të reja për partneritet.

Me vendim të Qeverisë së mëparshme ishte themeluar një Bord për menaxhim të Qendrës Klinike Universitare, të cilit i ishte dhënë menaxhimi i Buxhetit për vitin 2007. Sipas të dhënave të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2007, Bordi ka hasur në shumë vështirësi dhe pasojat i kemi parë në muajt e parë të vitit 2008, të manifestuara me mungesë të barërave, të materialit shpenzues si dhe të vonimit të implementimit të investimeve kapitale.

Aktualisht, kemi furnizim mbi 70% të listës esenciale. Ka arritur pajisja në Qendrën Klinike Universitare dhe spitalet rajonale, është rinovuar hapësira për mjekimin intensiv në Qendrën Klinike Universitare, është në përfundim objekti për Onkologji dhe Radioatopi, janë siguruar mjetet për fazën e dytë për realizim të punimeve në hapësirën e Kardiokirurgjisë. Vlen të theksohet se që nga fillimi i këtij viti, për investime kapitale në shëndetësi janë realizuar më se 10 milionë euro. Në vitin tjetër do të ketë më shumë investime, si nga buxheti vendor, ashtu edhe nga Konferenca e Donatorëve.

Pyetja e pestë ka të bëjë me institucionet shëndetësore private.

Në vendin tonë, institucionet shëndetësore private ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas ligjeve në fuqi. Deri më tani, për licencim kanë aplikuar 820 institucione private shëndetësore. 624 janë licencuar, 102 janë refuzuar, 76 janë në proces të licencimit.

Gjatë inspektimeve, për shkak të veprimeve të kundërligjshme janë shqiptuar 40 vendime për ndërprerje të aktivitetit. Sipas ligjeve në fuqi dhe udhëzimeve administrative, institucioni shëndetësor privat nuk mund ta fillojë punën pa e pasur licencën. Edhe pse nuk është pjesë e pyetjeve që më janë dorëzuar për këtë interpelancë, ju informoj se arrestimet e fundit të disa profesionistëve shëndetësorë, janë rezultat i hetimeve të bëra nga Policia e Kosovës, e jo sipas ftesës së Ministrisë së Shëndetësisë.

Me këtë rast, ritheksoj se Ministria e Shëndetësisë ka raporte korrekte me të gjitha ministritë, në kuadër të saj edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Nëse analizojmë se nga 820 institucione shëndetësore private që kanë aplikuar për licencim, 40 kanë problem apo ndeshen me shkelje ligjore, do të thotë që numri i tyre është diku 5% nga të gjitha institucionet.

Komisioni Parlamentar për Shëndetësi është në përgatitje të Raportit për institucionet shëndetësore private, nga i cili presim rekomandime.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Me këtë rast shpreh falënderimin dhe përkushtimin për korrektësi të ish ministrit të Shëndetësisë, deputetit të Kuvendit të Kosovës dhe kryetarit të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, zotit Sadik Idriz.

Sa për atë se si ka qenë gjendja në shëndetësi në fillim të vitit 2008, ndoshta më së miri konstatohet në raportin e Zyrës së Auditorit Gjeneral për vitin 2007.

Ministria e Shëndetësisë, thotë raporti, nuk i ka zbatuar asnjë prej rekomandimeve...

KRYESUESI XHEZAIR MURATI: Vazhdoni ministër!

... Gjatë vitit 2007, proceset e prokurimit në Ministri të Shëndetësisë kanë shkelur pothuajse çdo rregullorë të prokurimit dhe kanë rritur ekspozimin ndaj rrezikut të mashtrimit dhe të keqpërdorimit të fondeve publike. Në Raport për vitin 2007 thuhet se rreth 60% të produkteve medicinale që qarkullonin në tregun tonë në vitin 2007, ishin ilegale apo të palicencuara nga AKPM-ja. Lista e vërejtjeve dhe e keqpërdorimeve në Qendrën Klinike Universitare është e gjerë, raport të cilin e keni edhe ju, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Jemi shtet dhe duhet institucionalizuar filozofia shtetërore. Kërkohet dije dhe guxim për t'i marrë përgjegjësitë për zhvillim të vendit dhe, në kuadër të saj edhe të shëndetësisë, kërkohet edhe mbështetje zhvillimore ndërkombëtare. Për të fituar atë, duhet të dëshmojmë se në vendin tonë kemi sundim ligji. Këtë po e kërkojnë qytetarët e vendit, këtë po e kërkon bashkësia ndërkombëtare, këtë po e kundërshtojnë keqbërësit dhe mbështetësit e tyre.

Nuk është e durueshme që keqbërësit të tallen me qytetarë dhe me ligjin dhe me pushtetin legjitim. Rikujtoj se institucionet e vendit kanë deklaruar përkushtim për rend dhe ligj dhe rezultate do të ketë.

Në mesin e shumë problemeve, kemi hasur në mungesë të barërave, të pajisjeve dhe vështirësi në menaxhim për trajtim jashtë vendit. Pritjet pesë vjeçare të shumë pacientëve dhe situatë paradoksale ku ne, si vend, me indikatorë të ulët shëndetësor, kemi qindra specialistë të mjekësisë të papunë. Kemi arritur mirëkuptimin e Kryeministrit dhe të Qeverisë për shtim të numrit prej 91 specialistëve në sistemin shëndetësor të Kosovës, por natyrisht me procedura të punësimit sipas konkursit.

Nocioni i shëndetit nuk është vetëm raporti mjek-pacient. Është shumë më i gjerë, zonja dhe zotërinj të LDD-së. Në kohën kur në botë angazhohemi për mjekësi molekulare dhe gjenetike, në vendin tonë ende gjysma e popullsisë pinë ujë të ndotur, të ndotur dhe ende nuk trajtohet një numër i madh i ujërave të zeza. Në këtë gjendje, kemi vendosur ta zbatojmë ligjin. E di që juve nuk ju konvenon zbatimi i ligjit. Të institucionalizojmë transparencën, të krijojmë partneritet me sindikatë, shoqata profesionale të mjekëve, të stomatologëve dhe të farmacistëve.

Sipas konstatimit të auditorëve, kishte shkelje flagrante në konkurs të specializantëve, vështirësi të mëdha në Departamentin e Farmacisë dhe që nga dita e parë filluam me zgjedhjen e këtyre problemeve dhe filluam me reforma rrënjësore në farmaci. Për ata që nuk janë në dijeni si ju, Organizata Botërore e Shëndetësisë kërkon nga vendet që të sigurojnë një listë të caktuar të barnave dhe të materialit shpenzues për të gjithë qytetarët e vendit. Në fillim të vitit 2008, në Republikë të Kosovës kishim vetëm 30% të barërave dhe të materialit shpenzues të Listës esenciale. Me kornizë afatmesme të shpenzimeve dhe në Konferencë të Donatorëve ka qenë synim që vitin 2011 të arrijmë 80% të kësaj liste. Këto ditë kemi arritur 72% dhe deri në fund të kësaj, të këtij muaji, kjo përqindje do të jetë 80%.

Zonja dhe zotërinj të LDD-së,

Në dy dekadat e fundit, kjo është hera e parë që furnizimi të arrijë në këtë nivel. Është rritje në sasi, por është rritje edhe në cilësi. Aktualisht, kemi barëra kryesisht nga vendet e Bashkimit Evropian, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, SHBA-ja, Kanadaja dhe Japonia. E ndërruam Udhëzimin administrativ për import të barërave sipas rekomandimit të Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale dhe Shoqatës së Farmacistëve për lehtësim të procedurave që këto barëra të vijnë nga vendet e zhvilluara e jo të kontrabandohen nga vendet e rajonit.

Për përpilim të Listës esenciale, formuam komision të posaçëm nga ana e profesionistëve, që ata ta bëjnë përzgjedhjen dhe ta mbajnë përgjegjësinë. Intensifikuam inspektimet në të gjitha barnatoret e vendit, si ato publike, po ashtu edhe private. Bëjmë hulumtime specifike për përdorimet dhe keqpërdorimet e barërave dhe ky përkushtim, ky planifikim dhe kjo punë e zellshme dha rezultate, sepse prej 30% arrijmë në 72% për një kohë kaq të shkurtër dhe deri në fund të vitit do të jetë 80%, që është synim edhe i Konferencës së Donatorëve që të arrihet në vitin 2011.

Argumentimi para Qeverisë se ekzistojnë kapacitete për menaxhim transparent të buxhetit, solli si rezultat buxhet shtesë për pajisje dhe produkte medicinale, të cilat krahasuar me vitin 2007, janë 100%, kemi rritur buxhetin për farmaci për këtë kohë të shkurtër qind për qind.

E tërë puna në farmaci është transparente dhe është e dhënë në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë. Ju mund ta gjeni, zonja dhe zotërinj, Listën e qarkulluesve farmaceutikë me shumicë, Listën e përfaqësuesve të kompanive të jashtme, barnatoret e licencuara, Listën esenciale të barërave, Listën esenciale të materialit shpenzues, Listën e produkteve medicinave, e tjera. Natyrisht, gjatë kësaj kohe janë bërë diku 849 inspektime nëpër farmacitë e vendit, e tjera.

Aktualisht, jemi duke bërë përpjekje që në çdo paketim të barërave që i marrim, të jetë çmimi, ashtu siç është edhe në vendet tjera.

Inspektoratin shëndetësor e kemi gjetur me 3 inspektorë për 1200 institucione publike dhe shëndetësore. (kishte qenë mirë që të silleni pak më mirë, nëse ka mundësi, ju lutem!) E kemi gjetur me 3 inspektorë shëndetësorë dhe fal mbështetjes së Kabinetit qeveritar, numri është rritur në 7 dhe kanë filluar 7 që nga kjo vjeshtë dhe këta kanë arritur vetëm me 3 inspektorë që gjatë këtij viti të bëjnë më se 100 inspektime të institucioneve private ose 50 inspektime të institucioneve publike, kanë hartuar më se 210 raporte me rekomandime, janë dhënë më se 60 vendime të institucioneve, kanë dhënë përgjigje në të gjitha kërkesat e hulumtimeve specifike për çështjet e posaçme, e tjera. Kjo punë ka rezultuar me ngritje të vetëdijes profesionale të punëtorëve shëndetësorë, rritje të numrit të aplikantëve, e të tjera. Po ashtu, Inspektorati Sanitar, dëgjoni, gjatë këtij viti Inspektorati Sanitar i Kosovës ka bërë 8500 kontrollime në të tri nivelet, ka përpiluar 6579 raporte, ka lëshuar 950 aktvendime dhe urdhëresa, 520 kundërvajtje dhe ka asgjësuar mallra në vlerë prej 637.946 euro.

Sa për trajtimin jashtë vendit, ju jeni në dijeni, Kabineti qeveritar në krye me Kryeministrin ka lejuar rritjen për 400% të buxhetit për trajtim jashtë vendit dhe rastet që na kanë pritur ne që nga viti 2003, deri tash i kemi zgjidhur me transparencë të plotë dhe me një sukses të admirueshëm.

Sa i përket edukimit të vazhdueshëm, se vendit tonë i nevojitet dija, i kemi mbështetur të gjitha kërkesat për pjesëmarrje në tubime shkencore jashtë vendit, i kemi mbështetur të gjitha kërkesat për organizim të tubimeve shkencore në vend dhe kemi mjete që këtë mbështetje ta vazhdojmë.

Sa i përket realizimit të investimeve kapitale, zonja e zotërinj deputetë, jemi në fazë finale të realizimit të të gjitha projekteve. Në Ministrinë e Shëndetësisë aktualisht buxheti është i realizuar mbi 90% dhe ne presim që deri në fund të vitit, të arrijë maksimumin e mundshëm.

Nëse lejoni, kisha për të folur që pas shumë vitesh të përpjekjeve për themelim të Laboratorit të Agjencisë Kosovare të Produkteve Medicinale, ku pajisjen e kemi gjetur korridoreve, në pranverë të këtij viti ka filluar puna në Laboratorium dhe falë angazhimit të tyre dhe të ekspertizës së admirueshme, është fituar respekti që përmes procesit të IPA-s, të jetë një binjakëzim në mes të Laboratorit tonë dhe laboratorëve të Gjermanisë, të Sllovenisë dhe të Polonisë.

Sa u përket dështimeve disa dekadash për themelim të Onkologjisë, fal përkushtimit, ne kemi arritur që kjo të jetë në fazën e fundit dhe kjo të hapet shpejt. Sa i përket Intensives, unë e di që juve ju intereson, është lajm i mirë që puna në Intensive ka përfunduar dhe gjatë kësaj jave bëhet pranimi teknik i saj.

Sa i përket Kardiokirurgjisë, ne kemi argumentuar që kemi mjaft kapacitete që këtë projekt ta përfundojmë. Qeveria e Italisë është zotuar që do të paguaj për pajisje të Kardiokirurgjisë dhe për material shpenzues për tri vitet e ardhshme. Qeveria e Francës e ka marrë në konsideratë kërkesën tonë, që në kuadër të asistencës teknike të na sjellë një ekip të kardiokirurgëve për themelim të Kardiokirurgjisë dhe takimin e ekspertëve francez dhe të qeveritarëve francez e kemi më 12 dhjetor të këtij viti.

Sa i përket një çështjeje, të cilën ju e ngritët, e kanë ngritur para jush edhe shumë medime, këto ditë kemi pasur nderin që të kemi një raport fort të mirë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e cila i rikonfirmon konstatimet tona të fillim vitit.

1. Se gjendja është e paqëndrueshme,
2. Që nevojitet reformë dhe
3. Që gjatë asaj reforme duhet bërë saktësisht atë që jemi duke e bërë: rritjen e buxhetit për barëra, përmirësimin e shërbimeve dhe që ministrit Qeveria dhe Kuvendit t'i japin mandatin me të drejtë të vetos për të bërë reformën.

Për t'u realizuar reformat në shëndetësi, zonja dhe zotërinj, si në çdo vend të rruzullit tokësor, edhe në vendin tonë nevojitet një konsensus nacional.

Për agjendën legislative të vitit të ardhshëm, ne e kemi për të sjellë para jush Ligjin për shëndetësi, dhe atyre të gjithë së bashku duhet t'ua japim një përgjigje të re në raportin e mjekësisë private dhe të asaj publike. Ne e kemi disa rekomandime, për të cilat shpresojmë se ju do t'i merrni në konsideratë.

Të gjitha raportet thonë se sistemi i Stomatologjisë dhe profesionistët e stomatologjisë janë në nivelin më të lartë, qoftë me ekspertizë, qoftë me organizim dhe se në atë pjesë nuk nevojë të ndërhyrjes.

Dhe, në fund, për të ndodhur kjo, nevojitet një konsensus nacional, i cili do të kalojë prej një qeverie në qeveri dhe nevojitet një korrektësi. Ju faleminderit shumë!

KRYESUSI: Hvala gospodine ministre!

Dozvolite da pozdravim sve prisutne u sali. Ju përsëritet te gjithëve!

Pozivam šefove ili predstavnike parlamentarnih grupa, prema redosledu i raspoloživom vremenu da se uključe u interpelaciju. Normalno, po redosledu je Parlamentarna Grupa PDK. Pozivam predstavnika Parlamentarne grupe PDK, gospodju Selvije Halimi. Urdhëroni, foltorja është e juaja!

SELVIJE HALIMI: I nderuari kryesues,

Kryeministër, zëvendëskryeministër dhe anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Kur hapet debati për shëndetësinë në Kosovë, në vazhdimësi që nga paslufta e këndej ndahemi në dy tabore, një tabor që sheh vetëm zi dhe një tabor që sheh vetëm bardh.

Unë mendoj se të gjithë jemi përgjegjës për këtë se si është shëndetësia sot. Shëndetësia kërkon një vëmendje dhe qasje më specifike, si në hartimin e politikave shëndetësore, ashtu edhe në menaxhimin si duhet, për faktin se është një ndër lëmenjtë më të ndjeshëm dhe më të rëndësishëm për shoqërinë.

Problemet në sistemin shëndetësor në vend nuk kanë mundur të tejkalohen deri më sot si pasojë e mungesës së vullnetit dhe të punës së mirë, si pasojë e mungesës së përgjegjësisë dhe të përgjegjshmërisë për punë për vite me radhë nga ana e të gjithë aktorëve përgjegjës në shëndetësi. Kjo do të thotë se njerëzit të cilët marrin përgjegjësinë, duhet të kenë vullnetin e mirë, të duan të punojnë dhe të jenë dhe të ndihen përgjegjës dhe të përgjegjshëm për detyrat që ia ngarkojnë vetvetes.

Problemet kryesore me të cilat po ballafaqohet shëndetësia sot, e të cilat mjaft mirë i përmendi edhe ministri, si probleme të identifikuara, janë legjislacioni, strategjia shëndetësore, strategjia e resurseve humane, strategjia e shtrirjes së rrjetit të organizatave shëndetësore, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, konform standardeve dhe normativave, sistemi financiar, sistemi i informimit shëndetësor, sistemi menaxherial, niveli i shërbimeve shëndetësore dhe sistemi i kontrollit dhe i përgjegjësisë.

Në kontest të kësaj, Grupi Parlamentar i PDK-së rekomandon që Ministria me hapa të përshpejtuar të angazhohet në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit bazik të shëndetësisë dhe të ligjeve të tjera, respektimin e afateve për nxjerrjen e udhëzimeve administrative sipas ligjeve të cilat aktualisht janë në fuqi, renovimin dhe zgjerimin e infrastrukturës fizike në institucionet shëndetësore, në të dyja nivelet, ku përgjegjëse është Ministria, por edhe ndikimet në nivelin primar, ku përgjegjëse janë komunat, hartimin e strategjisë së rrjetit të shtrirjes së organizatave shëndetësore konform normativave dhe aprovimin e strategjisë shëndetësore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Deri më tash, në Ministrinë e Shëndetësisë ekzistojnë dy dokumente si strategji shëndetësore, një e hartuar në kohën emergjente, menjëherë pas luftës, dhe një më vonë, në vitin 2004. Mirëpo, sipas Ligjit të shëndetësisë, strategjia shëndetësore duhet të aprovohet në Kuvendin e Kosovës. Në Ministrinë e Shëndetësisë, zyrtarët të cilët bartin përgjegjësi menaxheriale ende deklarojnë se puna në shëndetësi bazohet në dy strategji të punës, të cilat japin mundësinë e nxjerrjes së vendimeve ad-hoc, apo hartimin e programeve dhe të projekteve të rastit apo të ndikimeve nga jashtë, siç ka ndodhur deri më sot.

Më pastaj, kërkohet që të bëhet hartimi dhe zyrtarizmi i protokollit të sëmundjeve që nga simptomat e para, diagnostimi, trajtimi dhe shërimi deri te rehabilitimi i plotë.

Zotëri ministër, deri më tash në mungesë të protokolleve të sëmundjeve, ne nuk po mund ta kemi një parallogaritje se sa kërkohet shpenzim për trajtim të një sëmundjeje të një pacienti konkret. Andaj, kjo kërkohet me urgjencë që të hartohet.

Krijimi i sistemit të qëndrueshëm financiar dhe menaxhimi i financave, duke llogaritur këtu nivelizimin e pagave në shëndetësi, dhe pagesat për rrezikshmëri në punë, pagesat e rregullta për punën në kujdestari, aprovimi i çmimoreve për shërbimet shëndetësore konform gjendjes ekonomike e sociale dhe aprovimi i çmimoreve për shërbimet vetanake, të cilat kryhen në institucione shëndetësore, në tërë sistemin shëndetësor si dhe mundësinë e përshpejtimit të sjelljes për aprovim të Ligjit për sigurimet shëndetësore.

Më pastaj, kërkohet ngritja e kapaciteteve menaxheriale nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm me qëllim të eliminimit të një problemi shumë të madh, me të cilin po ballafaqohet i tërë sistemi shëndetësor në vend, e që ka të bëjë me ndarjen e obligimeve

dhe të përgjegjësive në mes të punëve profesionale, administrative, gjegjësisht menaxheirale, dhe të punëve profesionale shëndetësore, që nënkupton reformat complete organizative, duke filluar nga vetë Ministria e Shëndetësisë e deri te të gjitha organizatat e tjera shëndetësore me qëllim të eliminimit të duplikimit të sektorëve organizativ dhe të ndarjes më të mirë të punëve dhe përgjegjësive, si dhe aplikimin e sistemit të matjes së punës për të dyja llojet e stafëve, si të atij administrativ, ashtu edhe të atij shëndetësor.

Mendojmë se duhet të bëhet përforcimi dhe rrjetëzimi i tërë sistemit të informimit shëndetësor dhe të kemi kyçje të rregullt dhe të drejtë, si të organizatave publike, ashtu edhe të atyre private në sistemin e informimit shëndetësor, të bëhet ngritja e nivelit të organizimit të sistemit të kontrollit dhe të përgjegjësive nëpërmjet inspektorateve, që për këtë pikë ministri i dha komentet se është filluar të punohet.

I nderuari ministër,

Këto rekomandime i jepen Ministrisë së Shëndetësisë me qëllimin më të mirë që të realizoni synimin e juaj të paraqitur, që zhvillimi i sistemit të qëndrueshëm shëndetësor dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për të gjithë vendin është synim i Qeverisë së Kosovës, i cili është i paraparë në programin qeveritar 2008-2011.

Për atë vitin e këtij synimi janë përcaktuar edhe pesë prioritete, të cilat janë të paraqitura po një këtë program. Synimi i Ministrisë së Shëndetësisë, gjegjësisht Qeverisë, është i paraparë edhe në kornizën afatmesme buxhetore 2009-2011, që do të thotë se kemi një kompatibilitet të plotë në mes të programit qeveritar dhe kornizës afatmesme sa i përket sektorit shëndetësor. Këtu duhet potencuar faktin se shëndetësia është ranguar si një ndër katër prioritetet e para të angazhimit qeveritar dhe gjithashtu kemi edhe ngritje të buxhetit për vitin 2009. Kjo do të thotë se ngritja do të vazhdojë edhe për vitin 2010 edhe vitin 2011. Me qëllim që të realizohet programi qeveritar dhe synimi i paraparë gjithashtu në kornizën afatmesme, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike kërkon nga ju që me hapa të përshpejtuar t'i zgjidhni këto probleme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Halimi! Në radhë është Grupi Parlamentar i LDK-së. Keni 6 minuta e gjysmë, zotëri Haziri, gjashtë e gjysmë, ne dva minuta, imate šest i po, jer je ministar potrošio 18 i po munta, imamo elektronsko računanje. Izvolite!

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit shumë, zoti kryesues, Kryeministër, deputetë të nderuar, ministër Gashi!

Informata e juaj në detaje sipas kërkesës së kolegëve nga Grupi Parlamentar i LDD-së, tregoi qartë se sa ka pasur nevojë që ky Parlament të njoftohet për gjendjen në sistemin shëndetësor.

Duke e pasur në konsideratë se pjesa që do të mbetet, pas fjalës sime do ta lëmë prapë mundësinë që ju të përgjigjeni, dëshiroj të konfirmoj edhe një herë që sistemi shëndetësor në Kosovë, sipas politikave tona edhe programit qeveritar është nën prioritet të lartë dhe trendet janë pozitive në kuptimin e rritjes buxhetore, të mbështetjes së domosdoshme.

Kosova e ka të domosdoshme reformimin e plotë, jo vetëm të këtij sistemi, por edhe të sistemit të gjyqësorit, edhe të sistemit të administratës publike, edhe shumë pjesëve tjera, por ne mbështesim prioritetin. Prioriteti më i latë mbetet shëndetësia si njëra nga shtyllat kryesore.

Ministri ka paraqitur disa herë nevojën e domosdoshme që të mbështetet edhe më shumë sistemi shëndetësor me buxhet, si mundësi e vetme për t'i përballuar problemet. Kjo Qeveri sigurisht që ka trashëguar probleme në këto tetë vite të jetës sonë në gjendjen e pasluftës, probleme kapitale që kanë të bëjnë me shëndetin publik dhe mundësinë tonë që të ndërhyjmë. Edhe më tutje mbetet për t'u bërë shumë dhe besojmë që mbështetja jonë e vazhdueshme për ministrin dhe sistemin shëndetësor do të ketë kuptim vetëm atëherë kur ne vazhdojmë ta trajtojmë si prioritet dhe vazhdojmë t'i japim buxhet më shumë, në mënyrë që të përballohen problemet që ka. Ne absolutisht e mbështesim konsensusin që u përmend këtu në arritjen e një fillimi të një procesit të madh çfarë quhet reformim i plotë i sistemit shëndetësor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala gospodine Haziri! Vama je preostalo još 5 minuta, dakle Parlamentarnoj grupi LDK.

Na redu je Parlamentarna grupa AKR, imate ukupno 11 minuta. Izvolite!

Ko se javlja? Gospodin Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Do të jem i kujdesshëm që këta minuta t'i shfrytëzoj drejt. Zoti ministër, seriozisht derisa po ju dëgjoja duke folur, thashë të lumtë ata që e dëgjojnë fjalën e juaj sot, sepse nuk e kanë problem nëse do të sëmuren me se gjithçka është në rregull.

Sikur e përshkruat ju gjendjen, nuk kemi ndonjë problem të madh, por kjo i bie në atë thënien: "operacioni u krye me sukses, pacienti vdiq". Zoti ministër, për fat të keq, gjendja në shëndetësi edhe ashtu nuk ka qenë e mirë dhe shumë qytetarë të Kosovës patën shpresuar se me ardhjen në krye të kësaj ministrie të një ministri që vjen pikërisht nga kjo fushë, do të ketë përmirësim të gjendjes, por për fat të keq, ne kemi përkeqësim të vazhdueshëm, që do të thosha se seriozisht duhet të gjithë ne të mendojmë se në cilën pikë gjendet sot sistemi i shëndetësisë në Kosovë dhe çka do të duhej të ndërmerrej.

Madje, për fat të keq, roli që ka pasur Ministria në këtë gjendje, është thelluar edhe më tepër për shkak të konfliktit të interesit që është shënuar jo rrallë herë në këtë Ministri. Madje, Ministria asnjëherë nuk ka arritur që të tejkalojë marrjen me vetveten dhe kjo është gjendja e cila është sot. E them me përgjegjësi se gjendja në shëndetësinë Kosovare nuk ka qenë asnjëherë, po e përsëris, asnjëherë më e keqe se sa sot, ndoshta që nga viti 1947 e këndej.

Unë besoj që edhe kolegët e mi do të prekin çështje që janë me interes, por do të përqendrohem vetëm një çështje, në tri pika shumë të shkurtra, sektori privat.

Zoti ministër, kohëve të fundit janë mbyllur disa klinika të cilat funksionojnë tash e disa vite. Kush do të duhej të japë përgjegjësi për atë se si kanë funksionuar deri tash ata në të kaluarën, ose ju, së dyti, burgosja e mjekëve, e kolegëve tuaj, zoti ministër, besoj se nuk do të duhej të kalohej kaq lehtë dhe pasojat që janë shkaktuar me rastin e arrestimit të tyre, sikur ata të ishin kriminel të dorës së parë dhe, për fund, zoti ministër, kam një pyetje për ju: A e ndieni veten fajtor për këtë gjendje të krijuar në shëndetësinë kosovare dhe çka, sipas jush, ose kush, sipas jush, do të duhej që të japë përgjegjësi për këtë gjendje të mjerueshme që e kemi? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala, gospodine Makolli! Vama je preostalo, vašoj grupi je preostalo još 7 minuta. Sledeća grupa jeste Alijansa, dakle AAK. Za reč se javila poslanica Zylfije Hundozi. Imate reč i 11 minuta.

ZYLFIJE HONDOZI: Zotëri kryesues,
Zotëri Kryeministër,
Ministra të pranishëm,
Kolegë deputetë,

Situata në shëndetësinë kosovare është e rëndë dhe po rëndohet dita-ditës për arsye se kjo Qeveri nuk ka arritur të zhvillojë politika të mirëfillta për shëndetësinë, të cilat jo vetëm që do ta përmirësojnë situatën e tashme, por do ta përmirësojnë shëndetin dhe do ta zvogëlojnë vdekshmërinë e popullatës së Kosovës.

Kosova edhe më tutje është vendi me vdekshmëri më të lartë të lehonave dhe të foshnjave në Evropë. Raporti i Organizatës Botërore Shëndetësore i dha vlerësimet e veta për shëndetësinë kosovare në mënyrë shumë reale dhe po më vjen shumë keq që e paske keqinterpretuar, zotëri ministër.

Për shkak të mungesës së politikave të mirëfillta, puna në institucionet publike shëndetësore nuk shkon si duhet. Punëtorët shëndetësorë ballafaqohen me mungesë të mjeteve themelore të punës dhe më i rëndë ky ballafaqim është gjatë kujdestarive, kur duhet t'u jepet ndihmë rasteve urgjente.

Keqmenaxhimet e kanë karakterizuar punën e institucioneve shëndetësore gjatë tërë kohës. Një shembull i kohëve të fundit, i cili na krijon paqartësi dhe dyshim është nxjerrja e Urdhërësës administrative e datës 16.10.2008, e cila është në kundërshtim me Ligjin për duhanin, gjegjësisht neni 6 të këtij ligji për shenjëzimin e pakove të duhanit gjatë importit dhe doganimit të tyre. Paqartësia është edhe më e madhe nëse dimë që ligjet ndryshohen vetëm nga Kuvendi i Kosovës, nëse jo, nuk di pse po rrimë ne deputetët këtu. Pra, e pyes Kryeministrin këtu se kush ka pasur të drejtë ta ndryshojë Ligjin për duhanin pa e pyetur Kuvendin e Kosovës? Është e qartë se kjo është bërë për përfitime personale.

Si pasojë e situatës së rëndë në shëndetësinë kosovare, numri gjithnjë më i madh i pacientëve tanë shkon për të kërkuar ndihmë mjekësore jashtë vendit, e ma ta një numër i konsiderueshëm i të hollave nga buxheti i Kosovës. Ky fakt tashmë është i njohur për të gjithë.

Sot u tha shumë për situatën e rëndë në shëndetësi prej kolegëve të mi, por vetëm konstatimet e gjendjes faktike nuk do t'i ndihmojnë shëndetësisë kosovare, prandaj unë do të jap disa sugjerime dhe tash e tutje flas, jo vetëm në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Kosovës, por edhe të profesionistit shëndetësor me përvojë 28 vjeçare.

Nën një, shëndetësia duhet të bëhet prioritet kombëtar i kësaj Qeverie. Por, prioritet kombëtar i të gjithë neve, të pozitës dhe të opozitës dhe besoj që kjo interpelancë do të jetë stimulues për gjetjen e zgjidhjes më të mirë që të dilet nga situata e sotme.

Urgjentisht të fillohet me përfundimin dhe implementimin e Ligjit për sigurime shëndetësore. Nëse do të ketë vështirësi, gjatë kohës mund të revidohen gabimet se është e qartë se pa financim të qëndrueshëm dhe efikas të shërbimeve shëndetësore, nuk ka funksionim të mirëfilltë të sektorit të shëndetësisë.

Financimi edhe me anë të sigurimeve shëndetësore nuk do t'i mbulojë të gjitha nevojat e shëndetësisë nëse mjetet financiare të dedikuara për shëndetësi nuk kursehen dhe nuk menaxhohen drejt, por keqpërdoren, praktikë e cila ka dominuar gjer më tani.

Problemin kryesor në mjekësinë terciare paraqet Qendra Klinike Universitare. Aty ka pasur shumë keqmenaxhime, po kjo qendër është e stërngarkuar me raste nga e tërë Kosova. Zgjidhja e duhur do të ishte ndërtimi i Spitalit të Prishtinës, ndërtimin e të cilit e kanë premtuar të gjitha partitë politike në programet e veta gjatë fushatave zgjedhore në shtatë vitet e fundit, por nuk doli asnjë ministër mjaft i fortë që ta zbatojë, në asnjë parti politike, e Prishtina ka më tepër nevojë për spital se ku ta dimë se për çka tjetër.

Ngritja e kuadrove shëndetësore, duke iu mundësuar që një pjesë të specializimit ta kryejnë jashtë vendit, mundësinë të cilën e kemi pasur në mjekët më të vjetër, të gjithë, pa përjashtim. Një vjet të specializimit e kemi kryer në klinikat më të njohura jashtë Kosovës. Tash është duke dominuar një praktikë e dëmshme dhe e pa shpjegueshme. Mjekët që po e kryejnë specializimin, të cilin po e paguan Qeveria, po lihen pa punë me vite të tëra. Shembulli i fundit është grupi prej 41 specialistëve, të cilëve iu ka ndarë kontrata për punë në QKU nga ana e Qeverisë, por në klinika nuk po i pranon askush në punë. Ata edhe më tutje po enden rrugëve të Prishtinës.

Nuk e kam të qartë çfarë strategjie është kjo, të investosh dhe në fund, si përfundim ta gjuash investimin në të cilin janë shpenzuar mjaft të holla të buxhetit të Kosovës. Por, edhe meqë punojnë, nuk janë në pozitë më të mirë.

Rritja e rrogave që u është premtuar në buxhetin e këtij viti të paraqitur në këtë Kuvend, nuk figuron askund, që do të thotë se rritja e premtuar e rrogave në realitet nuk ekziston. Kjo është edhe një lojë me dinjitetin e punëtorëve shëndetësorë. Loja tjetër ka qenë burgosja spektakulare në prezencën e medie, që ka qenë prekëse, sidomos për pacientët, të cilët ata mjekë i kanë shëruar.

Menjëherë, të nesërmen janë lajmëruar shumë pacientë për trajtime mjekësore të frikës dhe të ankthit të cilat janë shkaktuar nga skenat spektakulare televizive, duke na thënë se nëse kështu mund të veprohet me elitën e shoqërisë, çka do të na bëjnë në njerëzve të thjeshtë. Kush di të lexojë mes rreshtave, kuptohet mirë se çfarë imazhi ka krijuar ky shtet për vetveten.

Burgosja në prezencën e kamerave, duke i dhënë kësaj ngjarjeje më shumë publicitetet se çfarëdo artikulli ushqimor që duhet të shitet, jo vetëm që ka qenë shkelje flagrante e të drejtave të njeriut, por ka qenë një veprim pa kripë e pa shije, duke zgjuar dyshime se po fshihet diçka dhe po tërhiqet vëmendja nga ndonjë ngjarje me rëndësi, të cilën duhet fshehur sa më gjatë, që u vërtetua më vonë. Pa i përkrahur punëtorët shëndetësorë, duke iu mundësuar që ta kryejnë punën e vet me dinjitet, nuk do të ketë shëndetësi të mirëfilltë. Njerëzit janë ata që e kryejnë punën, jo objektet dhe aparatet.

Njëherësh, duhet të sqarohet puna në institucionet private dhe ato publike, duhet të diferencohet, gjegjësisht duhet të gjendet një rrugë, të cilën, në këtë drejtim e kanë ndjekur fqinjët tanë. Këtë fakt në vetvete do ta pranojnë të gjithë profesionistët shëndetësorë dhe ata që e donë shëndetësinë.

Komisioni për shëndetësi, në mandatin e kaluar, në raportin e vet për monitorimi e Ligjit për shëndetësi ka dhënë shumë rekomandime, të cilat janë ende aktuale, se ju shumicën e rekomandimeve nuk i keni zbatuar, siç është formimi i sistemit informativ, pa të cilin nuk mund të funksionojnë institucionet shëndetësore, formimi i Komitetit etik dhe të Bordit etik, që do t'i zgjidhë çështjet morale dhe etike në shëndetësi, planifikimi me kohë i nevojave për barëra nga lista esenciale dhe kryerja e procedurave të prokurimit me kohë, në mënyrë që të mos mbesin institucionet pa barëra nga lista esenciale dhe shumë rekomandime të tjera të cilat me të vërtetë do t'ju ndihmonin shumë.

Nuk ekziston vetëm një njeri që i di të gjitha. Puna ekipore sjell rezultate më të mira. E di që është iluzore që të presim përmirësime të menjëhershme pas situatës në të cilën ka qenë shëndetësia këto nëntë vite, por një mobilizim intensiv i Qeverisë, duke e ndërruar qasjen ndaj këtij sektori, gjegjësisht duke e kthyer në prioritet kombëtar shëndetësinë, mund t'i kthejë punët për së mbari. Edhe mediat mund ta ndihmojnë shëndetësinë, duke u angazhuar që puna e tyre të jetë e paanshme, duke e prezantuar gjithmonë të vërtetën dhe duke i paraqitur ngjarjet një kuptimin e plotë të tyre, pa e mbajtur anën e askujt dhe t'i llogarisin mirë efektet që do t'i mbërrijnë reportazhet e tyre te të sëmurit dhe punëtorët shëndetësorë. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Hvala i vama poslanice Hundozi! Još dava minuta vam je ostalo. Sledeća na redu je pokretač interpelacije, Parlamentarna Grupa LDD, šef Parlamentarne grupe Lulzim Zeneli. Imate 11 minuta, gospodine Zeneli!

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kryeministër,

Anëtar të Kabinetit qeveritar,

Së pari, në kuadër të kërkesës për interpelancë dhe arsyeshmëria e cila është dhënë në fjalën hyrëse, po edhe një gjë duhet ta kemi të qartë se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka shtruar kërkesë dhe kjo kërkesë është miratuar në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, që në fund të debatit të sotëm të votohet mocioni i Grupit Parlamentar të LDD-së. Prandaj, do t'i kemi edhe 5 minutat e fundit që do të bisedojmë lidhur me rekomandimet e mundshme që Grupi Parlamentar synon t'i adresojë.

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryeministër,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Ka 9 vite qysh se sistemi shëndetësor në vend ka hyrë në një gjendje alarmante, lirisht ta quajmë katastrofike, ka 9 vite që shëndetësia kosovare dergjet, ndërsa në vitin e pavarësisë Ministria e Shëndetësisë pothuaj se po e vulos fatin e përbuzjes, të injorimit, të thyerjes së dinjitetit të mjekut, të mantilbardhit dhe, përfundimisht me këtë, edhe të thyerjes së dinjitetit të pacientit kosovar.

Organizata Botërore e Shëndetësisë shumë qartë e dha porosinë dhe bëri një krahasim me një kompani publike, lirisht ta quajmë kompani private. “Në qoftë se një kompani private do të menaxhohej në këtë formë, siç menaxhohet Ministria e Shëndetësisë, për një muaj ditë do të falimentonte”. Ky ishte citati.

Kjo do të ishte porosia më e qartë për Qeverinë e Kosovës, për Kryeministrin e Kosovës, fundi i fundit, është mandatar i kësaj Qeverie. Ajo çka duhet të theksohet se me këtë filozofi me të cilën udhëhiqet kjo Qeveri lidhur me shëndetësinë kosovare, nuk

është asgjë tjetër përpos, lirisht ta quajmë, amoralitet dhe fizkulturë e llojit të vet, që di ta bëjë vetëm Ministria e Shëndetësisë.

Nëse keni përcjellë fushatën denigruese dhe tejet fyese, që ka shkuar në pafundësi, të Ministrisë së Shëndetësisë ndaj mjekut, punëtorit shëndetësor, e që në fatkeqësinë tonë sot mjeku u barazua dhe u vendos në rangun e kriminalitetit ordiner, politika e kësaj Qeverie mund të kuptohet me burgosjen spektakulare të mjekëve, të profesorëve të Universitetit, mund ta kuptoni nëse keni përballë, që nuk u theksua këtu, vendimin e fundit të Ministrisë së Shëndetësisë që pacienti kosovar të paguaj para goxha të majme për qëndrimin në spitale tona, në ato spitale ku barërat mungojnë, ku trajtimi higjienik sanitar është katastrofik, ku ushqimi kundërmon, e të kërkosh para prej qytetarëve të varfër në këto kushte, ku spitalet tona nuk mund të ofrojnë asnjë nga këto shërbime, është më shumë se ironi.

Ministria e Shëndetësisë, i nderuar kryesues, është sinonim i tenderëve, është sinonim i keqpërdorimeve, është sinonim i skandaleve dhe abuzimeve. Meritat më të mëdha për këtë gjendje të mjerueshme të shëndetësisë kosovare, e kanë pikërisht, tash po e them, e kanë pikërisht partnerët e koalicionit qeverisës, të cilët prej periudhës së pasluftës kanë koketuar me fatin e shëndetësisë kosovare. Thënë shkurt, shëndetësia kosovare është në fund të pusit dhe nuk ka ku të shkojë më keq.

Raporti i fundit, edhe njëherë po e them, i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, duhet ta ndërgjegjësojë përfundimisht Qeverinë e Kosovës sa i përket shëndetësisë.

Fjala publike do të duhej të peshonte sot. Edhe fjala e ministrit dhe e Kabinetit qeveritar duhet të peshonte për arsye se për këtë gjendje të rëndë është premtuar mjaft, është premtuar mjaft, është sinjalizuar se do të bëhen ndryshime radikale, por deri sot këto nuk po ndodhin.

Po theksoj disa nga argumentet, për të cilat ministri Gashi u shpreh këtu se ka ndryshime spektakulare shumë të mëdha.

Zoti kryesues, sot në dhjetor, ende nuk është implementuar Vendimi, Udhëzimi administrativ për barnatoret publike, që është nënshkruar nga ministri Sadik Idriz, më 1.01.2008, dhe është dashur të implementohet. Për çka bëhet fjalë këtu? Është dashur që barnatoret publike të funksionojnë në tërë sistemin shëndetësor, në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare. Në këto objekte sot funksionojnë barnatore private. Kjo nuk është bërë dhe po vazhdon të shukatet për këtë problematikë.

Deklaratat e ministrit se kemi përmbushur 70% të barërave nga lista esenciale, si po e mendon ashtu? Nëse 70% është nga llojllojshmëria e barërave të listës esenciale, kjo nuk do të thotë asgjë. Ai mund t'i blejë vetëm 10 pako prej secilës pjesë dhe të thotë se kemi përmbushur 100%. Po, kjo nuk do të thotë asgjë se, sa i përket sasisë, kjo as 5% nuk i mbulon nevojat e qytetarëve dhe të pacientëve. Qeveria e Kosovës pati premtuar barëra falas për pensionerë. Deri sot kjo nuk është realizuar.

U fol shumë për raportin lidhur me Medikusin e famshëm ditëve të fundit. Sipas policisë, aktivitetet e kundërligjshme të Medikusit kanë filluar më 24. mars 2008, ndërsa mjeku turk është licencuar nga ministri Gashi më 9 maj 2008. Çka do të thotë kjo? Do të dojë përgjigje edhe kjo.

Burgosjet spektakulare, ofendimi më i madh që iu ka bërë strukturës, superstrukturës intelektuale të shëndetësisë, është më shumë se fatkeqësi dhe fyerje e dinjitetit të punëtorit shëndetësor, të mjekut dhe fyerje e dinjitetit të shëndetësisë kosovare në përgjithësi.

Të nderuar qytetarë, se e di që na përcjellin, me këto kalkulime, me këtë gjendje, me këtë performancë çfarë e tregon kjo Qeveria jonë, sot tregon më së miri se nuk është e interesuar ta ndryshojnë gjendjen, nuk është e interesuar të kujdeset për pacientin dhe punëtorin shëndetësor. Kjo do të mbetet në ndërgjegjen e ardhshme se si do të krijohet situata në të ardhmen. Lirisht fol për shëndetësi dhe sot është më shumë se ironi t'i dëgjosh deklaratat pompoze që po shprehen me këtë rast. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala gospodine Zeneli! Parlamentarnej grupi LDD preostalo je još 4 minute. Po redosledu, Parlamentarna grupa „7+“, gospodin Sadik Idriz. Izvolite!

SADIK IDRIZI: Hvala predsedavajući!

Članovi Kabineta,

Ministar Gaši,

Kolege poslanici,

Stanje u zdravstvu je i dalje nezavidno i potrebna su sistemska rešenja. Nigde ne postoji besplatno zdravstvo i to ako neko misli, onda je to zaista pogrešan korak. Nigde u svetu ne postoji besplatno zdravstvo. Mi želimo dva sistema u jedan sistem da spojimo, što je nemoguće. Ne možemo imati mišljenje da ćemo imati zdravstvo iz perioda komunizma, a da ga implementiramo danas u ovoj ekonomiji kakva jeste.

Pored činjenice da ima pokušaja da se odredjene stvari promene, međutim svaki pokušaj nailazi kod medija na nož, jer u zdravstvu to je praksa više godina da samo loše vjesti su dobre vjesti. Svaka dobra vjest, u zdravstvu nije vjest za naše medije i to je problem koji nas prati gogovo svih ovih godina.

I pored činjenice da je povećan budžet za farmaceutiski sektor u 2008. godini za 100%, takodje i za kategoriju lečenja van zemlje, mislim da problemi ostaju, jer i dalje zdravstvo nije prioritet. Ne može biti prioritet zdravstvo ako na Kosovu ukupan budžet ne iznosi 90 miliona za oba sektora, odnosno za sva tri sektora, i onaj koji se menadžira na primarnom zdravstvu, koji se menadžira od strane opština, jer ne iznosi ni 90 miliona eura ukupno za zdravstvo, koliko se izdvaja u budžetu Kosova.

Samo radi uporedjenja, Crna Gora koja ima 650 hiljada stanovnika, znači tri puta manje nego Kosovo, a ima budžet oko 150 miliona eura, ili Makedonija, koja ima isti broj stanovnika kao Kosovo, ima 280 miliona eura za zdravstvo. Slovenija ima isti broj stanovnika, ima oko milijardu i po godišnje za zdravstvo, Albanija ima 153 eura po glavi stanovnika, dok Kosovo ne dostiže ni 50 eura po glavi stanovnika godišnje i to je na nivou Džibutija. Sa takvim budžetom, vi i da ste i najbolji menadžer, ne možete da očekujete neke stvari u nečemu što je nasleđeno svih ovih godina nakon rata.

Bez Zakona o zdravstvenom osiguranju, koji je prošao oba čitanja u ovom parlamentu i nije potpisan zbog budžetskih implikacija koje su bile prikazane veće nego što jesu, i bez formiranja Fonda za zdravstvo ne može biti uspeha u zdravstvo i ne može Ministarstvo da se bavi, unutar ministarstva da se bavi raznim stvarima i tenderima ili sklapanjem ugovora sa privatnim institucijama. To je pitanje fonda i bez formiranja fonda mi ne možemo imati jedno uspešno zdravstvo na Kosovu.

Radnici u zdravstvu su nezadovoljni ličnim primanjima i to traje, nakon rata gotovo da nije bilo povećanja. Vi ne možete očekivati najbolje rezultate od medicinskog radnika sa srednjom školom koji nema 150 eura, ili doktora specialiste koji ima 250 eura. Bilo je obećanje od 44 eura, još nije realizovano. To je bilo obećano da se prekine štrajk i mislim da su te stvari više puta kod radnika zdravstva ponavljani i da se gubi kod njih jedno poverenje u institucije, što nije dobro obećati ako se ne ispuni na vreme.

Zadnja hapšenja su išla na štetu dostojanstva zdravstvenih radnika. Možda Ministarstvo nije imalo direktnog upliva, ali video sam da je Inspektorat bio uključen i išlo je to na štetu dostojanstva zdravstvenih radnika. Sigurno da ima radnika koji zaslužuju da..., to nije naša stvar, ali mislim da način na koji se to radi, treba da bude sa nekim dostojanstvom, odnosno da se sačuva dostojanstvo radnika. Radnici u zdravstvu, često puta dešava se nakon toga da su u teškoj situaciji da pokrenu bilo koju aktivnost, jer se mogu pacijenti žaliti, pokreću se tužbe i dako dalje. Dešava se u zdravstvu da pacijenti i umru, međutim kod nas se dešava da se to veoma teško doživljava jer se odmah podigne prašina da je umro pacijent. Pacijenti umiru i u najrazvijenim zemljama, ali se ne pravi skandal zbog svake greške kao što je to kod nas.

Mi možemo govoriti, ovde smo čuli da je stanje, da ne kažem katastrofalno, od strane onih koji su predlagali interpelaciju, po izlaganju ministra, nije tako stanje, stanje mnogo bolje. Mislim da o stanju u zdravstvu najbolje znaju pacijenti kakvo je, i znaju zdravstveni radnici koji rade tamo. Mi možemo govoriti da je stanje odlično ili loše, oni najbolje znaju u kakvoj je situaciji naše zdravstvo.

Problem koji se dešava sa stalnim sekretarom i stalnim sekretarima u ovom ministarstvu nije samo tu, to je problem koji je zadnjih godina bio i u drugim ministarstvima. Ja ne znam zašto se ovi sekretari i dalje zovu stalni sekretari, premanenti i tako dalje. U svim zemljama zovu se državni sekretari i na Kosovu treba jednom da se ti sekretari zovu državni sekretari i da oni dolaze sa ministrom, a da postoji direktor Ministarstva koji se bavi civilnim osobljem, jer često puta dođe ministar iz druge garniture, zadrži starog sekretara, gde se stvaraju različiti sukobi. Mislim da sekretari dolaze sa ministrom i da oni imaju odprilike da implementiraju politiku ministra a da direktori vode i menadžiraju civilni staf. Inače, ministar ima odredjenih prednosti u odnosu na dosadašnje ministre koji su dolazili iz manjinskih grupacija i zajednica i koji su dolazili iz manjih partija, koje nisu bile uticajne niti imale jači lobi u Vladi ili u parlamentu, a takodje i na terenu u institucijama zdravstva i to je vjegova prednost za razliku od tri ministra koja su bila do sada iz manjinskih partija.

Kao Komisija za zdravstvo, ja sam na čelu te komisije, radili smo ono što je došlo. Ja nemam pravo da govorim u ime te Komisije, svako ovde u ime svoje parlamentarne grupe ima pravo da govori. Međutim, zakone koje su do sada bili u toj komisiji, odradili smo i imamo još monitoring Zakona o privatnoj delatnosti i biće pripremljen izveštaj narednih nekoliko dana koji će biti dostavljen Parlamentu.

Ministru želim puno uspeha u radu i mislim da jedan pristup koji bi bio jači, znači da Vlada zaista stavi zdravstvo u prioritet i da zdravstvo Kosova nekako se pokrene. Za sada stojimo negde, i kada ima nekih rezultata, nisu vidljivi. Hvala!

KRYESUESI: Hvala, gospodine Idrizi! Na redu je Parlamentarna grupa SLS. Pozivam, ima li predstavnika koji će dati komentar u ime te parlamentarne grupe. Gospodin

Branislav Grbić, imate reć. Takodje imate na raspolaganju, vi znate koliko imate članova parlamentarne grupe najbolje i toliko minuta imate. Hvala!

BRANISLAV GRBIĆ: Pa, naše parlamentarne članove je teško okupiti, ali dobro, ja ću uspeti da kažem ono što znam i od prilike ono što smatram da treba reći u vezi zdravstva Kosova.

Sigurno, kao učesnik u tom Ministarstvu, znači već jedan period, smatram da rešavanje problema zdravstva je vrlo jedan složen i kompleksan problem koji je pre svega institucionalni problem i sigurno ti problemi ne mogu da se reše preko noći, bez obzira o kojoj vladi se radi. To je problem koji je smisao čitavog opstanka jednog društva i kao takvo, znači, svi građani su uključeni u problem rešavanja i smatram da treba da budu uključeni i njihova želja je da budu zdravi građani Kosova i sigurno naša obaveza kao institucije, znači jednog dela Vlade Kosova, odnosno Ministarstva, da u tome i tu šansu omogućimo, ali u skadu sa našim mogućnostima, znači sa mogućnostima koja ova Vlada i u skladu sa budžetom i privredom, i privrednim razvojem Kosova. Sigurno je da te želje mogu još uvek ostati na nivou nekih fantazija i sigurno je potrebno dosta vremena da ceo jedan sistem organizovanog društva krene ka boljitku, odnosno ka poboljšanju samog standarda života u kome je uključeno, normalno, i socijalno siguranje i samo zdravstvo. I prema tome, smatram da jedan čovek, jedan ministar, kao deo jedne vlade, može pružiti onoliko koliko su njegove mogućnosti i koliko mu vreme, odnosno novac dozvoljava da tu svoju kreativnu politiku i ostvari. Sigurno, u tom kontekstu moguće je da su neke tehničke greške u pitanju, znači promena koraka, ali suštinski, znači namere su sigurno da taj jedan sistem zdravstva zaživi i da on pokaže izvesne rezultate. Period od godinu dana je suviše mali da bi pričali o nekim rezultatima i mogućnost za razvoj zdravstva je sigurno, znači, budućnost Kosova. U tom kontekstu, znači, vidim i dalju politiku koja sigurno da ima te šanse i mogućnosti onoliko koliko je i sama Vlada spremna da se uključujući u rešavanje jednog takvog segmenta kao što je zdravstvo.

I ono što mogu da kažem kao učesnik u Vladi, odnosno kao bivši ministar i sve, da je osnova u problemu ministarstva, rad odnosno odnos između političkog stafa i dela administracije u kome su uključeni, kao što je nabavka, kao što je sekretar i sigurno da tu ima dosta problema u smislu da, znači, i sama javna nabavka je jedan od vrlo bitnih faktora razvojne politike Ministarstva. U kontekstu znači da javna nabavka treba da prati razvojnu politiku ministarstva i da omogućava da svi projekti, sve kupovine i sve bude transparentno i da budu u vremenskom roku koliko sam taj sam godišnji budžet dozvoljava. Ja bih još jednom želeo da kažem da sigurno, mislim, ne sumnjam u iskrene namere gospodina ministra Gašija i sigurno smatram da će ova vlada i ovo zdravstvo sigurno dati rezultate.

KRYESUESI: Hvala vam gospodine Grbiću. Evo, da vas informišem, na redu su sada otprilike poslanici parlamentarnih grupa, koji nemaju parlamentarne grupe. Oni imaju ukupno 10 minuta i za sada imamo dva prijavljena: Numana Baljića i gospodina Arsima Rexhepija. Oni samim tim, dele po pet minuta. Evo, izvolite, dajem vam reć gospodine Baljiću!

NUMAN BALJIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući! Selam svima koji su ovde prisutni. Želio sam da kažem nekoliko važnih riječi koji se tiču sektora zdravstva i stanja u zdravstvu sa aspekta čoveka koji se ovim pitanjem bavio na najvišoj poziciji i sa aspekta građanina i zabrinutosti koje dijelimo, naravno, sa celokupnim narodom za stanje zdravstva u zemlji.

Kao što znamo, stanje zdravstva na Kosovu je, nažalost, veoma loše i to je činjenica koju ne može niko poreći. Na nama je, dakle, da nadujemo način kako da izidjemo iz teškog stanja u zdravstvu. Svi koji su govorili o ovom pitanju su pobrojali mnoge razloge. Međutim, ovde treba odabrati najvažnije razloge i pristupiti rešavanju tih razloga i ukupnih situacija u zdravstvu. Naravno da nije dovoljno da postoji akcija unutar samog Ministarstva zdravlja, nego da je vrlo važno da postoji jedna veoma dobro sinhronizovana i koordinisana energična akcija Ministarstva i Vlade Kosova. Vlada Kosova mora konačno staviti zdravstvo kao nacionalni prioritet, što do sada nije urađeno. To je propust svih dosadašnjih vlada i svi pokušaji koji su bili u rešavanju ovog pitanja, uglavnom su završavali na nivou eksperimenata. Jedan od tih eksperimenata su naravno bile i famozne komisije, pa onda nove komisije i stalno nekakve komisije koje su osnivane.

Ovde imamo nekoliko ključnih problema, na koje moramo naći odgovor. Jedan od problema je, recimo, budžet. Pare su naravno problem, ali sa parama se ne rešava sve. Vi možete dati milijarde evra u nečije ruke, ali on će ih potračiti i neće ih znati upotrebiti. Ali efikasno upotrebljavanje budžeta, čemu se treba konačno naučiti i unutar Vlade, i unutar Ministarstva, jeste prava stvar na koju moramo naći odgovor.

Druga stvar je menadžiranje. Menadžiranje je najteža bolest od koje boluje Ministarstvo zdravlja. Vjerujte da naći pravi odgovor za dobro menadžiranje je u stvari rešavanje problema sistema zdravstva. Ali, nije dovoljno da ministar i njegovi glavni pomagači, savjetnici, potom šefovi glavnih stubova da jedino oni rade na tome. Oni moraju imati podršku cjelokupne vlade, sa primjerom na čelu. Premijer mora pružiti ruku ministru, uprotivnom ne može se riješiti problem menadžiranja. Ako imamo, govorim veoma otvoreno, na umu gradju unutar Ministarstva, potom rukovodjenje na najvišim nivoima, Klinički Univerzitetski Centar ČKU – famozni, potom regionalne bolnice, familjarnu medicinu, institute zdravlja i sve ostale institucije – gdje uvijek postoje neki ljudi koji djeluju ne samo po stručnoj osnovi, nego vrlo često i po stranačkim odnosno partijskim, pa se vrlo često dešava da ministar ne može dijelovati ili mu podmeću klipove zato što je neko na nekoj drugoj strani. Dakle, mora se napraviti nacionalna strategija, gde će se poštovati ta strategija i gde će prvi čovek u Ministarstvu dobiti jasnu i snažnu i iskrenu podršku. U protivnom, nema uspjeha.

Druge stvari koje se tiču ovog pitanja, jeste konačno stavljanje reda u sektoru farmacije, odnosno lijekova. Više od 100 miliona evra je do sada Vlada Kosova izdvojila za lijekove. Molim vas, ja sam juče bio kod mog velikog prijatelja i kolege, stomatologa Adnana, koji godinama radi u protetici. Oni nemaju alkohola u bocama, oni rade sa vodom umesto alkohola. Kako ćemo liječiti zdravlje nacuje, zube naše djece i omladine i ljudi ako nemamo alkohola u flašama kojima radimo. Stanje je očajno. Nemojmo e zavaravati i govoriti da postoje neke stvari koje su, napreci na papiru su jedna stvar, ali napreci u stvarnosti su druga stvar. Tako da, glavna poruka jeste da ključne stvari koje se tiču jeste sinhronizovana akcija i, naravno, rešavanje vrlo važnih poluga koje se tiču sistema zdravstva, a to je konačno pokretanje šeme zdravstvenog osiguranja. Bez rešavanja, bez početka finansiranja sistema zdravstvenog osiguranja, nema lijeka zdravstvu. Sistem zdravstva će biti bolesnik ako se ne pokrene sistem zdravstvenog osiguranja. Uprkos nekih utješnih riječi da navodno pare ne čine sve i da nema nigde besplatnog zdravstva u svijetu, mi ovde na Kosovu imamo najsiromašnije stanovništvo u Evropi. Molim vas, ljudi na Kosovu nemaju para da plate svoje liječenje. Dakle, država mora intervenisati i moramo pokrenuti, moramo izdvojiti novac koji je potreban za šemu

zdravstvenog osiguranja. Ili one riječi da mi imamo zakonsku infrastrukturu i tako dalje, i tako dalje. Pa, mi imamo zakone. Imamo zakone o osiguranju, ali nemamo osiguranja. Dakle, ne pomaže nam ni donijeti budžet, niti donijeti zakoni ako nemamo novca, ljude i mogućnosti da pokrenemo taj cijelokupni sistem i, da na kraju završim, plate. Bez povećanja

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hvala, gospodine Baljiću. Gospodo evo, dugujem vam objašnjenje. Sada prelazimo na preostalo raspoloživo vreme. Svaka parlamentarna grupa obavestiću vas koliko još ima minuta za interpelaciju. Parlamentarna grupa PDK ima 30 minuta, Parlamentarna grupa LDK ima 5 minuta, Parlamentarna grupa AKR ima 7,5 minuta, Parlamentarna grupa AAK 2 minuta, LDD ima 4 minuta, Parlamentarna grupa “7+!” je potrošila svoje vreme, Parlamentarna grupa SLS ima još 3 minute. Dakle, pozivam predstavnika Parlamentarne grupe PDK i ko se javlja za riječ. Dakle, idemo po redosledu. Ne, nemamo pauzu za sada, izvinite jer moramo da iscrpimo interpelaciju i idemo dalje. Dakle, po redosledu, Ibrahim Gashi. Izvolite, gospodine Gashi, imate riječ i na raspolaganje imate 7,5 minuta.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje zoti zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,

Zoti ministër, me gjithë respektin që kam për ju dhe konsideratat për gjendjen në shëndetësi që e keni trashëguar, më duhet t’ju them se janë plot dhjetë muaj që ne në këtë foltore jemi mësuar të dëgjojmë të njëjtin refren, me të njëjtin intonacion, nga ana juaj për sukseset në shëndetësinë e Kosovës.

Si qytetar dhe pacient i mundshëm, por edhe si joprofesionist, dua t’i fokusoj tri probleme. Ju flisni për zgjerimin e listës esenciale të barërave derisa para disa ditësh unë dua t’ju kujtoj se në mediat e Kosovës kemi dëgjuar se Qendra Klinike Universitare ka mbetur pa një ilaç esencial, pra pa Trodon dhe Morfium dhe njerëzit kanë qenë të detyruar të vuajnë dhembjet deri në vdekje për një mungesë kaq banale. Dhe, kjo për mua është një shqetësim tepër i madh dhe mendoj për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Së dyti, vërejtjet që vijnë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë janë më shumë se të qarta për ata që duan t’i kuptojnë dhe tash kjo është kontradikta më e madhe që krijohet në opinion. Ju flitni për suksese, Organizata e Shëndetësisë flet për bankrotim të shëndetësisë kosovare dhe kjo për mua është diçka që nuk kisha dashur të dëgjoj më nga ju, domethënë, fjalën “sukses”.

Pastaj, së treti, mediatizimi i arrestimit të mjekëve. Ju vetë na keni folur edhe në këtë foltore edhe individualisht se keni hetuar, domethënë keni evidentuar dhe konstatuar hajni shumë të mëdha në shëndetësinë e Kosovës, kështu që ne kemi pritur që të kemi arrestime spektakulare të atyre keqpërdoruesve në shëndetësinë e Kosovës dhe jo të profesorëve të respektuar të Universitetit të Prishtinës, me përmasa rajonale dhe botërore, të cilët, në çdo kohë që do t’i kishit thirrur në hetuesi, do të kishin ardhur me shumë kënaqësi, sepse jemi të gjithë ne, domethënë që e kuptojmë natyrën e punës dhe jemi aq të përgjegjshëm përpara shtetit dhe pushtetit tonë.

Në fund, nuk mbetet kurrgjë të them tjetër vetëm e përfundoj fjalimin tim si deputet ku opinionin e Kosovës i ka sytë te ne dhe ne në njëfarë mënyre mbahemi si përgjegjës për

këtë gjendje, pavarësisht a jemi në pozitë a në opozitë. Unë dua nga kjo foltore, si deputet i Kuvendit të Kosovës, t'u kërkoj falje të gjithë pacientëve për gjendjen dhe për vuajtjet e tyre në të cilën i ka vu shëndetësia e Kosovës dhe njëkohësisht t'i falënderoj të gjithë ata mjekë dhe infermierë që punojnë në këtë gjendje, që rrinë atje për 200 euro, kujdestarojnë 24 orë dhe ne flasim këtu diçka që me të vërtetë nuk korrespondon me asnjë parametër me realitetin që e kemi atje.

Edhe njëherë kisha dashur që ta thërrasim arsyen, sepse jemi njerëz të përgjegjshëm dhe, mbi të gjitha, ata që mbajnë poste drejtuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala, kolega Gaši! Imate još četiri minute vaša Parlamentarna grupa. Sledeći prijavljani je gospodin Berim Ramosaj. Gospodine Ramosaj, imate rije!

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, edhe pse jam laik i mjekësisë, dua ta jap atë kontributin tim. Vërtet, duke u mbështetur në imputet që kemi nga shëndetësia e Kosovës dhe gjendja në shëndetësinë e Kosovës, desha të them se ajo na tregon për sinjale, vërtet shumë të rënda të shëndetësisë kosovare, andaj sjelljet e sotme të ministrit ishin vërtet jo në harmoni me gjendjen e shëndetësisë. Pra, nga diskutimet e deritashme u tregua se ministri nuk ka të bëjë me interpelancën e LDD-së, por me shqetësimin e të gjithë qytetarëve dhe të gjithë deputetëve, shumicës së tyre në këtë Parlament, andaj sjelljet e tij për kolegët e vet deputetë nuk i kanë hije një individi, i cili vërtet dëshiron të jetë ekzekutues i qëndrimeve, respektivisht i strategjisë, në qoftë se ka për shëndetësinë e Kosovës.

Më vjen keq doktor, por me gjithë respektin që kemi pasur kur keni marrë këtë dikaster, kemi menduar se më në fund shëndetësia e Kosovës e nëpërkëmbur, e lënë në duar të ministrave që nuk kanë pasur lidhje për këtë drejtim, për këtë fushë, kemi menduar se e kemi gjetur profesionistin e duhur, por u mashtruam të gjithë. U mashtruam, sepse gjendja e shëndetësisë në Kosovë tregon për këtë mashtrim. Mirëpo, nëse Qeveria Thaçi dhe koalicioni qeveritar vërtet mendon se Ministria e Shëndetësisë po punon mirë, numrat i kanë, mund ta mbështesin këtë, por të dimë një gjë se para qytetarëve të Kosovës do të bëhen bashkëpërgjegjës për këtë gjendje të shëndetësisë së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Berim! Vama je preostalo još 2 minute. Sledeći govornik je Shkumbin Demaliaj. Kolega Demaliaj, izvolite! Imate četiri minute.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kryeministër, Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë, për të mos u marrë kohë të gjatë, meqenëse e kemi të shkurtuar mundësinë për të diskutuar të gjithë dhe e kemi minutazhin e përcaktuar, e kemi një afat shumë të shkurtër, kanë kërkuar që edhe kolegët tjerë nga Grupi ynë Parlamentar të diskutojnë sot, kisha pasur dëshirë ta prek një çështje shumë me rëndësi e të kuptohet se a ka dy qeveri Kosova në kuadër të koalicionit, apo është një kryeministër dhe ministrat? Në këtë rast, kisha pasur dëshirë të kërkoj të njoftohem brenda rezymimit të përgjithshëm kur e bën ministri në fund, se a është kah e implementon vendimin e Qeverisë për punësimin e specialistëve të shëndetësisë kosovare? Pra, ka filluar implementimi i pjesërisht në disa rajone, mirëpo në QKU janë 49 specialistë që kanë marrë kontrata të punës dhe menjëherë pas datës 4 nëntor, më 14 nëntor drejtori i QKUK-së thotë se duhet të hapet konkursi për këto vende të punës dhe thotë se është mungesë e buxhetit. Ministri na informoi se ka buxhet të mjaftueshëm, është rritur buxheti për 200%, 400% edhe në

shumë resorë të tjerë. Në këtë rast, kisha pasur dëshirë këtë t'ia them ministrit, por kam edhe një çështje tjetër. Ligji për licencimin e subjekteve private shëndetësore kur do t'i ketë ndryshimet brenda tij për shkak se aty kemi edhe asociacione, do të thotë, shoqëri civile që është asociacioni i komunave të Kosovës dhe shërbyesit civilë, të cilët, përpos pagës që marrin për ta kryer punën brenda orarit të punës, ata marrin edhe mjete shumë të mëdha me rastin kur bëjnë licencimin e subjekteve private shëndetësore?

Ndërkaq, kisha pasur dëshirë të flas edhe për një çështje lidhur me legjislacionin, kur ministri vetë e thotë janë marrë, janë bërë njëqind inspektime nga 3 inspektorë. Do të thotë, për një vit kanë kryer nga 30 inspektime për krye të inspektorit, çka do të thotë është shumë marramendëse. Në këtë rast, nuk është mirë të thuhet, por konsultojeni pak ministren e Drejtësisë nga subjekti juaj politik. Me vendim nuk mund të kryhet kurrgjë, me aktvendime mund të marrin qëndrime të duhura, sepse duhet të jetë edhe një organ i shkallës së dytë që t'i ekzekutojë ato. Kaq, kisha pasur dëshirë të them, pra dua t'u lë mundësinë edhe kolegëve të mi deputetë. Zoti ministër, të na informoni për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Vaša Parlamentarna grupa ima još 2 minuta. Gospodine Geci, imate 2 minuta. Izvolite!

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë nuk pata ndërmend të diskutoj, por me këtë që u tha nuk kam qare pa u lidhur me një rast që më ka ndodhur mua. Para disa ditësh m'u ka sëmurë nëna, e kam marrë ta çoj te mjeku dhe, më besoni, thanë: "jo ai mjeku është në burg". Hajde shkojmë te një tjetër. "Jo, edhe ky tjetri është në burg". Hajde nënë shkojmë në Dubravë se qysh e ka filluar ministri i Shëndetësisë, krejt mjekët do t'i çojë në Dubravë.

Unë kam një propozim konkret për ministrin dhe për Kryeministrin. Zoti Kryeministër, a ka mundësi ta bëni një ndërrim në Qeverinë tuaj, ministrin e Shëndetësisë ta bëni ministër të Punëve të Brendshme? Me kamera televizive kishte për ta vënë pikën 1 dhe 31 në veri dhe do të shpetonin mjekët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Hvala vam! Imate još minutu gospodjo. Hoće li Drita ili Adem Salihaj, birajte vas dvoje. Imate minut ukupno iz Partije LDD. Imate riječ, kolegice Drita!

DRITA MALIQI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë të Parlamentit,

Me të vërtetë për një minutë s'mund të them shumë, sepse institucionet e shëndetësisë, sidomos të asaj primare, dua të flas shkurt për Gjilanin, janë në gjendje kaosi dhe janë përdhosur rregulli, ligji, projektet që patën ndryshuar edhe jetën e qytetarëve të Gjilanit. E gjithë kjo është bërë nga fansi i Kryeministrit, kryetari i kuvendit komunal të Gjilanit, Qemajl Mustafa. Edhe pse Gjilani, në këtë Qendrën e Mjekësisë Familjare është zgjedhur e para më datën 10 maj 2008, kryetari i komunës e hoqi drejtorin, e ndërroi doktor Shfaqet Murtezin para skadimit të kontratës dhe në të instaloi organet e dhunshme, duke dërguar ushtruesë të detyrës nënkryetaren e PDK-së, edhe pse ekzistonte zëvendësdrejtori dhe ushtronte të gjitha funksionet e tij. Për t'i kryer detyrat partiake dhe hakmarrjet e ulëta, ushtruesja e detyrës vazhdoi që nga muaji i parë me spastrimet e stafit udhëheqës për t'i vendosur vazalët partiakë dhe për të vendosur sistem

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hvala! Ja sam dužan jedno objašnjenje, gospodo prisutni. Naime, nas Poslovník obavezuje da govorimo prema snazi političkih subjekata. Postoji kompromis – dogovor šefova parlamentarnih grupa i članova Predsedništva, tako da je minutaža podeljena na osnovu kompromisa. Za riječ se javio zamenik premijera, gospodin Hajredin Kući. Izvolite zameniče premijera, imate rije!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUĆI: Në emër të deputetit, që jam, edhe i kam nja 30 minuta, Gjylnaze! Po bëj pak shaka. Besoj se e kuptojmë edhe reagimin. S'ë kam pasur ndërmend të flas, por besoj se është një obligim edhe personal, edhe institucional, edhe si Qeveri që të reagojmë jo vetëm ndaj disa thënieve që u thanë në Kuvend, por mbi të gjitha ndaj disa dukurive që janë bërë në segmentin shëndetësor.

E them me përgjegjësi të plotë në emër të Qeverisë, edhe me konsultim me Kryeministrin, spektaklet që kanë ndodhur në sistemin shëndetësor, nuk e kanë mbështetjen e Qeverisë. Ato spektakle që kanë qenë me burgosjen e mjekëve, që kanë qenë në forma të ndryshme, të cilat i përngjajnë më shumë burgosjes së ndonjë banditi, nuk e kanë mbështetjen e Qeverisë.

Mjekët tanë nuk guxojnë që të jenë objekte të tilla. Nëse ka veprime ilegale, janë masat se si duhet të merret, por duke ruajtur dinjitetin gjithmonë të mjekut dhe të intelektualit. Ne e dimë që në këtë vend ka logjikë që policia duhet t'i përgjigjet UNMIK-ut. Ne kemi kuptuar nga Televizioni çfarë po ndodh. Po e them publikisht para Kuvendit të Kosovës, Kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministrat kanë kuptuar nga Televizioni çfarë po ndodh. Dhe, po e them edhe një gjë. Nëse ndodh edhe një spektakël i tillë, dikush do të shkojë nga Qeveria dhe do të shkojë nga policia. Kjo është një përgjegjësi e plotë, që po e them me përgjegjësi të plotë. Nuk jemi ne kundër mjekëve, nuk jemi ne kundër mjekësisë private. Me ligj garantohen mjekësia private dhe publike. Me ligj garantohen. Unë e di që mjekët, unë kam mjek edhe në familje, keni edhe ju të gjithë të tjerët, edhe miq dhe të tjerë, dhe njerëzit në ordinanca private janë frikësuar të shkojnë. Nuk është kjo qeveri, nuk është kjo polici, nuk është ky shtet që duhet t'i ndjekë mjekët. Ky shtet nuk i ndjek mjekët, nuk i ndjek intelektualët. Ata që bëjnë veprime ilegale ka mënyra se si shkojnë. Dhe, në Kosovë ndodh trafikimi i drogës, nuk ka spektakle, ka spektakle për mjekët dhe kjo logjikë ka ndikuar negativisht. Unë po e them në emër të Qeverisë, ne e mbështesim punën e plotë, dinjitetin e mjekut, dinjitetin e secilit punëtor që punon në personelin shëndetësor dhe do ta kenë mbështetjen tonë të plotë.

Unë po e them vetëm një fjali si jurist. Unë e di që në një ordinancë mund të ketë pasur veprime ilegale dhe nuk e mbroj atë, s'ë mbron as Qeveria. Por, unë e di që në ato spektakle dëmi jomaterial nuk kompensohet. Mund të jenë 8 të fajshëm, 1 i pafajshëm, kushdo të ... ai që e bën. Ne do ta ndërrojmë mentalitetin, shumë shpejt do të emërohet drejtori i Policisë, shumë shpejt do t'i marrim kompetencat e plota, do të ndërrohet mentaliteti i veprimt në Qeveri dhe kudo tjetër.

Ministri i Shëndetësisë e ka mbështetjen e plotë për ta ndryshuar gjendjen në shëndetësi. Ministri i Shëndetësisë e ka mbështetjen e plotë për të vënë rend dhe rregull, e ka mbështetjen e plotë për të përmirësuar ofrimet e shërbimeve për qytetarët, ndërsa ministri do të jetë jashtëzakonisht i përgjegjshëm për punën që e bën, jashtëzakonisht i përgjegjshëm përballë mjekëve, tek e fundit, është pjesë e tyre. Dhe, unë jam i bindur se nuk duhet ta shohim ministrin ose Qeverinë, njërën në një anë, ndërsa sistemin shëndetësor, në anën tjetër. Në këtë drejtim, ne kemi pasur nevojë që ta themi një gjë të

tillë. Në vitin 2009, Qeveria e Republikës së Kosovës ka disa prioritete. Publikisht po e them, prioritet mbi prioritete do të jetë shëndetësia dhe në shëndetësi, përveç ministrit të Shëndetësisë, si personi më kompetent, do të jetë i kyçur direkt edhe Kryeministri edhe dy zëvendëskryeministrat. Do të kemi angazhim direkt, jo angazhim për t' i frikësuar mjekët, por për ta ndryshuar gjendjen në shëndetësi.

Mund të thotë dikush, ka pasur, s'ka pasur pasoja. Gjendja në shëndetësi, çfarë është sot, Qeveria, Kryeministri, unë, secili, nuk e ndiejmë se është gjendja e mirë e shëndetësisë dhe nuk themi se është gjendja e mirë e shëndetësisë. Gjendja në shëndetësi mund të ndryshohet dhe do të ndryshohet, po ju premtoj të gjithë juve se do të ndryshohet, por jo me spektakle. Gjendja në shëndetësi do të ndryshohet me punë, me aktivitet, duke ruajtur dinjitetin dhe duke u dhënë mundësi mjekëve dhe zhvillimit të mjekësisë.

U përmend edhe rasti i specialistëve. Ka vendime që ne i respektojmë procedurat, Ministria e Shëndetësisë e kështu. Vendimet që janë marrë në Qeveri do të respektohen. Këtu është vetëm një Qeveri, nuk janë dy qeveri dhe kjo Qeveri do të vendosë rend e rregull. Kemi ku të vendosim rend e rregull edhe para shëndetësisë, nuk është vetëm shëndetësia, nuk është “gjuajtje e shtrigave” ndaj mjekëve. Unë po ju them shumë sinqerisht, unë jam edhe profesor dhe njoh kolegë, nuk e ndiej veten mirë. Një logjikë e tillë ka mund të shkojë edhe në universitete private, po ta kishim këtë mentalitet, por s'e kemi këtë mentalitet si Qeveri. Unë po them se tash e tutje do të jemi të kujdesshëm. Unë personalisht kam ftuar edhe ministrin e Shëndetësisë, edhe ministrin e Punëve të Brendshme dhe kam kërkuar nga të dytë që veprimet e tilla spektakulare duhet të jenë paraprakisht të njohura dhe kamerat ka ku të dërgohen. Unë jam i pakënaqur dhe ne jemi duke bërë hetime si ka ndodhur që kamerat të presin me orë deri sa të bëhet një spektakël i tillë. Hetimet do të shkojnë nga organet kompetente, po edhe masat do të jenë politike dhe disiplinore nga ne, ndërsa nëse ka përgjegjësi penale, i merr dikush tjetër.

Nga kjo tribunë, nga ky vend dua t'iu them të gjithë mjekëve se kemi respekt për punën e tyre, do ta respektojmë dhe ruajmë dinjitetin e tyre. I ftoj që ta kryejnë punën me ndërgjegje të plotë. Nëse ka veprim kundërligjor, do të përgjigjen përballë ligjit. Kjo qeveri do të jetë në anën e së drejtës, në anën e ligjit. Kush nuk ka problem me ligjin, do ta ketë mbështetjen e plotë të Qeverisë. Natyrisht se shëndetësia është një shërbim. U përmend nga ministri Idrizi dhe të tjerët, kuptimi i pagesës, i përqindjes që ndahet për kokë të banorëve. Ministri besoj është i përkushtuar dhe ka treguar prova të plota që është i përkushtuar në tërësi. Ka pasur edhe disa telashe të pakëndshme edhe me stafin dhe me gjëra të tjera për çdo ditë e më shumë, por kësaj radhe po them prapë, në vitin 2009 do t'i ndihmojmë edhe të gjithë ne. Ne e ndiejmë veten përgjegjës nëse nuk ndryshohet gjendja në shëndetësi. Edhe për atë që është sot, nuk e ndiej veten krejt lehtë. Mos të mendohet se e ndiejmë vetën shumë mirë ta arsyetojmë. Për çdo segment, në qoftë se ka pasur ndryshime, do të tentojmë të bëjmë ndryshime pozitive edhe në këtë sektor dhe jam i bindur se bashkërisht, me ndihmën tuaj, me kujdesin tuaj, do ta fitojmë një përgjegjësi, një mbështetje të plotë dhe besoj edhe Kuvendi do t'i japë mbështetje të plotë edhe Qeverisë, edhe ministrit në veçanti, t'i bëjë reformat e tilla, ta ndryshojë mentalitetin. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore duhet të jetë një prej preokupimeve të këtij vendi. S'dua ta citoj askënd që ka thënë “mendja e shëndoshë, në trup të shëndoshë”, por dua të them, mbi të gjitha, se kjo shoqëri ka nevojë që shërbimet shëndetësore të kuptohen si nevojë dhe si obligim i Qeverisë dhe jo si një luks që mund të jetë për ndonjë shtresë të qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Ftoj deputeten Mimoza Ahmetaj ta marrë fjalën.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër, Kabinet Qeveritar, Pas fjalëve që i tha zoti zëvendëskryeministër është me të vërtetë e tepërt të shtohet diçka, por megjithatë po e ndiej si obligim të them atë lidhur me situatën reale në të cilën është shëndetësia e Kosovës.

Shëndetësia është në gjendje mjaft të vështirë dhe këtë situatë e karakterizojnë: menaxhimi i dobët, planifikimi joadekuat i nevojave të qytetarëve, shkalla e lartë e korrupsionit, moskoordinimi i punës në mes tri niveleve të shëndetësisë dhe Ministrisë, raportet e këqija ndërpersonale në institucionet më të larta shëndetësore, mungesa e Klinikës së Kardiokirurgjisë dhe Onkologjisë, mungesa e materialeve themelore në fushat e caktuara, si të kontrastit për CT, mungesa e morfinës, mungesa e materialeve për dializë, pastaj numri në rritje i pacientëve që kërkojnë shërim jashtë vendit, janë të gjitha këto vetëm disa nga problemet që janë shumë aktuale në shëndetësi.

Furnizimet me barna, të cilat bëhen në momentin e fundit dhe atëherë kur gjendja bëhet vërtet alarmante dhe jepen leje emergjente për furnizime, siç ka ndodhur disa herë, kur dihet se këto leje që kapin vlera prej dhjetëra mijëra eurove, jepen vetëm në raste të katastrofave natyrore ose të epidemive që e kanosin shtetin. Në vend se furnizimi me barna të menaxhohet nga vetë klinika, ajo vazhdon të bëhet nga Ministria.

Çështja e decentralizimit në shëndetësi është lënë në harresë. Gjendja tash është më shumë e centralizuar se që ka qenë. Zgjedhja e shefave të klinikave, të reparteve, e bërë nga Ministria, është tregues tjetër se sa është e centralizuar shëndetësia. Një gjë e tillë është mjaft e tmerrshme.

Megjithë problemet e vazhdueshme të përmendura më sipër, përmirësime në furnizime me barna ka pasur këta 2-3 muajt e fundit, në krahasim me periudhën para 5 – 6 muajsh, mirëpo, mbetet ende shumë për t'u bërë.

Blerja e stendave pa nevojë me afat shumë të shkurtër të përdorimit, me çmime të shtrenjta, duke ditur që ne as që kemi kardiokirurgji të funksionalizuar ku do të mund të përdoreshin stendat e tilla. Shpeshherë mjekët në salla të operacioneve ose në salla të lindjes ballafaqohen me mungesën e gjërave elementare prej të cilave varet jeta e njeriut dhe pastaj janë po ata të cilët ballafaqohen me akuzat për mospunë dhe kujdes ndaj pacientëve. Mungesa e filmave të rëntgenit me arsyetimin se ka në depo të mjaftueshme, është po ashtu çështje brengosëse.

Të gjitha këto janë probleme që vazhdimisht i janë plasuar opinionit të gjerë duke iu faturuar personelit mjekësor dhe me këtë është nëpërkëmbur autoriteti i mjekut, në vend se të krijohen kushte që këto kuadro të krijuara me aq mund, të stimulohen dhe avancohen profesionalisht dhe t'i shërbejnë vendit.

Licencimi i klinikave private, pezullimi i punës së tyre ose mosrefuzimi për licencim është dukuri e cila kërkon t'i kushtohet kujdes. Në shumicën e rasteve nuk përfillen afatet kohore për licencim dhe institucione të tëra vazhdojnë të punojnë duke mos e ditur se cili do të jetë epilogu i fundit pas aplikimit për licencë të punës.

I nderuari ministër,

Shpesh dëgjojmë të diskutohet çështja e buxhetit të vogël të Ministrisë së Shëndetësisë, se ai nuk i plotëson nevojat e popullatës dhe të shëndetësisë në përgjithësi, por po qe se e krahasojmë buxhetin për shëndetësi me atë të Ministrisë së Arsimit, e cila me buxhet shumë më të vogël ka shënuar mjaft rezultate për një periudhë aq të shkurtër, atëherë kjo lë të dyshohet se me tepër është çështje e keqmenaxhimit të atij buxheti sesa vërtet e mungesës së tij.

Të nderuar deputetë,

Kohë më parë është lansuar çmimorja e shërbimeve shëndetësore, e cila ka ngritur reaksion shumë negativ në media dhe në popullatë. Dhe, për sqarimin e kësaj çmimoreje është bërë shumë pak nga personat zyrtarë brenda Ministrisë se çka realisht do të thotë kjo çmimore dhe cila është rëndësia e saj për shëndetësinë? Gjithashtu, është diskutuar edhe për sistemin informativ shëndetësor, për të cilin, si duket, është ende duke u punuar dhe është larg për t'u realizuar.

Është e ditur se këta dy faktorë, si sistemi informativ shëndetësor, ashtu edhe çmimorja e shërbimeve shëndetësore, janë shumë të rëndësishme për t'i vënë bazat e një shëndetësie të mirëfilltë institucionale dhe krijimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Mungesa e Institutit të Onkologjisë po i kushton Kosovës qindra-mijëra euro në vit, për shkak se pacientët tanë, në mungesë të Institutit të Onkologjisë, shkojnë për trajtim në vendet e rajonit. Në Kosovë është ndërtuar objekti për Onkologji para disa vjetësh, por ai nuk është funksionalizuar, sepse teknikisht nuk i plotëson kushtet.

Gjithashtu, duhet përmendur se, edhe po të ekzistonte objekti, ne kemi mangësi të kuadrit për onkologji. Do të ishte shumë më mirë që mjetet e tilla që derdhen në buxhetet e vendeve fqinjë, të investohen në Kosovë dhe me këtë edhe do t'i kishim klinikat dhe personelin e kualifikuar.

E njëjta gjë vlen edhe për Kardiokirurgjinë dhe për Mjekësinë Intensive.

Zoti ministër,

Askush nuk ka pritur nga ju që të bëni mrekulli për një periudhë të caktuar, por kemi pasur shpresën se do të vini me një plan konkret për zgjidhjen e problemeve të krijuara dhe do t'i bëni hapat e parë drejt zgjidhjes. Të gjitha skandalet e fundit dhe raporti i OBSH-së janë tregues të mjaftueshëm se cilët duhet të jenë hapat e ardhshëm për veprim në shëndetësi. Krijimi i një grupi punues, i përbërë nga ekspertë vendorë dhe të huaj, të cilët kanë përvoja në menaxhim në shëndetësi, do të ishte hap i parë mjaft i rëndësishëm. Zgjidhja e problemeve duhet filluar nga Ministria dhe duke vazhduar më poshtë deri te ambulancat e mjekësisë familjare.

Po ashtu, do të duhej të rishikohej mundësia e nivelizimit të pagave të mjekëve, të largimit të mjekëve nga kategoria e shërbyesve civilë, si dhe të bëhet decentralizimi brenda shëndetësisë, gjë që është edhe prioritet i kësaj qeverie.

Këto do të ishin vetëm disa nga rekomandimet që mendoj se do t'i shërbenin ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala, poslanice Ahmetaj! Za riječ se javio gospodin Hajredin Hyseni – PDK. Imate preostalih još 16 minuta, gospodine Hyseni. Izvolite, vaša je govornica!

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Pas fjalës së zëvendëskryeministrit, që për mua ishte një fjalë programore, dhe pas qartësimit të shumë dilemave që janë në opinion, unë iu besoj zotimeve të Qeverisë dhe unë tërhiqem prej fjalës dhe vetëm do ta mbështes këtë zotim të Qeverisë dhe do t'i uroj sukses që vërtet shëndetësia të marrë një rrugë të mbarë dhe të shkojë në binarë të duhur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala i vama, gospodine Hyseni! Sledeći govornik je iz AKR, javili su se profesor Riza Smaka i gospodjica Suzana Novobrdaliu. Oboje imaju dva minuta i ja bih zamolio da se opredele. Izvolite profesore Smaka, vaša je govornica!

RIZA SMAKA: Respekt, zoti kryesues!

Zoti Kryeministër, zëvendësministra, ministra,

Deputetë të nderuar,

Me të vërtetë theksimet e zotit Kuçit e dhanë një ton në atë kuptimin se ka pasur shumë indinjatë në opinion sa i përket arrestimit të mjekëve, se fundi i fundit, ne kemi ligj, kemi Kod penal, ka procedura, e tjera.

Më lejoni të bëj një pasazh të shkurtër. Kush nuk beson, mundet në Google ta shohë. Më 15 qershor të vitit 1995 më kanë burgosur 6 policë të një regjimi autokrat. Paskan pas qëlluar me një edukacion dhe më kanë thënë: “Kemi urdhër që të të arrestojmë. A mund të llogarisim se do të vini pas nja 10-15 minutash, për hir tuajin, të studentëve”? Dhe, kam shkuar! Rasti i dytë ka qenë më 13 qershor të vitit 1999, kur më kanë arrestuar në mënyrë krejt të ngjashme me këtë që ka ndodhur, apo jo, e tjera. Do të thotë, angazhohem për ligjin, për rregullat, sepse ato kanë shumë efekte të mira.

Shëndetësia është në një gjendje të vështirë. Ka vend për të folur 24 orë për defektet, por unë mendoj se ne duhet ta kemi një qasje maksimalisht objektive. A do të mund të bënte cilido prej nesh, po të ishte ministër? Me siguri, ndoshta më tepër a më pak, por dukshëm, apo jo! Unë angazhohem që Ligjin për Qeverinë që ta rishikojmë, ta amendojmë, ministrave tanë t’iu japim ingjerenca, autorizime dhe më pastaj ne do të kishim në atë proporcionalitet autorizime për t’i qortuar në qoftë se autorizimet e veta nuk do t’i kishin aplikuar.

Do të isha angazhuar, të nderuar, që ne shumë shpejt t’i bëjmë këto punë dhe mund t’i bëjmë: Ligjin për shëndetësinë publike, Ligjin për shëndetësinë private, Ligjin për

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hvala profesore! Režija je prekinula jer ste prekoračili vreme. Hvala profesore Smaka! Za riječ se javila poslanica Edita Tahiri. Izvolite!

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, kryesues!

Përshëndetje të gjithëve!

Nuk është asgjë e re për të konstatuar se gjendja në shëndetësi është e rëndë, por është e rëndë edhe si rezultat i grumbullimit të problemeve për një kohë të gjatë, por edhe të një përgjegjësie të veçantë për faktin se populli ynë ka dalë nga lufta dhe kujdesi në planin shëndetësor u desh të jetë në nivelin maksimal.

Vetëm dy momente, ndoshta, e karakterizojnë më së miri gjendjen: mortaliteti dhe morbiditeti i fëmijëve, pra, që nuk ka pasur përmirësime, në mungesë të një sistemi aktiv të imunizimit. Por, çka është më e vështirë, është problemi i shëndetit mendor që gjithnjë më shumë po vështirësohet në Kosovë krahas shëndetit fizik. Numri i vetëvrasjeve është në rritje, që është shumë shqetësuese dhe gjithsesi ndërlidhet me të kaluarën, por edhe me kushtet në të cilat është sot vendi.

Unë vetë kam pasur rast të kem sigurisht punë, por edhe si deputete jam e interesuar për situatën. Me të vërtetë kushtet e punës janë në nivelin e mjerueshëm, për të mos përmendur mungesën e barnave esenciale, të pajisjeve, po edhe ato pajisje që janë dhe mosmirëmbajtja e tyre tregon se situata kërkon një vëmendje të veçantë.

Sa i takon menaxhimit të burimeve njerëzore, mendoj se mund të thuhet mbase ka një armatë mjekësh që kanë diplomuar dhe nuk e di pse nuk krijohet një strategji nacionale më adekuate që këta njerëz, pra, të përfshihen në rritjen e kualitetit të shërbimeve mjekësore, por edhe pacientët të fillojnë të ndjehen më të dinjitetshëm dhe t'i kalojnë ato dhembje së paku në një zbutje më normale që është për një situatë normale.

Është edhe një informacion, të cilin më shumë e kam marr nga gazetatat, që lidhet me specialistët, të cilët edhe pse kanë marrë miratimin për t'u sistemuar, vazhdon disa muaj problemi i tyre.

Për të dalë te sektori privat, këto ditë u shqetësuam me këto zhvillime dhe veprimtaria jologjore për të cilën nuk kemi pasur shumë njohuri doli në shesh, mirëpo ajo që duhet të theksohet këtu është se ekziston një numër i madh i klinikave private që fare nuk janë të licencuara dhe pyetja ime është: a thua çka po ndodhë atje në ato qendra?

Unë, përshëndes vendimin e Qeverisë për ta rritur buxhetin për shëndetësinë, sepse me këtë rast u tregua që shëndetësia po del në prioritet, pra në një prioritet nacional dhe është një veprim i drejtë për mendimin tim dhe kisha dashur të jap disa propozime, ndonëse nuk jam eksperte, por kam konsultuar një ekip ekspertësh që kam në parti dhe këto janë disa nga sugjerimet.

E para që të ketë një menaxhim strategjik në sektorin shëndetësor. Desha të shpjegoj çka nënkupton menaxhimi strategjik?

Në çdo organizatë kur performansat bien nën minimumin e lejueshëm, është sikur puna e pacientit që është shumë i sëmurë dhe kërkon një diagnostifikim e pastaj edhe barna, edhe puna e sektorit shëndetësor kërkon një diagnostifikim dhe më pas masat e duhura për të dalë nga kjo gjendje.

E dyta, mendoj se të ardhurat e personelit mjekësor nuk janë në nivelin e duhur dhe besoj se ky buxhet do të përdoret sigurisht edhe për këtë çështje.

E treta, mendoj se duhet të zbatohen masat “brain gain” në shëndetësi. Mendoj se ka shumë qytetarë të Kosovës që sot janë emra të mjekësisë në botë dhe ndoshta duhet të zbatojmë një program për “rikthimin e trurit” në planin e mjekësisë, mbase edhe në fusha tjera.

E katërta, sigurimi shëndetësor duhet të rregullohet në mënyrë që të ndikojë edhe te siguria e pacientëve, por edhe të mund të kontribuojë për përmirësimin e kualitetit të rrethanave për mjekët dhe mjekësinë.

Dhe, e pesta, mendoj se decentralizimi është një prej rrugëve të menaxhimit strategjik dhe ka mundësi që duke mundësuar decentralizimin, mbase edhe përgjegjësia të shkojë në nivele tjera por të jetë në funksion të kualitetit.

Për mendimin tim ka mundësi të përmirësohet situata, por për këto punë, natyrisht, duhet pasur vizion strategjik, por edhe guxim që të merren vendime serioze, në mënyrë që rezultatet të jenë në dobi të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam kolegince Tahiri! Sledeći diskutant je gospodin Naim Rrustemi. Izvolite, gospodine Rrustemi!

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

I nderuar ministër,

Të gjykojmë sa është gjendja e mirë në shëndetësi, nuk është shumë vështirë, sepse po shihet që është shumë keq, jo vetëm prej nesh, por edhe prej qytetarëve të Kosovës. Është një sektor në të cilin qytetarët ndeshen drejtpërdrejt me të, por edhe ne personalisht jemi potencial i mundshëm që mjekët të na trajtojnë. Unë do t'i qasem kësaj interpelance në tri momente të caktuara. Njëri do të jetë ai politik, tjetri në nivelin organizativ brenda Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qeverisë në përgjithësi dhe momenti i tretë në rrafshin tokësor, në implementim.

I nderuar ministër, në planin politik, qysh prej marrjes së detyrës tuaj asnjëherë nuk e keni përmendur apo nuk e keni ngritur çështjen e Spitalit të Mitrovicës. Edhe pas debateve të shumta publike që u bënë rreth 6-pikëshit ka qenë pak e ndershme që të thuhet dy-tri fjalë për të.

Po ju njoftoj se në vitin 1999 spitali i Mitrovicës është udhëhequr nga një bord i përzier ku kanë qenë 2 shqiptarë, 2 serbë dhe 1 ndërkombëtar. Dhe që nga viti 2000 janë zëvendësuar me politika ndarëse, që nuk besoj se janë në funksion të stabilitetit të Kosovës.

Edhe në aspektin organizativ, ministër, këtu u tha edhe nga të tjerët, u tha edhe nga zëvendëskryeministri, u diskutua lidhur me këtë dhe filloi të bëhet si aferë çështja e pranimi në punë të 41 specializanteve. Personalisht për mua ndoshta nuk do të ishte shumë brengosëse, por brengosja është moskomunikimi i brendshëm brenda Qeverisë. A ka qenë vendimi i mirë apo i keq, nuk është shumë me rëndësi? Është me rëndësi se do të duhej implementuar, së paku do të duhej të kishte pak respekt ndaj vendimeve të Qeverisë.

Dhe, në planin e tretë, në planin implementues shumë herë në këtë sallë, por edhe publikisht nëpër vende të tjera është diskutuar disi si me një humor, me një humor të zi për çështje serioze, për çështje të shëndetësisë. Është përdorur shpesh cinizmi. Shpesh është tentuar të arsyetohet se ne do t'i ngrisim barnat esenciale në 70 apo 80%, kurse ne të gjithë po e shohim, e edhe unë personalisht e kam parë, në spital nuk ka mjete për infuzion. Mund të ketë barna esenciale, në QKU nuk ka pajisje për infuzion. Këto fjalë i ka vërtetuar edhe publikisht edhe drejtori i Qendrës Klinike Universitare dhe ai mban

përgjegjësi për fjalën e vet publike. Dhe unë fillova të mendoj, mund të ketë barna, por ato infuzione vetëm nëse ua dhenë me lugë me lugë, ngapak-ngapak.

Mirëpo, këtë metodë nuk do ta kisha preferuar në shërbime publike, sepse është më e shtrenjtë, se kërkon fuqi punëtore. Pra, në shërbime publike efektiviteti matet me efikasitet financiar, me fjalë të tjera, duhet të kryhen punët e duhura me sa më pak mjete të mundshme.

Shpresoj që do t'i merrni për bazë këto sugjerime tona po edhe do të bëni një punë ashtu siç do të duhej bërë, por nëse nuk mund të bëni atë që premtoni, atëherë seriozisht do të duhej përsiatur në vetvete – pse po e thua atë që s'mund ta bësh? Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala, gospodine Rustemi! Za riječ se javila poslanica Gjylnaze Syla i imate 3 minute.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Interpelancën e kam mirëpritur, sepse e shoh si mundësi të mirë për marrjen e vendimit për përmirësimin e shëndetësisë. Megjithatë, dëshiroj të shpreh shqetësimin dhe keqardhjen se duhet të them që sistemi shëndetësor në Kosovë është dështim. Prandaj, janë të nevojshme veprime të menjëhershme për të përmirësuar gjendjen e rëndë dhe do të filloj nga disa propozime.

Duhet një vizion afatgjatë, me synim të krijimit të sistemit shëndetësor efikas dhe të qëndrueshëm. Veprimet që duhet ndërmarrë janë:

1. Reformat në shëndetësi, duke filluar nga vetë Ministria.
2. Ristrukturimi i sektorit publik, dhe
3. Monitorimi i sektorit privat.

Përpjekjet, siç thashë, duhet të fillohen nga vetë Ministria meqenëse Ministrisë së Shëndetësisë i mungon organizimi dhe menaxhimi, i cili mund të bëjë ndryshimin e gjendjes. Prandaj, hapi i parë duhet të jetë fuqizimi i rritjes së kapaciteteve menaxhuese të Ministrisë dhe riorganizimi i brendshëm i saj, duke përfshirë edhe shkarkimin nga obligimet e panevojshme, siç është fusha e financimit të institucioneve shëndetësore, furnizimi me barna, menaxhimi i drejtpërdrejtë i spitaleve rajonale dhe QKUK-së.

Këto obligime duhet kaluar institucioneve ekzistuese, duke rritur autonominë e tyre, por edhe institucioneve të reja të cilat duhet të krijohen: Fondi i Sigurimeve Shëndetësore dhe Oda e Mjekëve, sikur që është praktikë në të gjitha vendet që janë ose tentojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian.

Në fund, do të përqendrohem në një çështje që do të jetë edhe pyetje për ministrin.

Zoti ministër, Aleanca i ka përkrahur kërkesat e punëtorëve shëndetësorë për mbështetjen financiare të tyre. A do të ketë rritje të pagave të punëtorëve shëndetësorë në vitin 2009, si dhe shtesa prej 42 eurove?

Çështja e shëndetësisë është një çështje e madhe, të cilën nuk ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hvala vam poslanice Syl! Obaveštavam poslanike, gospodina Nait Hasani, gospodju Flora Brovina i gospodina Ramadan Gashi da imaju ukupno 5 minuta i onda neka se dogovore koliko će ko da govori. Izvolite, gospodine Nait. Znači, poslanici Nait Hasani, Flora Brovina i Ramadan Gashi imaju ukupno 5 minuta. Vi se dogovorite ko će koliko da govori. Izvolite gospodine Hasani!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje Kryeministër, ministra,

Kaq shkurt s'na e ka marrë mendja se na rrok por, megjithatë, edhe neve na del pak shkurt në fund.

Mendoj që të gjitha ato që u thanë prej zëvendëskryeministrit dhe që na i keni hëngër fjalët se ai është zëvendëskryeministër e neve deputetëve s'është dashur të na shkurtoni aq shumë diskutimet. Edhe dhjetë minutat e tij duhej të na jepeshin neve.

Por, e gjithë ajo që dua të them, them se ne kemi deklaruar që jemi për mbrojtje të ligjit dhe e mbrojmë ligjin dhe ligjshmërinë, ndërsa atë që e tha zëvendëskryeministri, e mbështesim në tërësi, por për të gjitha këto menaxhimet në shëndetësi ju kisha sugjeruar ta marrim model Prizrenin, si shëndetësinë dhe menaxhimin e Prizrenit, sepse atje kemi një ekonomist dhe ai ekonomist e menaxhon shëndetësinë. Atje nuk kemi konflikt interesi, por kemi menaxhim të shëndetësisë, ndërsa në spitalet tjera, edhe në klinikë, kemi konflikt interesi ndërmjet mjekut dhe menaxhimit të mjekut të shëndetësisë.

Gjithashtu, dua t'i falënderoj shumë këta që folën, por shkeljet janë të mëhershme dhe ne kemi ardhur që t'i ndalojmë shkeljet. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam, gospodine Hasani! Imate tri minuta gospodjo poslanice Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje të gjithëve,

Shëndetësia e Kosovës vuan tani e më shumë se 18 vjet, vuajnë pacientët, vuan personeli shëndetësor që angazhohet në mbrojtjen e shëndetit të popullatës. Pra, kjo është një sëmundje kronike e cila u atakua nga armiku si sektori i parë, domethënë, dhe nuk iu dha përparësi në kuadër të institucioneve tona, nuk ishte politikë me prioritet.

Kam shumë emocion dhe kisha dilema ta marrë fjalën apo jo, për shkak të këtij emocioni, sepse dua ta theksoj se para vetes kam një moment kur më kujtohet se në Akademinë Franceze fola për shkeljen e të drejtave të pacientit dhe për shkeljen e të drejtave të personelit shëndetësor gjatë gjithë këtyre 18 vjetëve. E kam këtë parasysht, sepse para veti e kam edhe burgosjen spektakulare të kolegëve të mi e që kanë emra të merituar për gjithë këtë periudhë për të cilën folëm. Ata mund ta kenë shkelur ligjin, por nuk ka pasur nevojë që të diskreditohen në një mënyrë kaq të rëndë.

Unë, për një gjë tjetër, pasi që është interpelancë, dua t'i drejtohem ministrit. Ju, zoti ministër, jeni të njoftuar edhe si deputet me rekomandimet që Komisioni për Shëndetësi ia pati dorëzuar ministrit paraprak, 60 a më shumë rekomandime, dhe pyetjen të cilën ia kam pas bërë ish-ministrit se sa nga këto rekomandime të Komisionit për Shëndetësi janë realizuar, kam marr një përgjigje për një përqindje shumë të vogël. Prandaj, kërkoj që të më përgjigjeni, nëse keni mundësi ju, në mandatin tuaj, a i keni plotësuar të paktën

gjysmën e këtyre rekomandimeve, që janë vërtet një politikë dhe kërkesë e domosdoshme pas monitorimit të Ligjit për shëndetësi.

Së dyti, kërkoj nga ju dhe Qeveria në tërësi që sa më shpejt të formojmë planin nacional për shëndetësinë – planin afatshkurtër dhe afatmesëm, sepse çdo qeveri duhet ta ketë këtë plan e të mundet pastaj hap pas hapi të ketë edhe një plan konkret. Kështu ka qenë edhe në kohërat më të vështira, prandaj tani mendoj se duhet ta kemi një plan të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala i vama poslanice Brovina! Imamo sada još pet minuta s kojima raspolaže Parlamentarna grupa LDK-a i dva prijavljena poslanika, a to su Zef Morina i doktorka Nurishahe Hulaj. Ja vas molim da se u okviru ovog vremena prijavite. Imate riječ gospodine Morina. Izvolite!

ZEF MORINA: Unë, shumë shkurtër do të flas dhe faleminderit!

Përsëendetje Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Deputetë të nderuar,

Në të vërtetë, raporti i ministrit, i cili ishte shumë përmbajtësor, jep të kuptohet se angazhimi i ministrit dhe i Ministrisë është në rrugë të drejtë edhe pse është problem që kjo gjendje e shëndetësisë të riparohet për një afat shumë të shkurtër.

Që të mos u marr shumë kohë, desha t'ia bëj një pyetje ministrit sa i përket licencimit të institucioneve private.

Pas këtyre arrestimeve që u bënë dhe pas deklarimeve nga ana e Inspektoratit, del se ose është pengesë ligji ose udhëzimi administrativ, i cili nuk mundëson licencimin e institucioneve private dhe në këtë mënyrë iu jepet hapësirë atyre të punojnë ilegalisht. Në qoftë se është kështu, atëherë do të ishte mirë që të rishqyrtohet ose të rishikohet ai udhëzim administrativ, në mënyrë që të mos iu jepet mundësi institucioneve private të operojnë në kundërshtim me ligjin dhe vërtet është e papranueshme mënyra se si janë arrestuar ose si janë mbyllur ato institucione, pavarësisht në qoftë se të gjithë e dimë që ndoshta edhe kanë bërë veprime të tilla.

Çështje tjetër është se do të ishte mirë që me ligj t'iu jepet mundësia e trajtimeve të pacientëve brenda vendit e të mos i çojmë jashtë. Për shembull, për transplantimin e veshkave, ne kemi mjek të kalibrit botëror dhe është turp që atyre t'iu ndalohej veprimi, sepse një veprim i tillë do të jetë në interes të qytetarëve. Përndryshe, ne e kemi përcjellë punën tuaj, e mbështesim punën tuaj, sepse ka trende pozitive për të vendosur rregull dhe rend në shëndetësinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala i vama poslaniče Morina! Ima reč poslanica Nurishahe Hulaj i imate 3 minuta.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit kryesues i Kuvendit!

E nderuar Qeveri dhe deputetë,

Shëndetësia kosovare është një problematikë shumë komplekse duke ditur se problematikat kanë qenë me vite të tëra të grumbulluara dhe nuk kanë pasur zgjidhje adekuate. Vetë raporti i ministrit të Shëndetësisë gëzon faktin se kemi hyrë në kanale që çështjen bazike shëndetësore ta rregullojmë duke u bazuar në strategjitë e shëndetësisë kosovare, të cilat ekzistojnë, duke u bazuar në një legjislaturë të shëndetësisë kosovare, e cila është shumë komplekse dhe ekziston ajo infrastrukturë ligjore, e cila kërkon që të

përkrahet me mekanizma më të fuqishëm edhe nga ana qeveritare që këto ligje për shëndetësi, respektivisht Ligji për shëndetësinë publike të përkrahet për t'u implementuar në tërësi, duke e mbuluar me udhëzimet administrative, sepse pa udhëzime administrative ligjet nuk mund të jenë të implementueshme.

Është shumë me rëndësi që në shëndetësi, që cekën edhe kolegët e mi, mungon Fondi i Sigurimeve Shëndetësore dhe do të thosha se abc-ëja në shëndetësi është Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, për të cilin edhe vetë ministri ka marrë iniciativë me grupet punuese që ne në vitin e ardhshëm të dalim me fazën e parë që të fillojë implementimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore. Me këtë ligj lidhet edhe Ligji për punën, një ligj shumë i rëndësishëm i cili në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale është punuar shumë mirë dhe nga ana e Qeverisë janë tërhequr të dy ligjet – edhe Ligji i fondeve të sigurimeve shëndetësore edhe Ligji për punën, që janë dy ligje bazike që kërkojnë një përkrahje më të fuqishme qeveritare dhe janë dy ligje të rëndësishme për qytetarët e Kosovës.

Disa rekomandime kisha për t'i thënë këtu. Është shumë me rëndësi kontraktimi i shërbimeve shëndetësore, sepse duke ditur se shtretërit e spitaleve në Kosovë janë të shfrytëzueshëm 50 deri 62%, që do të thotë se është shumë pak dhe në bazë të shfrytëzueshmërisë dhe shërbimeve që i krijojnë organizatat shëndetësore, bëhet edhe kontraktimi i shërbimeve shëndetësore e këtë gjë e mundëson Fondi i Sigurimeve Shëndetësore dhe pyes këtu: - Sa japim ne, si qytetarë të Kosovës dhe ne, si deputetë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Još jedan minut, molio bih režiju, da joj omogućite.

NURISHAHE HULAJ: sa japim për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore kur dihet se çdo shtet në botë jep për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore – domethënë qytetarët. Edhe ne e kemi obligim që të kemi një sistem më të mirëfilltë dhe të japim kontribut që të gjithë që ta plotësojmë dhe iniciojmë Fondin e Sigurimeve Shëndetësore.

Këtu i kam edhe disa rekomandime. Që të jetë një përmirësim më i suksesshëm është me rëndësi të bëhet decentralizimi i farmaceutikës, domethënë të gjitha organizatat buxhetore shëndetësore vetë ta menaxhojnë farmaceutikën ose do të plotësojnë listën esenciale. Të decentralizohen barërat, të decentralizohen të hyrat vetjake të gjitha organizatave buxhetore shëndetësore siç janë decentralizuar edhe të hyrat vetjake të Universitetit të Prishtinës. Me këtë ne mund të zgjidhim shumë probleme dhe vetë organizata mund t'i orientojë dhe t'i menaxhojë në mënyrë më racionale dhe me një kosto- efektivitet më të lartë.

Vetë fjala shëndet, nuk do të thotë vetëm....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ja se izvinjavam. Isteklo vam je vreme, koleginice Hulaj. Ja se izvinjavam ostalim poslanicima. Na redu je poslednji govornik današnje interpelacije u ime SLS, gospodin Dragiša Mirić. Imate 3 minuta, gospodine Miriću. Izvolite!

DRAGIŠA MIRIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!
Gospodine predsedavajući, dame i gospodo, narodni poslanici,

Nadam se da mi nećete zameriti ako svojom diskusijom ne idem prema dnevnom redu. Ali na ovakav korak odlučio sam se na osnovu emocija koje me danima uništavaju kao čoveka, kao sina, kao roditelja. Igrom slučaja, ili ne znam već kako, ali zadnjih nekoliko meseci često puta sam se nalazio u situacijama i na mestima gde sam imao priliku da vidim kako ljudi sa Kosova žive loše i pod strašnim okolnostima....

KRYESUESI: Molim vas, držite se dnevnog reda, gospodine Miriću. Tema je van zdravstva, molim vas!

DRAGIŠA MIRIĆ: Ima tu i zdravstva, gospodine predsedavajući.

KRYESUESI: Ali se uključite u tu temu, molim vas jer opominje me režija i organizatori.

DRAGIŠA MIRIĆ: Uključicu se! Zakoračili smo dugo, u treći milenium a način u kome živi jedan dobar broj ljudi podseća me na filmove o praistoriji. Svi smo mi svesni i znamo da je na Kosovu loša zdravstvena zaštita, ekonomska situacija, da su plate male i da je velika nezaposlenost i zato sam se odlučio da se danas javim za govornicom i da ovim svojim izlaganjem pokušam da u svima nama probudim osećaj odgovornosti prema tim ljudima i da što pre nadjemo način da uspemo da ulepšamo i ublažimo nevolje onih ljudi koji ne znaju šta je život i koji još uvek nisu okusili život. Znam da je pred nama jako težak zadatak, ali ništa nas neće koštati ako probamo i pokušamo da bar za njihovo bolje sutra uradimo nešto bolje. Ja, kao pojedinac, ne mogu mnogo da pomognem, ali mogu stalno da izlazim za govornicom i da vas podsećam da naše obaveze prema društvu i prema onima koji su socijalno najugroženiji i u to ime ja sam odlučio da napravim prvi korak. Možda je to ništa, ali za mene je to dokaz da sam nešto pokušao i da sam dao inicijativu, a na neki način predstavlja i moralnu satisfakciju prema ugroženima, pa sam u to ime odlučio da mi se od sledeće poslaničke plate pa sve dok mi traje mandat poslanika odbija po 200 evra mesečno a da se tim novcem pomognu najugroženije bolesne porodice bez obzira na nacionalnost. Ja znam da je danas 200 evra malo za život ali se nadam da će ova moja inicijativa naići na odobravanje kod svih vas i voleo bih da i vi, narodni poslanici, sledite moj put. Takodje, gospodine premijeru, vama se obraćam, o ovoj inicijativi treba i Vlada da se pozabavi i da nadje modus kako uticati na privredni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Molim vas, pustite još par sekundi da govornik završi rečenicu. Molim režiju!

DRAGIŠA MIRIĆ: ... Zato ja vas još jednom molim da se ovim problemom svi zajedno pozabavimo i da učinimo sve da i te ugrožene i bolesne ljude ogreje sunce. A ja još jednom želim da vas podsetim da se od sledeće poslaničke plate pa sve do kraja mandata dobrovoljno odričem 200 evra u korist najugroženijih i bolesnih porodica na Kosovu. Hvala na pažnji!

KRYESUESI: Hvala i vama, gospodine Miriću! Vaš gest je vrlo human i u to ime, evo u ime Skupštine, ja ovaj gest pozdravljam. Obaveštavam prisutne da je 120 minuta interpelacije poslanika isteklo. Pozivam ministra, gospodina Gashi da sa svojih pet minuta da konačnu riječ vezano za njegov resor. Izvolite, ministar Gashi.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra dhe ju të çmuar deputetë,

Informata dhe në veçanti debati për mua është shumë i dobishëm. Nga ky debat janë dhënë me dhjetëra rekomandime dhe mendoj se porosia e përgjithshme e të gjithë diskutuesve është se duhet ndërruar gjendjen në shëndetësi. Këtë porosi më duket e kam të qartë dhe është e pakontestueshme.

Fillimisht, më lejoni që ta ripërsëris atë çka thashë edhe në fjalën hyrëse, sa i përket arrestimeve, unë jam informuar nga mediumet.

Nën dy, si ditën e parë, si çdo herë në pyetje dhe përgjigje parlamentare këtu, kam theksuar, e ritheksoj edhe sot se gjendja është shumë e rëndë, po e themi ne, e kanë në raporte të gjithë ata që i kemi ftuar ta hulumtojnë gjendjen. E kam lutur Bankën Botërore, e kam lutur Organizatën Botërore të Shëndetësisë, i kam lutur ekspertët e jashtëm nga Amerika dhe Evropa që në shpenzime të tyre të vijnë ta ekzaminonë gjendjen dhe kanë ardhur në të njëjtin përfundim – gjendja është shumë e rëndë dhe është një gjendje e cila është akumuluar me dekada në një vend, i cili, pas aparteidit ka eskaluar në gjenocid dhe në luftë dhe është administruar nga një sistem i Organizatës së Kombeve të Bashkuara që për qëllim si çdo kund në vend e ka status-kuon. Ne tash jemi shtet dhe ne duhet ta marrim përgjegjësinë e unë jam i gatshëm ta marr dhe e kam marrë përgjegjësinë për reformë të shëndetësisë. Të gjithë ata që e kanë hulumtuar këtë gjendje dhe kanë përvojë në reforma në shëndetësi në rruzull tokësor, thonë se janë të dhimbshme, që kushtojnë shumë dhe që zgjasin e për të cilat fillimisht nevojitet një konsensus nacional dhe nevojitet një mandat në veto të atij që e bën atë reformë. Do të thotë këtu, nuk duhet të ketë dyshim.

Ajo çka njëherësh është edhe e pakontestueshme, këtë vit ne kemi rezultate. Juve, të opozitës, të mos ju brengos arritja e rezultateve. Ju duhet të gëzoheni nëse kemi arritur që prej 30% të listës esenciale, për më pak se 6 muaj, ta bëjmë mbi 70%.

Dëgjoni! Kush të dojë, sa herë që do dhe sa herë që ka mundësi të dalë në medime, ai mund të dalë e të thotë se mungon ky bar, sepse sot neve na mungojnë 30%. Prandaj, unë nuk shqetësohem kur një profesionist del dhe thotë nuk ekziston ky bar, sepse ne sot na mungojnë 30% dhe ne besojmë se deri në fund të vitit kjo mungesë do të jetë më e vogël, por njëkohësisht është e pakontestueshme dhe se atë kornizë afatmesme të shpenzimeve - dhe në Konferencë të Donatorëve kemi pasur synim ta arrijmë në vitin 2011, ne e kemi arritur në dhjetor të vitit 2008. Kjo duhet t'ju gëzojë.

Një çështje tjetër. Unë e kuptoj politikën e partive politike. Unë i kuptoj fushatat, por ju kisha lutur që kur të flisni për shëndetësi e në veçanti ata të cilët s'e dinë grupin e gjakut dhe flasin për reforma të shëndetësisë, të jenë më të kujdesshëm.

Tjetër. Ata, të cilët shpifin në Kuvend, ajo nuk është e mirë. Janë të pakontestueshme, dhe ju mundeni nga ky Kuvend t'i shihni renovimet. Ju mund të shkoni nga ky Kuvend të shihni pajisjet. Por asnjëherë nga kjo foltore, as unë as kush prej Qeverie nuk ju ka thënë se gjendja është e mirë. Gjendja është shumë e rëndë, por kemi rezultate. Dhe ata të cilët i mohojnë, është mirë që ta marrin në rikonsideratë qëndrimin e tyre joparimor.

Këtu u ngritën shumë pyetje, për të cilat...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hvala vam gospodine ministre! Režija radi svoj posao. Hvala vam!

Prema Poslovniku, pozivam predlagača interpelacije, predstavnika Partije LDD, izgleda da je po tom pitanju gospodin Zeneli, da oni iskoriste svojih pet minuta kao predlagači. Izvolite!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Besoj se s' do të zgjas më shumë se një minutë, për shkak edhe të problemeve teknike.

Ishte një e arritur, kujtoj, së pari për seancën plenare që diskuton seriozisht për këto çështje. Edhe pse jemi shumë të befasuar me optimizmin dhe rezultatet që po përmenden si term spektakular, por ne nuk po i shohim. Qytetarët e Kosovës nuk i dinë cilat janë ato rezultate. Tash, zoti zëvendësministër, ju theksuat se Qeveria nuk ka qenë në dijeni, ndoshta edhe ju s'keni qenë në dijeni. Tash dëgjuam edhe nga fjala e ministrit, mirëpo kjo tregon një përgjegjësi të madhe të pushtetit aktual për mosushtimin e pushtetit ekzekutiv në vend. Nëse tash dëgjojmë këtë fjalë pas 30 dite, si mund të quhet ndryshe përpos dobësi qeverisëse? T'ua thyesh dinjitetin, t'i thyesh moralisht profesorët e Universitetit, si rezultat pse nuk funksionon sistemi, është shumë e rëndë. T'ju japësh premtime melagomane – paga, shërbime, funksionalitet dhe në praktikë të mos hetosh asgjë dhe qytetari i Kosovës nuk ka mundësi t'i sheh ato sot. Kjo tregon se gjendemi në një krizë të thellë politike, morale dhe institucionale. Ministri flet për sukseset në QKUK-së, përgjegjësit e QKUK-së flasin ndryshe, nuk po i komentoj. Ministri flet për mjekësi molekulare -gjenetike, ndërsa në qendrat klinike tonat nuk kryhen shërbimet elementare. A jemi duke e jetuar realitetin? Dhe pacientët kosovarë, edhe sot kur po diskutojmë, ata kërkojnë shërbime në shtetet fqinje. Kjo do të ishte brenga kryesore e kësaj Qeverie. Po flasim për rritje të buxhetit. I nderuar Kryeministër, Qeveria mund ta rrisë buxhetin, mirëpo menaxhimi është diçka tjetër. Të rritësh buxhetin, do të thotë të rritësh keqpërdorimet, në rastin tonë konkret dhe të rritësh abuzimet me fonde. Të folsh sot për mjekësi dhe për shëndetësinë kosovare është diçka sikur për një dinosaur.

Shikoni, sot e kishim deklaratën e ministrit se gjendja në shëndetësi është e rëndë. Kemi pasur deklarata të mëhershme se në gjendje të rëndë dhe krizë të thellë janë abuzuesit e shëndetësisë dhe keqpërdoruesit dhe sot po bindemi se gjendja në shëndetësi qenka shumë e rëndë dhe kjo meriton një vëmendje shumë serioze prej Qeverisë.

Në kuadër të kësaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në përputhje me Rregulloren e Punës të Kuvendit, përkatësisht në pajtim me Rregullën 25 pika 9 i propozon për miratim Kuvendit të Kosovës, këtë mocion.

1. Krijimin e Komisionit hetimor parlamentar për t'i hetuar të gjitha këto shkelje ligjore në sistemin shëndetësor në vend dhe në veçanti në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe
2. Kërkojmë shkarkimin e ministrit të Shëndetësisë, si përgjegjës politik për gjendjen e rëndë në sistemin shëndetësor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala, gospodine predlagače ove interpelacije!

Na kraju, da vas obavestim da s obzirom na to da nije bio jasan stav predlagača interpelacije, ovde stoji da se traži informacija Skupštine Kosova o teškom stanju zdravstvenog sistema Kosova. Prema tome, stav pravne službe administracije Skupštine Kosova je da vaš predmet bila informacija i mi ovim zaključujemo interpelaciju Skupštine. Dakle, ovim ja dajem prisutnima pauzu do 15,35 minuta i molim poslanike da

u 15,30 minuta budu tu i da nastavimo rad Skupštine. Dakle odluka je pravne službe i administracije, gospodo predlagači.

Diskutim i paraqitur me shkrim

SUZAN NOVOBRDALIU: I nderuari Kryetar i Kuvendit,

Zoti ministër, për gjendjen në shëndetësinë kosovare nuk besoj se ka nevojë që këtu të thuhet ndonjë fjalë, sepse për këtë e dimë të gjithë, për këtë madje dinë edhe Leutrimi i vogël, i cili nga injektimi i terapisë së gabuar të një injeksioni sot nuk është në gjendje që të ecën dhe jetojë normalisht sikur të gjithë fëmijët tjerë. Për këtë dhe shumë raste tjera të ngjashme besoj se jeni informuar zoti ministër, qoftë edhe nëpërmjet mediave.

Nuk marr guximin që për gjendjen e vështirë në shëndetësinë kosovare t'ju fajësoj vetëm juve z. ministër, sepse për këtë kanë dhënë kontribut të madh edhe qeveritë dhe drejtuesit e shëndetësisë paraprake. Megjithatë, kjo nuk më bën të kursehem që të mos ju kritikoj për shpresat e gabuara që i ndërtuam në momentin kur ju u zgjodhët ministër i Shëndetësisë. Menduam se erdhi koha që shëndetësia kosovare të marrë trajtimin e merituar që kishte munguar për shumë vjet, erdhi koha sepse për drejtues të saj u zgjodh një njeri i cili shëndetësinë e ka profesion, i cili e ka qoftë edhe vetëm obligim profesional që të bëjë më shumë për këtë dikaster kaq të rëndësishëm të Qeverisë kosovare.

Me duhet t'ju them këtu zoti ministër se ju na zhgënjyet, ju filluat dhe po vazhdoni ta shkatërroni shëndetësinë kosovare çdo ditë e më shumë. Me gjasë pritjet tona kishin qenë të gabuara, sepse kjo edhe po vërtetohet.

Më këtë rast, të nderuar kolegë deputetë, më lejoni shumë shkurt të prezantoj një pjesë të angazhimeve të ministrit, i cili gjatë prezantimit të tij nuk i tha, sepse ose i ka harruar ose nuk i konsideron të rëndësishme për t'i prezantuar këtu para Kuvendit, në këtë interpelancë që është thirrur ndaj tij:

Angazhimi i parë i tij ishte lufta e madhe ndaj sekretarit permanent të Ministrisë së Shëndetësisë për largimin e tij nga ky post. Këtu nuk dua të diskutoj se a ishte i drejtë veprimi i tij dhe më këtë ta mbroj tashmë ish- Sekretarin permanent të Ministrisë së Shëndetësisë, por dua ta kundërshtoj praktiken e cila tashmë është instaluar në institucionet e shtetit të Kosovës që në pozitë kyçe të vihen njerëz të afërt me pushtetarët aktual dhe drejtuesit e dikastereve të caktuar.

Tjetra, angazhim i ministrit është edhe tendenca e tij që ta largojë nga kreu i QKUK-së drejtuesin aktual të saj. Kjo ndryshe nuk mund të kuptohet nëse i përcjellim me kujdes prononcimet e tyre dhe komunikimin e ndërsjellë mes tyre. Besoj se të gjithë këtu pajtohemi që komunikimi mes tyre duhet të ishte dhe të jetë shumë i ngushtë, përndryshe nuk mund të presim mirëfunksionim të QKUK-së dhe sistemit shëndetësor.

Angazhim tjetër i ministrit dhe i gjithë Qeverisë kosovare ishte ngritja e pagave për punëtorët e sistemit shëndetësor. Fatkeqësisht, një angazhim i tillë nuk u ndërmor para grevës disa ditore të të gjithë punëtorëve shëndetësor, sepse kjo është praktika që çdo ditë e më tepër po instalohet tek pushtetarët tanë, që ne të veprojmë vetëm pas grevave apo pas një kërcënimi serioz për grevë. Besoj se më këtë rast duhet të falënderohen të gjithë

punëtorët shëndetësorë që bëjnë një punë të shkëlqyeshme përkundër një kompensimi nënçmues. Këtë duhet ta bëni edhe ju i nderuari ministër. Këtu nuk po diskutoj për premtimin që i keni dhënë punëtorëve shëndetësorë për përmirësimin e të ardhurave të tyre dhe kushteve në të cilat ata punojnë, sepse këtë besoj se e keni bërë për shkak se edhe jeni të obliguar ta bëni.

Për të mos u marr shumë kohë, nuk po cekim këtu edhe shumë angazhime tjera që nuk dallojnë shumë më këto që i cekim më lartë, sepse ka edhe shumë raste tjera të cilat besoj se i dimë të gjithë e të cilat nuk kanë kaluar në heshtje qoftë edhe vetëm mediale.

Te nderuar kolegë deputetë, më lejoni që në pjesën tjetër të fjalës sime t'i trajtoj disa heshtje të cilat nuk janë trajtuar fare apo aq sa duhet nga ministri Gashi.

Fillimisht po ndalem tek projektbuxheti që Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraparë të ndajë për shëndetësinë kosovare për vitin 2009. Besoj se të gjithë e dini se janë paraparë vetëm 66 milionë e 282 mijë euro, karshi qindra milionëve euro që u janë ndarë ministrive tjera. Por, më këtë rast është vështirë të gjejmë fajtorin, a është ai Kryeministri i cili nuk ka lejuar t'i ndahen më shumë kësaj ministrie, apo më gjasë është fajti të vet ministri i cili është ndarë i kënaqur më kaq buxhet të ndarë për ministrinë që ai e drejton?

Më vjen keq nëse dikush nga ne këtu, apo edhe vetë ministri mendon se vetëm 12 milionë e 500 mijë euro mjaftojnë për vitin 2009 që të ndahen për shpenzime kapitale në tërë sistemin shëndetësor, apo 1 milion e 70 mijë euro për subvencione në këtë sistem, nuk e di, ju mendoj se mjaftojnë zoti Ministër?

Për gabimet që bëjnë punëtorët e caktuar shëndetësorë, meqë këtu nuk guxoj të bëj përgjithësime, sepse pak ka të tillë, dukë bërë qoftë edhe përkrahimin e terapisë së gabuar e cila shumë pacientëve, madje u ka kushtuar edhe më jetë, i nderuari ministër gjithë ajo çka ata që pësojnë nga këto raste mund të bëjnë është të hapin rastin në gjykatat e Kosovës. Një lëndë të tillë i duhen vite deri sa të trajtohet, ndërsa punëtori shëndetësor vazhdon të punojë dhe për fatin me të keq të bëjë edhe shumë gabime tjera. Kjo, i nderuari ministër, vjen nga ajo se tek ne nuk ka apo nuk vepron një lloj gjykate e nderit në kuadër të Shoqatës së Mjekëve që kjo të merret me këto raste dhe sigurisht të veprojë shumë më shpejt në bazë të detyrave të përcaktuara qartë. Ju këtë nuk e keni bërë.

Më këtë rast, në fjalën time nuk po i trajtoj edhe shumë çështje tjera siç është ngritja profesionale e punëtorëve shëndetësorë meqë zhvillimi i shkencës së mjekësisë është shumë dinamik, funksionalizimi i shumë aparaturave në kuadër të QKUK-s e cila në një formë është kthyer në një lloj muzeu për aparate medicinale, meqë ato nuk punojnë e pacientët tanë dërgohen për analiza të ngjashme t'i bëjnë në institucione private jo vetëm në vend, por madje edhe jashtë vendit. Nuk po flas as për licencimin apo moslicencimin e institucioneve shëndetësore private, as edhe për standardet evropiane të shëndetësisë të cilat duhet të synojmë t'i arrijmë një ditë, e të cilat fatkeqësisht janë shumë larg.

Të nderuar kolegë deputetë, krejt në fund të fjalës sime më këtë rast më lejoni që t'i drejtohem drejtpërdrejt ministrit Gashi.

I nderuar zoti ministër, nëse vërtet mendoni se kjo është mënyra më të cilën duhet të trajtohet sistemi shëndetësor kosovar, segment ky shumë i rëndësishëm për gjithë

popullsinë kosovare, atëherë ju lus shumë sinqerisht që qoftë edhe si obligim profesional që e keni, jepni dorëheqjen tuaj para këtij Kuvendi. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI I KUVENDIT: Në sallë janë 64 deputetë dhe janë plotësuar kushtet për të vazhduar punën.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 30 korrik 2008, dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedim me ligjet e pashpallura, Komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për tubimet publike dhe Kuvendit ia ka parashtruar rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Të nderuar deputetë, kryetari i Komisionit nuk është këtu dhe ne vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional sipas radhës së paraqitur në raport.

Në sallë janë 64 deputetë dhe janë plotësuar kushtet për të vazhduar punën.

Fillojmë me amendamentin 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Për amendamentin 1 kanë votuar 54 deputetë “për”, “kundër” asnjë, 2 abstenime, andaj konstatoj se u miratua amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 54 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 5.

Amendamenti 6.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

A është ndokush pa kartelë?

Në radhë është amendamenti 7.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

Në radhë është amendamenti 9.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 40 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 9.

Në radhë është amendamenti 10.

Në sallë janë të pranishëm 63 deputetë.

Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kujtoj se amendamenti 10 do të duhej të ndryshohej. Sipas kësaj, le të kuptohet që vetëm 72 orë para se të mbahet një protestë, mund të lajmërohet. Këtu ka qenë “më së voni”, ndërkaq tash hiqet fjala “më së voni” dhe kjo nënkupton se strikt duhet përmbajtur me 72 orë. As nuk mundet më herët as më vonë. Unë po shtroj edhe një çështje tjetër që kujtoj se duhet të jemi më fleksibil. Çka nëse lindin rrethanat që një protestë të mbahet brenda 24 orëve, a do të duhej të ketë rrethana të veçanta për një mundësi të tillë që organizimet e tilla të jenë edhe në një kohë më të shkurtër sesa 72-orëshi – paralajmërimi.

KRYETARI: Komisioni funksional. Jo funksional është Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri. Çka po propozon ti Ibrahim?

IBRAHIM MAKOLLI: Propozoj që të mbetet si ka qenë “më së voni”, sepse kjo e jep mundësinë që edhe më herët të bëjë kërkesë, edhe 100 orë para se të mbahet protesta. Po ashtu, propozoj që në rrethana të veçanta kjo kohë mund të jetë edhe më e ngushtë, sepse mund të ketë nevojë që një manifestim i tillë të mbahet brenda 24 orësh dhe me këtë nën këtë ne përjashtojmë këtë mundësi dhe këtë të drejtë.

KRYETARI: Por, ndoshta, një nën tjetër e përcakton atë.

IBRAHIM MAKOLLI: Jo, Kryetar, asnjë nën tjetër nuk e përcakton.

KRYETARI: Meqë nuk është Komisioni, fjalën e ka kërkuar zonja Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Unë po e shpreh mendimin tim personal se protestat në situata emergjente ato veç nuk janë më protesta, por janë diçka tjetër dhe shtrohet pyetja kush e merr përgjegjësinë për sigurimin, për vendin, për mbikëqyrjen e protestave, për rreziqet që bartin me veti protestat e të gjitha ato? Prandaj, sigurisht është menduar të lihet kjo kohë kaq e gjatë për t’u bërë të gjitha përgatitjet për të qenë protesta më e menaxhuar dhe për të pasur mbarëvajtjen e vet.

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Nga Komisioni e ka fjalën Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Meqenëse veç po dalin propozime lidhur me këtë amendament, propozimi më i mirë është që të jetë “më së voni”, për shkak se duhet të lejohet ai vakuumi për 72 orë, ndërkaq plotësisht i përgjigjem asaj çka tha ministrja e Drejtësisë, sepse lë të nënkuptohet se diçka çka organizohet shumë shpejt mund të jetë e paplanifikuar dhe përgjegjësia mund të jetë më e madhe. Ndërkaq, për një organizim të mirëfilltë, për një protestë apo çfarëdo forme tjetër që qytetarët dëshirojnë t’i manifestojnë pakënaqësitë apo rastet tjera të veta, për të dalë të organizuar 72 orë janë të mjaftueshme për t’u lajmëruar organet e rendit për një gjë të tillë. Pra, le t’i jepet konsensusi “më së voni” e të mos jetë strikt për të pritur njerëzit atë 72-orëshin komplet. Faleminderit!

KRYETARI: Do të thotë, ti në emër të Komisionit po heq dorë nga amendamenti numër 10 dhe po thua të mbetet si ka qenë – “më së voni 72 orë”.

Atëherë, kush është për këtë variant?

(Ndëhyrje)

Për variantin që të mbetet ashtu siç ka qenë, do të thotë të fshihet krejt amendamenti numër 10. Urdhëroni, Ibrahim!

IBRAHIM MAKOLLI: Në këtë formë, po më duket jemi keqkuptuar, sepse po e shtrojmë një çështje shumë të thjeshtë. Çka nëse lind nevoja që një organizim, pavarësisht se duhet të menaxhohet mirë, por çka nëse lind nevoja që nesër të mbahet një tubim? Ata nuk kanë leje, sepse në bazë të kësaj nuk mund të marrin leje, atëherë cilat do të jenë pasojat?

(Ndërhyrje, reagime)

Jo, më dëgjoni! Ne bile në Kosovë kemi më së shumti përvojë me organizim dhe me mbajtjen e protestave dhe unë nuk e di pse nuk do të duhej ta ketë një pjesë ky ligj – një nen në të cilin do të mundësohet një gjë e tillë në rrethana të veçanta.

KRYETARI: Me gjithë respektin, ky është amendament i ri dhe për të ne sot kemi hyrë në procedurë. Urdhëroni, Ardian Gjini, pasi që e keni kërkuar fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, Kryetar!

Mendoj se propozimi i parë që ishte që të thuhet se së paku 72 orë para mbajtjes së protestës duhet të lajmërohen autoritetet, është në rregull dhe duhet të përkrahet, ndërsa çështja e kohës më të shkurtër, mendoj se është çështje që del prej konceptit ose kontestit të rregullimit të materies. Ne, si Kuvend, po tentojmë që të vëmë rregull në formën e mbajtjes së protestave, në mënyrë që autoritetet të kenë kohë të përgatiten, të rregullohet komunikacioni e të gjitha çështjet e tjera dhe nuk besoj se duhet t’ia shkurtojmë kohën vetvetes që shoqëria të përgatitet në raste të tilla. Ne e dimë se ka raste kur mbahen protesta të paparalajmëruara, mirëpo ka dispozita tjera ligjore dhe vendime tjera ekzekutive të cilat iu mundësojnë autoriteteve të jenë tolerante në rast se janë ose nuk janë paqësore. Mendoj se 72 orë ose propozimi i cili është, është në rregull. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, zonja ministre!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Prapë kjo duhet të përcaktohet, “më së voni 72 orë” nënkupton se mundesh prej një ore ose prej 30 minutave, e ti duhesh ta lajmërosh organin 72 orë...

(Ndërhyrje, reagime)

Ashtu, do të thotë “më së voni”.

(Ndërprerje e shkurtër)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, ju e dini se përparësi ka amendamenti i Komisionit. Nëse ju nuk e votoni, mbetet teksti siç ka qenë në ligj.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:
Konstatoj se me 12 vota “për”, 36 “kundër” dhe 5 abstenime, nuk miratohet amendamenti numër 10, andaj mbetet teksti siç ka qenë në ligj. Faleminderit!

Kalojmë në amendamentin 11.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:
Konstatoj se me 47 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti numër 11.

Amendamenti 12.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:
Konstatoj se me 51 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 12.

Amendamenti 13.

Urdhëroni, profesor! E ka fjalën deputeti Smaka.

RIZA SMAKA: Angazhohem që ku është “mund të ndalohet 24 orë para” të thuhet “së paku... orë më parë”, sepse kjo shkon në favor edhe të atyre që duan për ta organizuar dhe mbajtur një protestë apo një demonstratë legale, si dhe të organeve, sepse lejohet mundësia. Ndryshe, sipas diksionit del se duhet të pritët, më parë mund të vendoset, ama duhet fiks 24 orë më parë të kumtohet vendimi. Faleminderit!

KRYETARI: Vlen e njëjta gjë. Vazhdojmë me votim për amendamentin e propozuar nga komisioni, që është amendamenti 13.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:
Konstatoj se me 26 vota “për”, 27 vota “kundër”, 7 abstenime, nuk miratohet amendamenti 13.

Do të thotë, mbetet propozimi i deputetit Riza Smaka.

Në radhë është amendamenti 14.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:
Konstatoj se me 48 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 14.

Amendamenti 15.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 15.

Amendamenti 16.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 16.

Amendamenti 17.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 17.

Amendamenti 18.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 18.

Amendamenti 19.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 58 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 19.

Amendamenti 20.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 20.

Amendamenti i parafundit 21.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 21.

Amendamenti i fundit 22.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 22.

Tani është radha për të votuar ligjin në tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë të tash:

Konstatoj se me 61 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për tubimet publike. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore e procedurat dhe Kuvendit ia kanë paraqitur rekomandimet e tyre.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka vlerësuar se projektligji e ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komisioni për Komunitete ka vlerësuar se Projektligji me amendamentet e propozuara, nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Komisioni për Buxhet e Financa ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore e procedurat dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Meqenëse nuk paraqitet askush lidhur me këtë pikë, kalojmë në votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

Amendamenti 2.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

Amendamenti 2.

Urdhëroni, deputet Smaka!

RIZA SMAKA: Ju lutem, në fund të alinesë, ku thuhet “me ligjin në Kosovë” duhet të zëvendësohet me “Kodin penal”, se me asnjë ligj nuk përcaktohet asnjë vepër penale, pos me Kodin penal, ekskluzivisht, prandaj ta përmirësojmë me këtë fjali, ta kompletojmë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Lidhur me këtë, le të deklarohet kryetari i Komisionit për Gjyqësi dhe Legjislacion.

BAHRI HYSENI: Zoti Kryetar! Unë mendoj se mirë e ka shkruar Komisioni funksional për Buxhet e Financa, sepse edhe kodi është ligj, mund të jetë kod – ligj, pa problem.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Atëherë, kalojmë në votim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 51 vota “për”, 7 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Amendamenti 4.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

Amendamenti 5.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 5.

Amendamenti 6.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

Amendamenti 7.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 7.

Amendamenti 8.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

Amendamenti 9.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 9.

Amendamenti 10.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 10.

Amendamenti 11.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 11.

Amendamenti 12 dhe i fundit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 12.

Radha është për të votuar tekstin e ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mandate dhe Imunitete për heqjen e statusit të deputetit zotit Sabit Rrahmani

Deputeti Sabit Rrahmani që nga data 28 mars 2008 nuk ka marrë pjesë në asnjë seancë plenare të Kuvendit dhe as që ka arsyetuar mungesën e tij, prandaj ky veprim i deputetit Sabit Rrahmani është në kundërshtim me nenin 70, paragrafi 3, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Rregullën 14.3 të Rregullores së Punës të Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit, në pajtim me Rregullën 14.3 të Rregullores së Punës të Kuvendit i ka propozuar Kuvendit që deputetit Sabit Rrahmani t’i hiqet statusi i deputetit.

Komisioni për Mandate dhe Imunitete ka shqyrtuar propozimin për heqjen e statusit të deputetit të Kuvendit, zotit Sabit Rrahmani dhe të njëjtin e ka përkrahur.

Rekomandimi i Komisionit për Mandate e Imunitete, së bashku me propozimin e Kryetarit të Kuvendit u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Mandate e Imunitete, Ahmet Isufi, që para deputetëve të arsyetojë rekomandimin.

AHMET ISUFI: I nderuar zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të paraqes këtë arsyetim për rekomandimin e Komisionit për Mandate e Imunitete dhe Rregullore të Punës të Kuvendit për marrjen e statusit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës, zotit Sabit Rrahmani.

Deputeti Sabit Rrahmani ka munguar në seancat plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës që nga data 28 mars 2008 dhe për këtë ai nuk ka afuar arsye bindëse. Ky veprim është në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Rregulloren e Punës të Kuvendit.

Përveç kësaj, Gjykata Komunale në Prishtinë, më datë 24 qershor 2008 i është drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës me kërkesën për dhënien e pëlqimit të Kuvendit lidhur me ndalimin dhe arrestimin e deputetit Sabit Rrahmani për shkak të veprimeve kundërligjore.

Kërkesës së Gjykatës i është bashkëngjitur edhe aktvendimi për caktimin e paraburgimit dhe urdhëresa për ndalimin, arrestimin dhe transferimin në Qendrën e Paraburgimit, të zotit Sabit Rrahmani, datë 26 mars 2008.

Më 20 gusht 2008, nga partia e tij ka ardhur një propozim për zëvendësimin e tij si deputet në Kuvend me një deputet tjetër nga radhët e partisë së tij.

Komisioni për Mandate dhe Imunitete, sipas Rregullores së Punës, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2008, pasi ka shqyrtuar propozimin e Kryetarit të Kuvendit lidhur me këtë çështje, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet që deputetit Sabit Rrahmani t'i merret statusi i deputetit.

Rekomandimin e Komisionit, bashkë me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, e keni para veti, të cilin duhet tani ta votojmë. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI: Faleminderit, Ahmet! Fjalën e ka kërkuar deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit zoti Kryetar i Kuvendit!

Želim da kažem nekoliko riječi kao poslanik u Skupštini i kao kolega u Grupi za integraciju u prošlom mandatu sa gospodinom Rahmanijem.

Želio bih da skrenem pažnju na dvije stvari: najprije na samu proceduru oko donošenja ove odluke i na samu odluku o oduzimanju mandata.

Ako je u pitanju procedura, mi smo već čuli da je iz njegove partije stigao, i upravo smo čuli iz Komisije za mandatska pitanja, zahtjev od 20. avgusta da se ovo pitanje razmatra, riješi i da se na mjestu poslanika o kome je riječ postavi drugi poslanik. Znači, prošlo je više od 3 mjeseca od tada a ovaj slučaj još uvek nije riješen.

Mandat je gospodinu Rahmaniju istekao 28. septembra. Danas je 4. decembar. Smatram da je to neoprostivo dugo i da jako puno vremena prošlo da se ovo pitanje razmatra. Prema Poslovniku Skupštine, odnosno Zakonu, na kome se vi, gospodine predsjedniče, cijelo vrijeme pozivate, ja ću vam citirati ovde, upravo na albanskom jeziku da bi ste bolje razumjeli, kaže ovako: „Rregulla 14 pika 3- thotë: „ Nëse deputeti i Kuvendit në periudhën gjashtëmujore nuk merr pjesë në seancën e Kuvendit”, pastaj vazhdon dhe pjesa kryesore “Kryetari i propozon Kuvendit për deputetin në fjalë pushimin e funksionit të tij. Kuvendi do të vendosë lidhur me këtë çështje në seancën e radhës”. Dakle, gospodine ključni zakonodavče, pošto se cijeli dan pozivate na zakon, šta je sa Zakonom koji kasni evo dva i po mjeseca, odnosno više od 3 mjeseca od zahtjeva njegove stranke?

Bili ste dužni na prvoj sjednici redovnoj da to uradite. Od tada je bilo najmanje 6 – 7 sjednica a ja pretpostavljam već sada i mogu da pretpostavljam jer su vaši potezi veoma predvidljivi, da ćete nastojati da to opravdate procedurom sjednica i tako dalje, i tako dalje. Pa, evo, i na to odgovora: 28. septembra je, dakle, istekao mandat čuvenom famoznom deputetu Rahmaniju i tek 31. oktobra održava se prva sjednica oko ovog pitanja. Dakle, više od mjesec dana odnosno 33 dana tačno - vama je trebalo da bi ste razmatrali pitanje, prema ovome što ste vi nama dali. To, u opšte nije u skladu sa procedurom, a trebalo je dakle na prvoj sjednici Predsjedništva koju imate svake sedmice.

Nakon toga, trebalo je da protekne još samo deset dana da bi Komisija za mandate to uradila a od Komisije za mandate, koja je potvrdila 11. novembra, drugih gotovo mjesec dana. Mislim da je to neoprostivo kršenje procedure i da bi ste, zaista, u najmanju ruku trebali da tražite izvinjenje za ovako odnošenje.

I na kraju, da ne bi ovo bila neka tirada ili držanje govorancija, ja bih predložio sledeće, i molim kolege poslanike da me slušaju.

Pošto se radi o poslaniku iz redova Aškalijske zajednice, koja je jedna od malobrojnih zajednica i pošto stalno na sceni imamo treniranje strogoče upravo na pripadnicima manjinskih zajednica, stalno se menjaju ministri ili iz Srpske zajednice, ili iz Aškalijske zajednice, ili iz Bošnjacke zajednice – mislim da bi trebalo prestati sa tom procedurom uprkos dopisu iz Opštinskog suda.

Ja bih pozvao i savjetovao kolege poslanike da pokažu velikodušnost. Mi svi dobro poznajemo gospodina Rahmani. Ja nisam u ulozi njegovog advokata. Znamo dobro da se bavio mnogim stvarima i uzimanjem dugova i raznim dalaverama, kako su rekli danas neki momci sa Blu-sky radija i tu su u pravu, naravno. Ali, ipak, ipak bi bilo dobro, bilo bi pametno pokazati plemenitost i širokogrudnost ako hoćemo da budemo dobri i veliki i da mu oprostimo. Ja bih predložio da mu se oprost. Hvala vam ljepa!

KRYETARI: E ka fjalën deputeti Etem Arifi.

ETEM ARIFI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë

Ju lutem për një mirëkuptim. Kërkojmë nga ju që mos ta votoni që t'i merret mandati zotit Rrahmani. Ne, sipas informatave që i kemi, Kryesia e Kuvendit është e njoftuar me shkrim edhe ka dokumentacion të bollshëm prej spitalit ku ai shërohet. Zoti Rrahmani iu ka nënshtuar një operacioni të zemrës dhe ai ka nevojë që ta bëjë një trajtim mjekësor edhe më tutje.

Për të gjitha këto mundemi të bazohemi në Ligjin, në Kushtetutën e Kosovës, në nenin 70.5. Edhe njëherë ju lus, të nderuar deputetë, që mos ta votoni që t'ia merrni mandatin deputetit, zotit Sabit Rrahmani. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! A e donë fjalën shefat e grupeve parlamentare? Atëherë, shkojmë në votim. Deputet, në rend të parë mësohu, këtu kanë të drejtë të prononcohen shefat e grupeve parlamentare, ata nuk e donë fjalën. Unë ua dhashë deputetëve që janë nga partia e tij dhe unë mendoj se nuk ka nevojë tjetër kush ta merr fjalën.

Ju i dëgjuat rekomandimet e Komisionit. Kush është për rekomandimin e Komisionit? Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë, tash:

Konstatohet se me 46 vota "për", 10 kundër, 4 abstenime, Kuvendi ia merr mandatin deputetit Sabit Rrahmani.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar propozimvendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës dhe ka rekomanduar që të shqyrtohet në seancën plenare.

Propozimvendimi i Qeverisë me dokumentacion dhe rekomandimet e Komisionit u janë shpërndarë deputetëve. Diskutuesi sipas radhës, përfaqësuesi i Qeverisë, si propozues, nëse e do fjalën. Nuk është i interesuar.

Kryetari i Komisionit Funksional, zoti Gani Koci, nëse e do fjalën. Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ne, si Komision, qysh herët i kemi dhënë rekomandimet tona se këto propozime për zgjedhjen e Bordit të Trustit Pensional duhet t'u nënshtrohen diskutimeve në Kuvend dhe Kuvendi të marrë vendime.

Unë vetëm një çështje dua që këtu të sqarohet në Kuvend. Ne i kemi marrë këta emra, sa janë gjashtë emra për Bordin e Trustit Pensional, por nuk i kemi të qartë dhe në ligj nuk thuhet se këta a votohen një nga një, apo votohen në paketë të gjithë së bashku?

Unë e kam një propozim që, meqë ka pasur kundërshti, ka pasur kundërthënie, ka pasur edhe sugjerime edhe të deputetëve, por edhe të grupeve parlamentare, të votohen një nga një anëtarët e Bordit të Trustit Pensional.

KRYETARI: Atëherë, lus shefat e grupeve parlamentare të deklarohen për këtë. Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, deputeti Ramë Buja e ka fjalën.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar!

Unë e ndiej se kam varfëri në këtë çështje dhe nuk e di se si e përcakton ligji. Unë nuk kam dëgjuar se ndonjë bord i caktuar mund të votohet një nga një, bordet zakonisht shkojnë votohen në paketë dhe unë nuk e di, nëse ka mundësi, mund ta kishim bërë një përzgjedhje pak më ndryshe se që është bërë në këtë çështje por, nëse mundet, ligji të na lejojë, unë jam "për!".

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti, kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, Kryetar!

Meqë kemi ardhur në pikë ku duhet të votohet për këtë bord, unë dëshiroj të konstatoj se prapë arsyet kanë mbetur të njëjta, por vullneti ynë që Bordi i Trustit të formalizohet sot, duhet të ekzistojë.

Dua ta përmend një çështje. Konkursi për këtë bord ka qenë ndërkombëtar, dhe paneli ka rekomanduar, mendimi i Panelit është final për këtë organ për t'i votuar njerëzit që janë përzgjedhur. Tre ndërkombëtarë nuk janë përfaqësues të asnjë institucioni tjetër pos të Kosovës, por ata kanë fituar në një konkurrencë shumë të rreptë dhe, po ashtu, tre përfaqësues të Kosovës e kanë fituar të drejtën të jenë në këtë pjesë, si pjesë e konkurrencës. Problemi kryesor ka qenë rreth përfaqësuesit të punëtorëve.

BSPK-ja ka konfirmuar formalisht me një letër se njëri nga anëtarët është përfaqësues i tyre. Nuk e di, nuk jam i sigurt sa është e vërtetë, por kredibiliteti i organizatës vjen në shprehje nëse nuk është i tillë, nën një. Dhe, nën dy, ICO e emëron përfaqësuesin e shtatë.

Qeveria, po ashtu, përmes një vendimi e ka caktuar kryesuesin, nuk ka pasur të drejtë sipas rregullores, sepse Bordi e cakton vetë kryesuesin në seancën e parë që takohet, por e respekton rekomandimin. Nuk jam i sigurt, nuk mund të thirrem në Rregullore, unë dyshoj që ka mundësi të bëjë selektim tjetër. Dyshoj mos po bëjmë shkelje të ligjit, unë kërkoj që Zyra Ligjore duhet ta konstatojë këtë gjendje, sepse procedurat deri te ky organ kanë ardhur që kërkohet votim si bord e jo si individë. Të mos bëjmë shkelje të ligjit, sepse në emër të ligjit deri tash e kemi mbajtur bordin këtu.

Nëse sqarohet kjo, ne jemi për ta votuar, për t'u formalizuar bordi. Mandatin ia japim 3 muaj, 5 muaj, 6 muaj, sa të doni, por një bord duhet të vijë, por duhet të qartësohet, s'jam i sigurt se a duhet të votohet individualisht, por besoj se duhet të votohet në tërësi.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në radhë është shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe ne, si Grup parlamentar kërkojmë që procesi i votimit të bëhet një nga një, meqenëse nuk është e përcaktuar me ligj për t'i dhënë fund kësaj katrahure që po ngjet me këtë bord për shkak se askush nga qytetarët e vendit nuk di se ku janë mjetet e kursyera për pensione të Trustit Pensional të Kosovës. Pra, asnjë rekomandim apo asnjë raport të vetëm, as qytetarët, por edhe ne si institucione nuk e kemi nga ky bord, me mosekzistimin e Bordit të Trustit Pensional. Pra, ne vetëm dimë se mjetet janë duke humbur, arrin vlera deri 120 milionë humbje edhe pse Qeveria ka deklaruar më herët me premtimin e saj se ato mjete do t'i kthejë edhe t'i menaxhojë në Kosovë. Ndërkaq, meqenëse po duhet një panel i këtij bordi të jetë mikst (i përzier) edhe ndërkombëtar edhe vendor, përpos që të kërkojmë të votohet një nga një, kërkojmë që edhe mandati të jetë njëvjeçar, për shkak se shpresojmë se shumë shpejt Qeveria do ta bëjë të mundur që Trusti i Kursimeve Pensionale të jetë në Kosovë dhe të udhëhiqet dhe të menaxhohet nga vendorët, nga vetë institucionet e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Radha është e Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Fillimisht, mendoj se duhet të pajtohem me ju, asnjë bord nuk e kemi votuar një nga një dhe ekzistojnë disa arsye qoftë praktike, qoftë logjike për të mos i votuar një nga një anëtarët e bordeve. Ne po na duhet bordi shpejt dhe nëse i votojmë një nga një, rrezikojmë të mos kemi bord sonte, për shkak se mund t'i votojmë dy. Ta marrim shembull nga anëtarët, e anëtarët tjerë do të mbesin pa votuar dhe atëherë do të kalojmë në votim të individëve, kurse më vonë do të kemi propozime të ndryshme se nuk mund t'i kthejmë individët të cilët nuk kemi votuar, individët të cilët ky Kuvend nuk i voton, t'i kthejmë edhe një herë, do të thotë se realisht edhe pse nuk shkruan qartë në ligj, bordet nuk votohen me individë për shkak se merr edhe peshë edhe karakter krejt tjetër votimi.

Krejt kjo që thashë, në asnjë mënyrë nuk nënkupton se Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e voton këtë bord. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Ardian! Fjalën e ka Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Qëndrimi i Lidhjes Demokratike të Dardanisë është ky: së pari, duke e marrë parasysh kërkesën e mëhershme të Kuvendit për një raport detal të Trustit Pensional të Kosovës, së dyti, duke marrë parasysh nivelin e ulët të ekspertizave të anëtarëve të propozuar në fushën e financave publike dhe financave ndërkombëtare, respektivisht menaxhmentit financiar të anëtarëve të propozuar të Bordi, së treti, duke marrë parasysh konfliktin e interesave të anëtarëve të propozuara të Bordit në Trustin Pensional të Kosovës dhe, së katërti, duke marrë parasysh interferimin politik grupor, pse jo edhe familjar të partive politike në koalicion ndaj anëtarëve të propozuara të Bordit të Trustit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë nuk e mbështet këtë përbërje të anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës. Ndërsa, në qoftë se miratohet propozimi, ne jemi për bllok vendim, do me thënë jo një nga një, por si tërësi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Në emër të Grupit Parlamentar” 7+”, Sadik Idriz e ka kërkuar fjalën.

SADIK IDRIZ: Pa, predsedniče, i mi imamo par dilema. Prva dilema je ova koju su izneli prethodni diskutanti, odnosi se na to da li se glasa pojedinačno ili u bloku i ta dilema znači stavlja pred svim skoro poslanicima. Druga dilema oko sastava, i mi imamo jednu dilemu da u ovom Bordu, bez razlike da li je neko konkurisao, nema predstavnika manjina, znači nijedan član nije predložen od redova manjina, manjinskih zajednica, a znamo da oni imaju u trustu svoja sredstva i zainteresovani su životno kako će da budu i to je jedna kako će biti situacija. Još nešto što se ponavlja u zadnje vreme da, kada su u pitanju bordovi, negde u nekoj početnoj fazi se eliminišu i kada konkurišu članovi, odnosno kandidati iz manjinskih zajednica. Mislim da nije dobro, da bi trebalo da se vodi računa da bude u bordovima, ne samo ovde nego i na drugima koje bira Vlada, koje predlaže Vlada, da bude predstavnika manjinskih zajednica. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk ka. Mirë, janë lajmëruar deputetët, kështu që atyre po ua plotësojmë dëshirat. Fjalën, sipas radhës e ka kërkuar deputeti Driton Tali

DRITON TALI: Ju faleminderit, Kryetar!

Unë paraprakisht po e shfrytëzoj edhe rastin për t’u ankuar për atë që ndodhi sot në mëngjes. Nuk është faji im që Qeveria nuk përgatitet për pyetje apo nuk ju vijnë pyetjet me rregull atje. Siç ishit dëshmitar, unë ua solla pyetjen që është bërë më 26 shtator. Po them edhe një herë, nuk është problemi im, nuk është faji im nëse administrata nuk ia dërgon Kryeministrit me kohë pyetjen dhe unë e pashë, ashtu siç e kuptova, mos mospërgatitja e Kryeministrit më patronizoi mua pa fije të fajit.

Po ua rikujtoj edhe njëherë, në seancën e 16 shtatorit, merreni lexojeni transkriptin, faqe 8 dhe 9, shiheni se çfarë përgjigje ka dhënë ministri i Arsimit dhe do ta kuptoni pse e kam bërë pyetjen sot edhe njëherë. Është në faqen 8 – 9. Jo, është shumë me rëndësi, se janë shkelur rregulloret, u patronizova pa nevojë, sidoqoftë po kthehem pak te Trusti tash.

I nderuari zoti Kryesues, singërisht, pa dashur të bëj politikë këtu, është diçka që të gjithëve neve na preokupon. Ky bord edhe pse kam qenë që në fillim kundër shtyrjes, singërisht po ju them, nuk e meriton që ta udhëheqë këtë Trust, pos një individi dhe gjithmonë po nisem nga ajo që atë që e ka qitur në CV, dikush e ka vërtetuar, pos një individi, të tjerët nuk i kanë edhe bazat më elementare për ta udhëhequr një institucion, i cili, po them, na përket të gjithë neve.

Ne ende jemi në ato farë trazirat, në atë mjegullnajën që është kah zgjat këtu, them unë 4-5 vjet me këtë Trustin si gjë e re, mirëpo shumë shpejt do të na hakmerret, për që nxitojmë ne për ta zgjedhur këtë bord me shpresë se do t'i rregullojmë gjërat jo. Dëmi është bërë çka është bërë në kuptimin e investimeve të Trustit në tregun global. Domethënë, nëse mendojmë ne tash se jemi nën presion të opinionit që, qe sa e sa Parlamenti akuzohet për dështimet e Trustit, nuk është aty puna. Unë po them edhe një herë, nëse vendosni për ta votuar në bllok, po e votojmë në bllok, por nuk është zgjidhja më racionale, mendoj se duhet t'i shqyrtojmë edhe alternativat tjera.

Po e them edhe njëherë, po e ripërsëris veten, ndoshta nuk është e tepërt. Unë kam qenë kundër asaj që ky bord të shtyhet duke qenë i bindur se tash po del se edhe kam pasur të drejtë, se të njëjtët persona do të na servohen. Por, këta persona të njëjtë nuk do të jenë në gjendje, po them, po e përjashtoj njërin aty, gjithnjë për CV-në e tij po flas, nuk e njoh personalisht, më përjashtim të njërit, të tjerët nuk kanë njohuri për ta ruajtur interesin e Kosovës apo të kontribuuesve kosovarë. Pa u futur në aspektin strategjik, aty ke ndryshime që duhet të bëhen rrënjësore, që unë jam i bindur se u mungon njohuria strategjike e personave të propozuar për bord, por sidoqoftë, Parlamenti e ka, po e them, këtë përgjegjësi sot, secili le të votojë sipas përgjegjësisë së vet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe prej teje! Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju ministra që jeni prezentë,

Duke pasur vërtet parasysh rëndësinë dhe rolin e këtij bordi dhe, ju lutem, ta keni parasysh, sepse vërtet ne jemi opozitë, por unë ndiej që kemi përgjegjësi të njëjtë sikurse pozita, jemi deputetë për t'i ngritur, për t'i theksuar çështjet për të gjetur përgjegjësinë dhe për të kërkuar përgjegjësi nga njerëzit të cilët i kanë marrë përgjegjësitë mbi vete.

Unë edhe njëherë kërkoj përgjegjësi nga kjo Qeveri që kanë kaluar 9 muaj kur janë intervistuar këta njerëz dhe pas 9 muajve, do me thënë, para 6 muajve është votuar një ligj për Trustin Pensional dhe ky ligj nuk është respektuar nga Qeveria e Kosovës dhe ne na vjen një panel i njëjtë që është intervistuar nga një panel tjetër që nuk e lejon ligji që është në fuqi.

Përveç asaj, që unë nuk dua të hyjë, sepse ligji decidivisht e thekson fort mirë kush duhet dhe çfarë duhet dhe çka duhet të kenë kryer këta persona të cilët duhet të përzgjidhen, unë nuk dua të hyjë në atë çështje, sepse vërtet sot apo Kuvendi nuk duhet t'i votojë këta persona, jo vetëm se këta nuk janë të aftë për të menaxhuar Trustin Pensional të Kosovës, por pse vërtet është shkelur ligji dhe për këtë duhet, natyrisht, të japë përgjegjësi në radhë të parë Qeveria, por edhe ne si Kuvend.

Me këtë u japim për të kuptuar qytetarëve të Kosovës, në radhë të parë pensionistëve të Kosovës, të cilët kërkojnë pensionet e tyre, ne shpesh bile ju kemi premtuar nëpër fushata që do t'ua kthejmë edhe ato që ua ka marrë Serbia, ndërsa fatkeqësisht ne nuk

po mund t'i ruajmë pensionet tona. Ne nuk e dimë ku i kemi, as sa kemi humbje, domethënë ne nuk jemi në gjendje për ta zgjedhur një bord më shumë se 6 muaj që kur është aprovuar ligji.

Natyrisht, Lidhja Demokratike e Dardanisë nuk pajtohet as me procedurën, por nuk pajtohet as me këta njerëz të cilët kanë ardhur për t'u votuar. Unë e di që keni hyrë tash në një rrugë pa krye dhe sot kisha propozuar të hyni në votim, të votohen, por i kisha ftuar kolegë deputetë të mos votohen këta persona dhe t'i hyjmë procedurës ligjore me ligj të intervistohen njerëz adekuat nga personat të cilët janë të caktuar në ligj se kush duhet t'i intervistojë këta dhe vërtet ta zgjedhim një bord, i cili të mos jetë partiak, të mos të jetë familjar, por bord i cili do t'i menaxhojë mjetet e gjithëve, ose pensionin e gjithë pensionistëve të Kosovës. Ju faleminderit, zoti Kryetar! Ky është propozimi im.

KRYETARI: Ju faleminderit, por propozimi ka ardhur nga Komisioni në të cilin bën pjesë edhe vet. Fjalën e ka kërkuar deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuari, zoti Kryetar!

Unë kam një propozim, pas dakordimit me të gjithë shefat e grupeve parlamentare, që të shkojmë në votim sot, sepse të gjithë po kërkojmë një adresë për të pasur mundësi që dikush të na jap raport për një Trust, të cilin të gjithëve na cenon dhe na tangon dhe në fakt tash nuk kemi mundësi të kërkojmë raport nga asnjë adresë e caktuar. Ne tash e bëjmë një adresë, por propozimi është që këtë votim ta bëjmë të afatizuar për 6 muaj, e pas 6 muajve ne mund të mendojmë seriozisht dhe më ndryshe për ta bërë një bord tjetër nëse na duhet, por sot ta votojmë bordin çfarë është.

KRYETARI: Një sqarim duhet ta bëjmë. Ne nuk votojmë veç e veç, ne e votojmë një vendim të Qeverisë. Unë nuk dua ta paragjykoj votimin. Ne mendoj se nëse duam ta zgjidhim këtë çështje, ne duhet të votojmë dhe ne duhet t'i hapim rrugë çështjes.

Ne, në seancën e radhës do ta kemi një raport, ndoshta më tepër është një informatë nga Banka Qendrore e Kosovës...Ai nuk është raport i Bordit, Kjo do të jetë një informatë nga Banka Qendrore e Kosovës. Sot është shpërndarë.... Ajo është çështje tjetër, raporti nuk lidhet me Bordin, ju lutem!

Fjalën e ka Gani Koci. Urdhëro Gani!

GANI KOCI: Ne edhe njëherë tjetër i kemi ngatërruar dy gjëra. Këtë çështjen që ka të bëjë me tarifën menaxhuese të Trustit Pensional dhe zgjedhjen ose përzgjedhjen e Bordit.

Nga rendi i ditës ka dalë kjo pikë që sot po e shqyrtojmë. Kanë qenë arsyet që i ka dhënë Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, të cilat arsye i kanë edhe sot. Ndërsa, çështja e raportit ka pasur të bëjë me kërkesën për zbritjen e tarifës menaxhuese edhe ajo do të jetë një pikë e veçantë e rendit të ditës. Ai raport do të shqyrtohet dhe do të merret vendim për kërkesën e Trustit Pensional lidhur me tarifën menaxhuese, prandaj mos e lidhni raportin, se nuk është kërkuar raport për këtë pikë, është kërkuar raport për kërkesën për zbritjen e tarifës menaxhuese. Atë raport do ta keni, do të analizohet edhe në Komisionin për Buxhet, edhe në Kuvend, dhe ju do të miratoni ose jo kërkesën për zbritjen e tarifës menaxhuese. Ju lutem, mos i ngatërroni këto dy çështje mes veti. Kjo është arsyeja.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Të nderuar shefa të grupeve parlamentare, e dëgjuat kërkesën e shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Kërkoj prononcimin e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

LUTFI HAZIRI: Po, ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ne u dakorduam me kolegun Buja, ne e mbështesim propozimin që të votohet vendimi i Qeverisë, mandati i këtij bordi të jetë 6 muaj, me obligim që të fillojë menjëherë çështja nën kujdesin e veçantë të Qeverisë sipas asaj që e zbaton ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Jo, ju lutem, ligjin nuk mundemi ta ndryshojmë. Fjalën e ka Ibrahim Makolli, shef i Grupit Parlamentar të AKR-së.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah këtë propozim që afati i këtij bordi të jetë 6 muaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, ne tash nuk mund ta ndryshojmë ligjin. Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe ne pajtohemi që të votohet edhe nëse mundemi ta rregullojmë mandatin, pajtohemi që ta rregullojmë në 6 muaj. Edhe njëherë po them, prapëseprapë, se grupi ynë parlamentar i voton këta individë për këtë bord. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Urdhëro, zoti zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Besoj që ka nevojë për një sqarim juridik, desha t'i them dy gjëra.

E para, votimi zakonisht bëhet në paketë se përgjegjësia do të jetë si komision, pra si bord dhe kur nuk ka një zgjidhje konkrete juridike, ka praktika juridike edhe ky bord do t'i përgjigjet Kuvendit në tërësi ose jo.

E dyta, që e përmendi Kryetari i Kuvendit, lidhet me mandatin. Është e vërtetë që mandati në ligj është 3 vjet, por është e vërtetë se ky Kuvend ka të drejtë ta ndërrojë edhe atë ligj edhe mandatin. Atëherë, çka duhet të jetë? Duhet të jetë votimi njëherë për mandatin, po ju lus juridikisht, që të votohet që këtij bordit t'i jepen 2 pika. E para, zgjidhet bordi, e dyta, caktohet pika e dytë që mandati do të jetë 6 muaj dhe brenda kësaj kohe duhet të bëhet zgjedhja e bordit të ri.

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Unë nuk e marr përgjegjësinë për ta ndryshuar ligjin në këtë formë, as mandatin që e ka përcaktuar ligji, prandaj ne e votojmë vendimin. Pra, keni mundësinë për të votuar.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Ju lutem, Luta e tha!

Pra, unë do ta marrë fjalën si deputet.

Të nderuar deputetë,

Kisha kërkuar që vërtet të vendosim një rend dhe një rregull. Kërkesën as tuajën, as të zëvendëskryeministrit për ta ndryshuar mandatin, pa e ndryshuar ligjin, unë si Kryetar nuk e vë në votim. Ju lutem, duhet të mësohemi ta respektojmë ligjin, kjo është e para.

E dyta, dëgjoni mirë se edhe në Rregulloren e Punës e keni, rendin e ditës dhe politikën në Kuvend e bëjnë grupet politike nëpërmjet shefave të grupeve parlamentare. Ju e dëgjuat nga Partia Demokratike, kërkesën e shefit të Grupit, nga Lidhja Demokratike u prononcua shefi i Grupit, nga AKR-ja shefi i Grupit, nga AAK-ja shefi i Grupit Parlamentar dhe, ju lutem, unë e udhëheq këtë Kuvend me Rregullore dhe me shefat e grupeve parlamentare. Jo çdo deputet krye veti, është politika, vendosni rregull në kuadër të grupeve tuaja parlamentare. Mos më qitni në pozitë të keqe mua se realisht unë këtu nuk kam faj.

Pra, edhe disa anëtarë të Kryesisë e lëshuan mbledhjen në shenjë proteste që nuk kanë të drejtë, ata duhet ta mbrojnë Rregulloren e Punës së Kuvendit sa edhe unë, sepse të mirat materiale nuk i kanë më të vogla se unë, bile i kanë edhe më të mira se unë. Unë po dua të them që ky Kuvend punon në bazë të Rregullores së Punës, ndryshojeni Rregulloren, unë do të punoj në bazë të asaj rregulloreje për të cilën merret vesh ky Kuvend. Unë jam i qartë prej fillimit. Ju lutem, ne votojmë vendimin e Qeverisë, nuk votojmë as mandatin, asnjë nga ne. Në vendimin e Qeverisë janë 5 apo 6 veta. Nuk kemi ardhur sot në Kuvend dhe po e bëjmë Kuvendin odë burrash. Le ta dinë, në parlamentet me kulturë dhe me traditë, deputetët e pavarur e marrin fjalën në fund të debatit, jo sa herë t'u tekton atyre, është një zë ai. Puna e Kuvendit bëhet me grupet parlamentare në komisionet parlamentare. E dëgjuat prononcimin e shefave të grupeve parlamentare dhe prononcimin e komisionit përgjegjës për të dhënë rekomandime. Nëse duam të bëjmë Pazar, bëjmë pazar, por Rregullorja është dhe i vendos kornizat e punës në Kuvend. Ju faleminderit!

Ju lutem, nëse ju doni, realisht ne e vazhdojmë tash debatin, unë nuk kam asgjë kundër. Po, të drejtën po ua jap. Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri, sipas radhës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, Kryetar! Po më vjen keq unë vetëm isha i irrituar që s'e mora fjalën, për ta thënë mendimin tim dhe asgjë tjetër. Këtu në fund kishim propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe atë që e tha zoti Haziri por, megjithatë, unë kaheerë jam lajmëruar për të diskutuar. Unë po e them, para se t'i them disa gjëra të tjera, ky Kuvend është organ më i lartë, që mund të marrë vendime shumë fuqiplote edhe të bëjë ndërrime, sepse është kompetent. Mund t'ju them me përgjegjësi që prej fillimit rreth kësaj çështjeje unë mendoj që janë bërë një mori shkeljesh dhe u tha qysh para 9 muajsh, do të përpiqem t'i them shkurtimisht. Një panel ndërkombëtar i ka përzgjedhur këta kandidatë, nuk më përket mua të them kush janë, kush janë dhe pas 9 muajsh na vjen këtu me shumë defekte, që edhe sot e kësaj dite, për mendimin tim, nuk janë eliminuar. Konsideroj që kam pasur dhe kam propozime konkrete.

Së pari, para se ta them propozimin, gjendja aktuale rreth mjeteve financiare nuk është asnjë justifikim që të marrim çfarëdo vendimi të gabueshëm, pra unë nuk paragjykoj çfarë do të jetë ai vendim.

Një çështje tjetër, mendoj që në qershor, e dimë të gjithë, ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Kosovës dhe ne të gjithë jemi për kosovarizim të institucioneve, por kjo nuk po ndodh as në këtë bord. E kundërta është, këtu bile i ke 4 me 3, sipas kësaj matematike.

Pastaj, ka shumë mundësi që i thashë edhe më herët, unë nuk di pse nuk është paraqitur në Kuvend edhe Raporti i auditivit, edhe raporti që u tha pse ai bord të shkojë, i cili ka qenë të shkojë pa i dhënë llogari dikujt, as njërin, as tjetrin nuk e kemi. Po ashtu, jemi informuar herën e kaluar që në Kuvend do të paraqesë një fjalë guvernatori i Bankës. Prandaj, nga të gjitha këto ka edhe shumë çka tjetër të shtohet për të mos u marrë kolegëve kohë, unë mendoj që edhe Kuvendi ka të drejtë, bile- bile edhe të marrë edhe vendim nëse unë e lexoj zotin Zalli atje, kush është ai, thotë që po të ishte bordi, do të mund ta merrte ndonjë vendim për t'i kthyer mjetet. Kjo është qesharake në Kosovë sipas tij, edhe ky Kuvend mund të marrë vendime të tilla e t'u thotë: - ktheni mjetet nëse janë të rrezikuara. Mund ta bëjë këtë nëse ne e dëshirojmë.

Këtu ekziston edhe një tjetër mundësi. Ka pasur mundësi edhe t'i vazhdohet për 2 – 3 muaj bordit tjetër, ka edhe mundësi të rishpallet konkursi dhe kjo është fare e fundit, që e tha që tash doli se ky s'ka qenë më herët. Unë e përkrah atë që u tha, nëse duhet, atëherë të jetë bord për 6 muaj, domethënë me mandat të kufizuar dhe çdo formë tjetër konsideroj që do të ishte shkelje. Faleminderit!

KRYETARI: Neni 12 pika 5.6, po e lexoj veç një fjali.”Mandati i secilit anëtar të emëruar në Këshillin drejtues zgjat 3 vjet, me mundësi të rizgjedhjes”. Kështu shkruan në ligj. Ju lutem, për ta ndryshuar këtë, ju e dini qysh ndryshohen ligjet. Vazhdojmë, fjalën e ka kërkuar deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!
Zëvendëskryeministër, Qeveri,
Deputetë të nderuar,

Unë mendoj që fjala për rend dite edhe për këtë debat i takon deputetit. Unë nuk e kërkoj dhe nuk dua ta mbaj fjalim në qoftë se ai është në kundërshtim me Rregulloren, por nuk ka nevojë këtu për t'u ngritur dhe për të bërë zhurmë për ta marrë fjalën, së paku nuk kisha dashur unë. Prandaj, nëse na takon ta mbajmë një rend, ta respektojmë edhe të punojmë në frymën e asaj që na takon si deputet dhe si Parlament. Nuk është kjo çështje kaq e thjeshtë, hajt ta kalojmë edhe e zgjidhim një problem.

Tri çështje dua t'i përmend me këtë rast.

E para, debati lidhur me Trustin e Pensioneve ka filluar në seancën e parë të shtatorit, atëherë kur e kemi ngritë bashkërisht me ju këtu dhe kemi sinjalizuar se duhet të shtrohet me urgjencë në rend dite, të përgatitet informata edhe të marrim vendimin, gjegjësisht së pari debatin, vlerësimet dhe rekomandimet nga ky Parlament se çka duhet të bëhet me atë për shkak të asaj që dikush i ka paraparë që do të vijnë këto probleme dhe këto pasoja që janë prodhuar në Trustin e Pensioneve. Nuk kemi gjetur mirëkuptimin atëherë, me vonesë i kemi hyrë kësaj pune dhe tash edhe më tej po e komplikojmë situatën. Unë kujtoj, pa dashur të shkoj më larg në historikun e këtij Trusti, se ky Parlament mund ta gjejë zgjidhjen. Zgjidhja është në qoftë se ne e respektojmë ligjin, gjegjësisht Rregulloren për Trustin. Nëse nuk e kam harruar atje nenin 24 apo 25 për plotësimin dhe ndryshimin që është dhe e bartim me autorizimin, mbi bazën e vlerësimeve që Kuvendi e ka çmuar se duhet të bëjë ndërhyrje dhe t'ia kalojë autorizimet, gjegjësisht kompetencat e caktuara t'i marrë guvernatori apo drejtori i Bankës Qendrore dhe së bashku me Bordin përkatës ai do të menaxhojë më tutje për një kohë për derisa ne nuk e zgjedhim këtë problemin tjetër. Pra, nuk do të kemi as mungesa, as vonesa, punojmë në pajtim me ligjin, guvernatori i Bankës është kompetent. Kur munden t'i menaxhojnë të gjitha mjetet e tjera me milionë

e milionë, pse nuk mund t'i menaxhojnë mjetet e Trustit të Pensionit, ajo i takon edhe me ligj. Pra, ne më të lehtë punë tash për tash mund ta bëjmë, mund t'i themi guvernatorit të Bankës se i kalojnë autorizimet në pajtim me ligjin, pas këtyre rrethanave që kanë ndodhur, dhe ai do të menaxhojë më tutje për një kohë përderisa ne të bëhemi gati si Qeveri ta respektojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës për të cilën për ditë do dalim dhe po bëjmë be në të, sepse ky propozim ishte më 15 mars, pa hyrë në fuqi Kushtetuta, pra propozimin aktual që e kemi. Pas 15 qershorit janë bartur kompetencat, nëse nuk i duam, dalim në foltore dhe themi- ne nuk i duam, kompetencat nuk na takojnë. Prandaj, kam të drejtë plotësisht që po them se nuk ka nevojë të ngutemi. Le të urdhërojmë Qeveria, le ta bëjë propozimin e ri në pajtim me Kushtetutën, pra është e detyruar të vendos kështu dhe nuk e bëjmë asnjë vonesë. A duhen 2 a 3 muaj, nuk është me rëndësi, i merr autorizimet guvernatori i Bankës, bashkë me bordin e menaxhon Turistin dhe na asnjë problem nuk e kemi. Pastaj, na e bien informatën, raportin dhe në një vendim tjetër del Qeveria para Parlamentit dhe thotë - urdhëroni propozimin në pajtim me Kushtetutën. Kjo që po duam ta bëjmë tash, nuk është në pajtim me Kushtetutën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është mirë të merreni vesh mes veti në grupin parlamentar dhe mos t'ia jap vizën shefi e pastaj deputeti thotë diçka tjetër. Falën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të respektuar ministra dhe deputetë,

Fillimisht, citoj vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës propozon anëtarët e bordit, nuk thotë propozon bordin në përbërje, por anëtarët, kjo është nën një. E dyta, në ligj edhe sikur të shkruante se do të duhej të votohej në bllok, nuk do të ishte në rregull, sepse është forma më antidemokratike e imponuar. Votimi duhet të bëhet kurdoherë një nga një, se është fjala për individ. Aq më parë, kur ka shumë këtu që e kanë mbushur kaq, po e zëmë, me kilogram ndoshta, CV-në e quajtur autobiografi. Thotë, bie fjala, që e ka organizuar aborgchopin këtu e atje. Është fjala për njerëz që me të vërtetë nuk premtojnë asgjë që do të kontribuonin në situatën shumë nebuloze të bordit.

Është një parim që njihet dhe aplikohet kudo që thuhet: "admajori adminus" (kush mundet më shumë, mundet më pak). Kuvendi i Republikës së Kosovës mundet, ju lutem, se kjo është aplikuar me mijëra herë dhe do të aplikohet që nëse është mandati, mund të jetë 4 vjet, 5 vjet, që e emëron ose e zgjedh në kohë të caktuar për 6 muaj, për një vjet, e tjera ...

KRYETARI: Profesor, jeni jurist, kam respekt, po dihet procedura e ndryshimit të ligjeve.

RIZA SMAKA: Ju lutem, këtë që e them, e them me plot kompetencë, edhe e them me plotë përgjegjësi, natyrisht, se ndryshe nuk do ta kisha thënë. Prandaj, angazhohem që ne të votojmë një nga një, të miratojmë këtë klauzolën që e propozoi zëvendëskryeministri Kuçi për 6 muaj. Në ndërkohë duhet të shpallet konkursi, sepse ka njerëz, se këtu shihen disa njerëz që janë super të privilegjuar (inmeriton) që prapë do të duhej të superprivilegjohej me do paga marramendëse, me asgjë të justifikueshme, e të tjera. Kemi ne shumë njerëz që meritojnë të jenë, domethënë. Shkurtimisht edhe përfundimisht, të votojmë një nga një, për 6 muaj ditë. Faleminderit!

KRYETARI: Me respektin më të madh për juristët, po kësaj radhe ne mund të mos votojmë hiq, por Ligjin nuk kam për të lejuar të shkelet. Fjalën e ka deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nuk dua të flas për rëndësinë e Trustit Pensional, sepse është folur mjaft, qe sa seanca jemi duke u marrë me zgjidhjen e këtij problemi. Këtu po shihet qartë se është tepër e rëndësishme t'i jepet një zgjidhje këtij problemi dhe të përfundojmë me te. Unë mendoj që është tepër e rëndësishme dhe kisha kërkuar nga ju që ta hidhni në votim dhe pas votimit pastaj ky problem të zgjidhet. Kaq, nuk dua të zgjas më tepër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe prej teje!
Fjalën e ka deputeti Arsim Rexhepi.

ARSIM REXHEPI: Zoti Kryetar,
I nderuar zoti zëvendëskryeministër,
Kolegë deputetë,

Ne jemi në një gjendje të jashtëzakonshme tanimë sa i përket këtij Trusti Pensional. Për më tepër, e jashtëzakonshme bëhet edhe humbja e ditëpërditshme që po i shkaktohet këtij Trusti. Dhe, nëse e marrim këtë gjendje dhe e vëmë në këtë kontest të kësaj jashtëzakonshmërie, atëherë ne jemi në sikletin për ta gjetur një zgjidhje sa më të shpejtë. Edhe unë jam në dilemë, a duhet të zgjidhet sot, apo ta lëmë për mbledhjen e ardhshme. Ne mund ta zgjedhim sot dhe zëvendëskryeministri është edhe nënkryetari i të njëjtës parti, zoti Kryetar, ku ju jeni sekretar i përgjithshëm. Nëse ju kërkon tek grupet parlamentare që të kenë harmoni, atëherë ju duhet ta gjeni harmoninë, së paku edhe te ju. Zëvendëskryeministri u ngrit dhe tha, të lutem, po të lutem pse është shumë mirë. Ne jemi të gjithë të vullnetit që ta votojmë këtë Trust dhe jemi të vetëdijshëm për gjendjen akute dhe po e votojmë. Mirëpo, ne na duhet një garanci që ky bord do të jetë për 6 muaj, kjo është e para. Dhe këtë mund ta bëjmë si institucioni më i lartë i vendit.

E dyta, janë po të njëjtët emra me të cilët ne nuk po mund të pajtohemi. Këtu ka njerëz që së paku gjysma e tyre, plus ai që do ta emëroj ICO, janë të jashtëm. Po, mirë de, mirë, edhe s'po i votojmë, edhe intenca ime është që ne t'i gjejmë njerëzit kosovarë që të hynë dhe të bëhen anëtarë të këtij Bordi. Nëse ne mundemi bashkërisht ta gjejmë një emërues të përbashkët për 6 muaj, atëherë i bëj thirrje Parlamentit që t'i votojmë, në mënyrë që t'i japim një shans zgjidhjes për të ardhmen, përndryshe kjo do të na përcjellë jo edhe 6 muaj, por edhe 1 vjet.

KRYETARI: Ju lutem, pse Kuvendi është kaq i gatshëm për ta shkelur ligjin që e ka miratuar në qershor të këtij viti, kur është ligj për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut. Fjalën e ka kërkuar Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar, ju përkujtoj se ky Kuvend ka demokraci parlamentare dhe po të pyeteshin vetëm shefat e grupeve parlamentare, do të ishin 7 njerëz që do të vendosnin për gjithë Kuvendin dhe nuk do të kishte nevojë për deputetët e tjerë.

Tjetra është se, sa i përket Trustit, është evidente që duhet të formohet Bordi i Trustit Pensional të Kosovës. Megjithatë, unë e vë në dyshim së paku njërin nga anëtarët dhe ky është Ruzhi Morina, i cili ka qenë kryetar i Rinisë Demokratike të Kosovës, prandaj kjo

nuk siguron që ky është i pavarur, por siguron që Partia Demokratike do ta kontrollojë në një mënyrë Bordin nëpërmjet zotit Morina. Pos kësaj, ai nuk ka përvojën që duhet 10-vjeçare profesionale në punën e pensioneve dhe as nuk është dijetar i shquar në fushën e shkencave ekonomike ose financiare, që është një nga kërkesat e ligjit, prandaj nuk do ta votoj këtë bord. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Panelin e ke kaluar, unë s'e kam dërguar atje. Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: I nderuari Kryetar!

Unë veç desha ta bëj pak sa të qartë dhe nuk po di se ku po i mbështesin anëtarët e grupeve parlamentare propozimet që janë drejtpërdrejt në kundërshtim me ligjin. Më fal, nëse ka mundësi, do të ishte mirë të mbani pak qetësi.

I nderuar Kryetar,

Nuk ka të drejtë askush në këtë moment ta bëjë ndryshimin e ligjit, sepse preken elementet bazë të përzgjedhjes. Komisioni përzgjedhës ka shpallur konkurs publik në revista të njohura ndërkombëtare, janë lajmëruar njerëzit në afat prej 3 vjetësh me mundësi vazhdimi. Me fjalë të tjera, janë vendosur kushtet e barabarta për të gjithë. Nëse ne sot bëjmë diçka të paligjshme për 6 muaj, atëherë nuk u kemi afuar mundësi të barabarta të gjithëve që të konkurrojnë për këto poste. Kjo është logjika, do të thotë, ligji është i saktë, është decidiv. Po, më e keqja tjetër që sipas mendimit tim po shprehet në Kuvend, është kërkesa për manipulim me ligj. Nuk ka nevojë Kuvendi i Kosovës që të merret me shok-terapi në secilin moment apo me bashkëpunime individuale, ligji është ligj. Ne mund të fillojmë iniciativa për ndryshimin e ligjit, por nuk kemi mundësi që sot të themi, ne jemi Kuvend, ne i sjellim ligjet, atë e kemi gabuar veç po e hartojmë një të ri tash për tash. Secili deputet e di, edhe grupet parlamentar e dinë se cilat janë iniciativat për ndryshimin e ligjit, kështu që propozoj që të mos futet në lajthitje as Kuvendi i Kosovës, as Kryesia e Kuvendit të Kosovës, por as ju, zoti Kryetar, të mos futeni në lajthitje dhe në procedura që janë antiligjore dhe ne mund të votojmë apo të mos votojmë. Kaq!

KRYETARI: Ju lutem, e merr fjalën një herë jo 500 herë. Diskutuesi i fundit është Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Unë nuk po mund t'ju kuptoj që prej ligjvënësve po kërkohet për ta shkelur ligjin, prej ligjvënësve kërkohet ta bëjnë ligjin, ta miratojnë ligjin dhe ta monitorojnë ligjin se si po zbatohet në praktikë dhe prej nesh tash nga dy njerëz, nga dy grupe parlamentare më të mëdha kërkohet ta shkelim një ligj që e kemi bërë para 6 muajsh. Ju këtu numrat i keni ta shkelni edhe ligjin, edhe Kushtetutën. Zoti Kuçi e di mirë që nëse ne e kemi bërë ligjin, ka procedura për ta ndryshuar ligjin dhe ne mund ta ndryshojmë ligjin, po jo ne si ligjvënës ta shkelim ligjin, e tash, të tjerët, çka donë të bëjnë. Unë nuk besoj që ne duhet dhe nuk mundemi, sepse nuk lejon mandej edhe Kushtetuta ta shkelim ligjin, që ne së bashku këtu ta shkelim ligjin dhe mandej edhe pse këtu është shkelur disa herë dhe mandej prapë të kthehemi pas 6 muajve dhe të themi, tash e kemi shkelur pak, më herët e kemi shkelur më shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Shumë mirë e dini që prej që jam këtu, asnjëherë nuk kam lejuar të shkelet ligji, ta keni parasysh, ju e dini shumë mirë.

Ju lutem, dëgjoni të nderuar deputetë,

E kemi një vendim të Qeverisë me emra, ose duhet të votojmë “për” ose “kundër”, por ky vendim duhet votuar për t’i hapur procedurat për atë që po kërkon disa. Përsëri nuk e di kush do të vijë, por problemi është që ne e kemi një vendim që duhet të votojmë ose “për” ose “kundër”.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim. Votojmë tash rekomandimin e Komisionit. Në sallë janë 61 deputetë. Faleminderit shumë!

Me 11 vota “për”, 34 “kundër” dhe 4 abstenime, konstatoj se vendimi nuk është miratuar.

Mirë u pafshim në seancën tjetër. Procedura përsëritet në bazë të ligjit.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve